



FONDACIONI I KOSOVËS
PËR SHOQËRI TË HAPUR



2018

RAPORTI

VJETOR

PUNA E FONDACIONIT NË VITIN 2018

Planifikimi Strategjik

Në vitin 2018 fondacioni është angazhuar në dy drejtime: të realizoj programet e parapara me Strategji 2017-2020 si dhe të merr një rol aktiv në mbështetje të iniciativave që e lehtësojnë dhe e bëjnë më efikas angazhimin e politikanëve dhe shoqërisë civile, në zgjidhjen e sfidave aktuale më të mëdha, procesit të negociatave me Sërbisë dhe nxitjen e bashkëpunimit rajonal - nëpërmes të financimit nga fondet rezervë të OSF.

Gjatë këtij viti fondacioni e ka ri-shikuar strategjinë e veprimit për ciklin e ri strategjik 2019-2022 e cila mbetet me një makrostrukturë programore të njëjtte si ajo e mëparshme, por që sjell mjaft ndryshime që i adresojnë zhvillimet aktuale - ambientin socio-ekonomik dhe politik gjithmonë në lëvizje – si dhe avancojnë qasjen dhe metodat që përdoren për t'i arritur qëllimet programore të parapara.

Programet – zhvillimet dhe sfidat në 2018

Shtirja programore ka mbetur e njëjtë me atë të disa viteve me parë, duke u fokusuar kryesisht në katër drejtime strategjike: (1) Rilidhja e Mitrovicës, (2) Integrimet Evropiane, (3) Luftimi i korrupsionit si dhe ngritja e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve qeveritare, dhe (4) Luftimi i korrupsionit (akademik) në Universitetin e Prishtinës. Kra

// Ndarja etnike dhe pandëshkueshmëria gjithnjë në zgjerim beten dy sfidat bazike për shoqërinë e hapur në Kosovë.

has këtyre programeve fondacioni ka sjellë aktivitete në programet që financohen nga donatorë të tretë (jo-Soros) të cilat ia mundësojnë një involvim më të thellë në përkrahjen e komuniteteve RAE. Po ashtu, një vend shumë të rëndësishëm në punën e fondacionit kanë zënë projektet e financuara nga Fondi Rezervë i OSF: Forcimi i pozitës Kosovare në procesin e negociatave me Serbinë dhe zërthimi i miteve të krijuara për Shqipërinë e madhe – program rajonal që realizohet së bashku me fondacionin simotër nga Tirana (OSFA).

Programet që realizohen në vazhdimësi në disa vitet e fundit – përveç programit të edukimit të lartë – e kanë ruajtur qëllimin përfundimtar edhe pse vazhdimisht pësojnë ndryshime të vogla për t'iu adoptuar më mirë rrethanave dhe zhvillimeve aktuale që në të shumtën e rasteve janë shumë dinamike. Të gjithë së bashku edhe në vitin 2018 kanë vazhduar t'i adresojnë çështjet madhore të agjendës zhvillimore të vendit, në rend të parë

për të: (1) sfiduar kulturën e pandëshkueshmërisë që lidhet me rastet më të shprehura të korrupsionit në vend, (2) për të krijuar rrethana optimale për afrimin e komuniteteve etnike që jetojnë në Kosovë dhe posaçërisht në Mitrovicë (veri dhe jug), (3) për të sjell sa më shumë vlera evropiane në reformat e institucioneve qeveritare dhe (4) për të ushtruar presion mbi Universitetin e Prishtinës për ta depolitizuar dhe për ta luftuar korrupsionin që është prezent në nivel menaxhues dhe akademik. Brenda kësaj strukture programore janë adresuar edhe disa çështje tjera që qëndrojnë në tërësi në veprimet për një shoqëri të hapur: janë mbështetur iniciativat që e luftojnë izolimin e vendit, duke e inkuadruar në iniciativa ndërkombëtare të sundimit të ligjit, posaçërisht në rrjetet e OGP, Open data, dhe Publish What You Pay (PWYP). Ka mbetur që në vitin 2019 të riaktivizohen nismat që Kosovën e sjellin më afër iniciativës globale EITI (Extractive Industry Transparency Initiative).

Krahas veprimeve programore fondacioni në vitin 2018 ka vazhduar të angazhohet për krijimin e rrjeteve dhe koalicioneve të organizatave jo-qeveritare, që në këtë fazë veprojnë si partnerë të fondacionit në realizimin e qëllimeve programore, por, në një të ardhme afatshkurtër këto rrjete do të vazhdojnë punën si të pavarura. Strategjia e fondacionit është t'i adresoj problemet madhore me të cilat merremi, nëpërmes të rrjeteve të themeluara mirë, që shumë lehtë lidhen mes veti me qëllime të përbashkëta, dhe plotësohen me ekspertizën e ndërtuar deri tash. Kjo qasje është treguar deri tash si shumë e qëlluar, dhe fondacioni e ka nxitur themelimin e të paktën dy rrjeteve të tilla: KITU (Koalicioni për Integritet dhe Transparencë në Universitet) si dhe

“ Fondacioni është i fokusuar në krijimin e rrjeteve dhe koalicioneve të aktorëve civilë për të forcuar ndikimin që ka në çështjet që i trajton, psh. Grupi Pro-Open; koalicioni për transparencë dhe integritet në Universitet (KITU) si dhe Rrjeti i medive në gjuhën serbe.

Open (Koalicioni për Hapje të të Dhënave dhe Llograihënie në Prokurim Publik). Një rrjet i ngjashëm, por jo-formal punon në çështjet e integritetit European.

Ka vite që fondacioni ka ndërtuar kapacitete shumë efikase të veprimit nëpërmes të projekteve operacionale (Koncepte) si dhe grantdhënie direkte (Fusha), të cilat mund t'i përshatën në mënyrë shumë fleksibile rrethanave programore të caktuara, si mjet efikas për ta sfiduar demokracinë Kosovare që vazhdon të jetë shumë e brishtë. Projektet e mëdha operacionale kanë qenë pjesa më e dukshme e veprimit të fondacionit në vitin 2018.

Situata politike dhe socio-ekonomike në vend në vitin 2018

Viti 2018 solli shumë lëvizje dinamike në politikën Kosovare. Zhvillimet politike në vend

dhe rajon sollën shumë më tepër dilema dhe konfuzion se sa zgjidhje dhe perspektivë zhvillimore. Aktorët politikë vazhdojnë të jenë të njëjtë e po ashtu edhe diskursi publik, në të cilin dominojnë veprime dhe retorikë popullore. I vetmi ndryshim është ai se Kosova gjatë vitit 2018 është futur në disa procese shumë të rëndësishme për vendin dhe se akoma nuk tregojnë se ka vizion konkret për zgjidhjen afatgjatë të sfidave që i ka përpara. Paqartësitë dhe kaosi politik shkaktuan shumë ngecje në agjendën zhvillimore të vendit, ku reformat e filluara vend-numëruan, ndërsa agjenda integruese në BE u zbeh dukshëm nga mos-veprimi adekuat i administratës kosovare. Lufta për pushtet u tregua edhe më e egër se më parë duke e anashkaluar mundësinë e arritjes së një konsensusi politik për çështjet madhore të vendit.

Sidomos pjesa e dytë e vitit 2018 ishte e përmbushur me konflikte politike, mungesë të vizionit dhe konsensusit për të adresuar një çështje madhore si që është dialogu me Serbinë. Ky fakt e ka bërë fondacionin të interesuar për të ndihmuar në fuqizimin e palës kosovare në këtë dialog. Në maj 2018, fondacioni i ka propozuar Fondit Rezervë të OSI që të angazhohet dukshëm në këtë proces, për t'i mbështetur partitë politike parlamentare, edhe me ndihmën e shoqërisë civile të vendit dhe jashtë tij. Kjo iniciativë do të zgjasë edhe gjatë vitit 2019, dhe tashmë janë siguruar fondet për realizimin e aktiviteteve të parapara.

Ekonomia e vendit vazhdon të jetë shumë prapa asaj që mund të arrihet. Parametrat virtual zhvillimor, siç është GDP (BPV) e dominuar nga projektet që realizohen me para të taksapaguesve, mbesin i vetmi argument i qeverisë se Kosova ka njëfarë zhvillimi. Por, pasi të analizohet performanca e NVM ose të

themi ndryshe, sektorit privat që është mbi 90% i operatorëve ekonomik në vend, shihet se ky sektor stagnon, dhe nuk ka shumë mundësi që me politikat dhe përkrahjen aktuale ta ngrisë performancën e vet. Dhe, në këtë situatë është fare normale që niveli i papunësisë, dhe varfërisë mbetet shumë i lartë. Me një ekonomi të tillë dhe me një politikë zhvillimore të zbehtë dhe jo konstruktive shtresa të ndryshme sociale do të jenë viktimat e para: pensionistët, të sëmurit, dhe kategori tjera vulnerable që janë të pa-shpresë dhe në rrezik permanent të përkeqësimit të më-tutjeshëm të gjendjes së tyre aktuale. Mjaft afër për të ju bashkëngjitur këtyre kategorive është një pjesë e madhe e rinisë dhe fëmijëve të cilët janë me pak shans për të siguruar ardhmërinë e tyre në Kosovë.

Shoqëria civile ose, të jemi më preciz, OJQ-të, janë konsoliduar deri në një masë dhe gjithnjë e më shumë e kanë të qartë se vetëm performanca e denjë do t'iu sjell mundësi zhvillimi, dhe përkrahje të donatorëve të cilët janë më të paktë se viteve të kaluara. Gjithnjë e më shumë vërehet puna e grupeve avokuese, e atyre që punojnë në hartimin e politikave zhvillimore, organizatave që tashmë kanë bërë eksperiencë në mbikëqyrjen e transparencës dhe llogaridhënies së vendim-marrësve, si dhe organizatave që punojnë me minoritetet etnike si dhe me grupet me nevoja të posaçme. Një pjesë e madhe e aktivizimit të OJQ-ve në sektor që mbulohen nga resorët qeveritare ka filluar të rrallohet, që është një refleks normal karshi faktit se me vendosjen dhe forcimin e veprimit të administratës lokale dhe qendrore, është zvogëluar nevoja që disa punë t'i bëjnë OJQ-të.

Thënë troq: në këtë vit fondacioni ka vazhduar të punojë në katër drejtime strategjike, analiza e të cilave është bërë në vazhdim të

këtij raporti, si dhe ka filluar punë të shënuar në adresimin e dy sfidave politike dhe zhvillimore që na i solli ky vit (me fonde rezervë). Po ashtu fondacioni ka vazhduar të punojë, me financimin e palëve të treta, siç është BE dhe fondacioni Gjerman Karl Kubel Stiftung, në adresimin e problemeve të komuniteteve RAE në lëmin e arsimit.


RAPORTI FINANCIAR

PASQYRA PERMBLEDHESE FINANCIARE E SHPENZIMEVE


të KFOS-it për periudhen kohore Janar - Dhjetor 2018

Nr.	Specifikimi	Buxheti Euro	Shpenzuar Euro	% e Shpenzuar
1	Mjetet e buxhetit bazë për vitin 2018			
	Koncepti 1 - Ribashkimi i Mitrovices	316,273.32	316,273.32	100.00
	Koncepti 2 - Perafrimi i institucioneve publike te Kosovës me Standarde te BE.	379,393.32	379,393.32	100.00
	Fusha 1 - Ngritja e transparencës dhe llogaridhenja	306,484.65	306,484.65	100.00
	Fusha 2 - Programi i Edukimit te larte	252,972.06	252,972.06	100.00
	Shpenzimet programore administrative	12,196.69	12,196.69	100.00
	Shpenzimet Administrative	223,201.71	223,201.71	100.00
	Sub-Totali 1 :	1,490,521.75	1,490,521.75	100.00
2	*Mjetet e buxhetit të fondit rezerve dhe të rrjetit për vitin 2018			
	Mjetet e Fondit Rezerve - Dialogu Kosove - Serbi	274,946.49	176,870.06	64.33
	Mjetet e Fondit Rezerve - Projekti Kosove - Shqiperi	150,969.00	34,161.16	22.63
	Mjetet e OSIFA per Konceptin 2.	153,669.00	58,027.31	37.76
	Mjetet e rrjetit per Iniciativen RAE	53,087.00	53,087.00	100.00
	Sub-Totali 2 :	632,671.49	322,145.53	50.92
3	Mjetet e buxhetit të dontorëve tjerë për vitin 2018			
	Fondet e Bashkimit Evropian	393,094.02	393,094.02	100.00
	Karl Kubel Stiftung	114,979.24	114,979.24	100.00
	Balkan Tender Watch	16,078.26	16,078.26	100.00
	Sub-Totali 3:	524,151.52	524,151.52	100.00
	Totali i buxhetit dhe shpenzimeve:	2,647,345	2,336,819	


1. Shpenzimet e bëra sipas programeve




2. Shpenzimet e bëra sipas muajve në 2018



3. Buxheti i shpenzuar i ndarë sipas kategorive financuese



4. Shpërndarja e granteve sipas vlerës së tyre - euro (është marrë për bazë shumë totale e shpenzuar sipas këtyre kategorive)





PROGRAMI EVROPIAN



ANKORIMI I INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË KOSOVËS ME STANDARDET DHE POLITIKAT E BE-SË

Ndonëse Kosova nënshkroi marrëveshjen e parë kontraktuale me Bashkimin Evropian në vitin 2015, institucionet e Kosovës janë larg prej arritjes së standardeve evropiane. Kosova ka adaptuar një Plan Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes Stabilizim-Asociim, dhe Agjendën për Reforma Evropiane, megjithatë shumë punë mbetet për tu bërë në reformimin e institucioneve kosovare dhe përafrimin e tyre me BE-në.

Ky program i fondacionit u themelua me qëllim që t'i shërbejë procesit të integritimit të Kosovës në BE duke u bërë nxitës dhe përkrahës i reformave në qeverisje. Fondacioni i ka fokusuar përpjekjet e veta brenda këtij programi në dy drejtime: së pari duke përdorë perspektivën evropiane të vendit për të avokuar reforma; së dyti duke u munduar që ta forcojë këtë perspektivë të Kosovës duke krijuar dhe mirëmbajtur lidhje me shtetet e Evropës që nuk e njohin shtetësinë e Kosovës.

Gjatë vitit 2018, Fondacioni ka përkrahur shoqërinë civile në vend për të monitoruar progresin e Kosovës në përmbushjen e standardeve evropiane, duke krijuar një rrjet organizatash që kanë hulumtuar dhe avokuar për përafrimin e institucioneve të Kosovës më afër BE-së brenda sektoreve të ndryshme në të cilat fokusohen.

// Fondacioni ka krijuar një rrjet organizatash në vendet mosnjohëse evropiane që shërbejnë si partnerë.

Përveç një serie të publikimeve në lidhje me pozitën e Kosovës karshi BE-së dhe analizave të progresit në procesin e integritimit, Fondacioni aktivisht është marrë me ndërtimin dhe zgjerimin e lidhjeve me shoqërinë civile dhe skenat kulturore në shtatë vendet mosnjohëse të shtetit të Kosovës, duke përfshirë këtu pesëshen evropiane dhe Sërbinë dhe Bosnjën e Hercegovinën. Pas suksesit në vitin 2017, për herë të dytë, Fondacioni do të përkrahë një rrjet prej 12 hulumtuesve të rinj nga këto vende, të cilët do të shpërndajnë njohuri për Kosovën moderne në vendet e tyre përkatëse. Fondacioni po ashtu ka vazhduar të bashkëpunojë së afërti me shoqërinë civile në vendet mosnjohëse si Greqia dhe Rumania, duke organizuar një ngjarje dy-ditore në Bukuresht, Rumani, ku me dhjetra akademikë dhe ekspertë të rajonit kanë pasur rastin të diskutojnë për të ardhmen e Kosovës brenda kornizës së re për zgjerim të BE-së.

Përveç programeve të buxhetit bazë, gjatë vitit 2018 Fondacioni ka zhvilluar edhe dy projekte operacionale të financuara nga fondi rezervë i Open Society Foundations. Nga maji 2018, duke e parë rëndësinë e hyrjes në fazën finale të dialogut, Fondacioni ka nisur një iniciativë me partnerët të saj nga Gjermania dhe Kosova për të fuqizuar pozitën e Kosovës në dialogun me Sërbine, duke lehtësuar në mes të palëve kosovare dhe duke nxitur krijimin e një konsensusi politik. Përveç kësaj, Fondacioni ka nisur bashkëpunim me Fondacionin për Shoqëri të Hapur në Shqipëri, OSFA, për të bërë një studim të përbashkët kuantitativ dhe kualitativ në lidhje me qëndrimet e qytetarëve rreth bashkëpunimit ekonomik, social, kulturor e politik në mes të dy vendeve. Të dyja projektet do të vazhdojnë të implementohen edhe përgjatë vitit 2019.

Thellimi i Njohurive mbi BE-në

Fondacioni është i përkushtuar që të përkrahë shoqërinë civile për të avokuar që institucionet kosovare të përafrohen me standardet e BE-së. Në rend të parë, kjo objektivë përkthehet në angazhimin e Fondacionit për të përkrahur organizata të shoqërisë civile për të prodhuar njohuri në lidhje me procesin e integritetit evropian, ndërsa në rend të dytë për t'i dhënë atyre mjete për të avokuar tek institucionet vendore dhe ato të kyçura në proces për rezultatet e dalura nga puna hulumtuese e tyre.

Një formë e të bërit këtë është përmes moduleve të "Thellimit të Njohurive mbi BE-në". Këto module ngërthejnë në vete përpilimin e dokumenteve pozicionuese mbi temat kyçe të Agjendës së Reformës Evropiane (ERA) dhe prioritetëve të dalura nga Marrëveshja

për Stabilizim-Asociim (MSA), si dhe punëtori intensive me akterët kyç nga institucionet publike, shoqëria civile dhe mediat. Modulet fokusohen në sektore specifike duke i dhënë hapësirë organizatave të shoqërisë civile të monitorojnë, hulumtojnë dhe analizojnë tema të ndryshme në thellësi.

Nga puna e këtyre organizatave gjatë vitit të shkuar është përgatitur një publikimi të përbashkët "Një debat evropian: Standardet evropiane si pjesë e e strukturave legale dhe institucionale" (lancimi i të cilës do të bëhet në fillim të vitit 2019). Përtej kësaj, shtatë organizata lokale janë fokusuar nëpër hulumtimin e prioriteve dhe standardeve evropiane në sektore të ndryshme, duke krijuar hapësirë që hisedarët të kenë qasje në njohuri më të thella dhe të kontribuojnë në analizimin e reformave dhe përafrimit me BE-në brenda sektoreve të tyre.

Instituti Demokratik i Kosovës, KDI ka avokuar për rritjen e integritetit dhe ndëshkueshmërisë në fushën e prokurimit publik dhe së bashku me organizatën Çohu! kanë mbajtur një punëtori tre ditore me akterët kyç në Strugë, Maqedoni në qershor. Punëtorja ka bërë bashkë ligjërues të huaj e vendorë dhe ka shpjer në një debat intensiv mes pjesëmarrësve - shumica hisedarë nga institucionet publike - në lidhje me atë se si do të mund të arrihej tek një mekanizëm për fuqizimin e Kodit Etik në prokurim publik dhe prokurori. Rekomandimet e nxjerra nga kjo punëtori janë përpiluar në një analizë të shkurtër të titulluar "Integriteti, element kyç në prokurim publik," e cila është botuar me 7 dhjetor 2018. Rekomandimet e dalura nga ky projekt parashtrajnë nevojën për ndryshime strukturore në Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik, KRPP, dhe krijimin e legjisllacionit për mbështetje të funksionimit të Byros së Integritetit,

një zgjidhje e bazuar në modelin holandez.

Në anën tjetër, **Organizata për Demokraci, Anti-Korrupsion dhe Dinjitet, Çohu!** është fokusuar në kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve. Përveç monitorimit të këtyre rasteve organiza është duke avokuar që këto sulme të përfshihen në Kodin Penal. Si pjesë të sensibilizimit më të përgjithshëm ata kanë mbajtur një shkollë gazetarie, 4 ditore në Durrës, Shqipëri në fund të shtatorit në bashkëpunim me ekipin e KRIK-ut nga Beogradi. Në fillim të 2019tës Çohu pritet të botoj një hulumtim mbi këtë temë.

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, QKSS në ndërkohë ka analizuar se si MSA-ja, më saktësisht pjesa politike e kësaj marrëveshje, mund të krijojë mundësi që Kosova, ngjashëm me vendet tjera të Ballkanit, të merr pjesë proaktivisht në misionet paqeruajtëse të BE-së. Për herë të parë, QKSS ka avokuar brenda dhe jashtë Kosovës për një qasje të tillë, duke nxitur debat për atë se si Kosova mund të shndërrohet në një vend kontribues në siguri, pjesë e komunitetit më të gjërë ndërkombëtar.

Si pjesë e projektit QKSS ka bërë lansimin e dokumentit të politikave të titulluar: “Pjesëmarrja e Kosovës në misionet paqeruajtëse: një mjet efektiv për politikën e jashtme” në shtator. Studimi gjithashtu analizon kornizën ligjore ekzistuese për pjesëmarrjen e Kosovës në misione paqeruajtëse të BE-së dhe identifikon kapacitetet potenciale dhe fushat e ekspertizës në të cilat Kosova mund të kontribuojë në mënyrë aktive. QKSS po ashtu ka përpiluar dhe publikuar dokumentin e politikave “Rimendimi i sigurisë: Ballkani Perëndimor si ofrues i sigurisë”. Ky punim është dërguar në Londër para organizimit të Samitit të Londrës në kuadër të Procesit të Berlinit.

Ndër tjerash, është organizuar punëtorja në kuadër të Thellimit të Njohurive për BE-në Moduli për Siguri, Drejtësi dhe Sundim të Ligjit me 16-18 dhjetor në Durrës, Shqipëri. Qëllimi i këtij moduli ka qenë ofrimi i një programi të veçantë të shkollimit jo-formal mbi çështjet e zhvillimit të sektorit të sigurisë në Kosovë, implementimin e MSA-së, bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë, si dhe kontributi i Kosovës në misionet paqeruajtëse të BE-së.

Demokrati Plus, D+, ka bërë monitorimin e rasteve të kontratave mbi vepër dhe ushtruesve të detyrës jashtë rregullave të Ligjit për shërbimin civil dhe ka avokuar për rregullim ligjor dhe praktik të tyre. D+ ka hartuar një draft raport me titull “Shfrytëzimi i kontratave mbi vepër dhe ushtruesve të detyrës në shërbimin civil: sa respektohen kriteret ligjore në rekrutimin me kontrata mbi vepër dhe mbajtjen e pozitave me UD”. Draft raporti është prezentuar dhe diskutuar në tryezën e mbajtur me hisedarët relevantë nga institucione të ndryshme me datat 7-9 dhjetor në Durrës, Shqipëri, ku edhe është mbajtur punëtorja në lidhje me kontratat mbi vepër në institucionet publike me hisedarët relevantë nga institucionet dhe shoqëria.

Raporti i finalizuar pritet të botohet në fillim të vitit 2019.

EC Ma Ndryshe ka bërë analizë të sektorit të ndërtimit, duke shqyrtuar zbatimin e standardeve evropiane në këtë sektor si dhe duke avokuar për planifikimin e keqpërdorimeve.

Si pjesë e projekt është hulumtuar dhe publikuar një analizë e shkurtë, që pasqyron situatën e planifikimit hapësinor në komunat në Kosovë duke trajtuar kornizën ligjore, rastet e ndërtimeve pa leje dhe analizuar rastin e

Prizrenit në veçanti. Publikimi është bërë në nëntor 2018. është mbajtur punëtorja “Standartet evropiane të transparencës në sektorin e ndërtimeve”, me 21-23 shtator në Durrës, Shqipëri. Gjatë kësaj punëtorja, pjesëmarrësit janë informuar mbi rolin e zbatimit të standardeve evropiane në planifikim hapësiror dhe parandalimin e keqpërdorimeve në sektorin e ndërtimit. është dorëzuar një raport për Komisionin Evropian në lidhje me fushën e planifikimit hapësiror. Një përmbledhje e shkurtë që i mbulon temat: Përbushja e MSA-së në fushën e mjedisit, Eurokodet dhe Kodi i Ndërtimit të Kosovës, Zbatimi i legjislacionit në sektorët e planifikimit dhe të ndërtimeve, Dëmet e shkaktuara ndaj trashëgimisë kulturore e Statistikat etj, i është dorëzuar institucioneve të BE-së për tu përfshirë në raportin e vendit të përpiluar nga Komisioni Evropian.

Në fillim të vitit 2019, pritet që të realizohet një dokumentar i shkurtë në lidhje me raste specifike të keqpërdorimit në sektorin e ndërtimeve.

Qendra Kosovare për Avokim dhe Zhvillim, KADC, është fokusuar në avokim të zbatimit të ligjit për kontrollin e duhanit, ligj që ndonëse është në harmoni me legjislacionin e BE-së, është dukshëm i injoruar apo shkelur në vende publike gjithandej Kosovës. Duke shqyrtuar se zbatimi i këtij ligji është imperativ për një jetë të shëndetshme, KADC janë fokusuar që të rrisin kapacitetet e inspektorëve që t’i njoftojnë me ndryshimet e ligjit për kundërvajte. Për këtë qëllim ata kanë mbajtur një punëtor tre ditore në tetor 2018, me 50 inspektorë nga të gjitha komunat e Kosovës për t’i diskutuar ndryshimet ligjore, si dhe rastet reale të inspektorëve sanitarë në terren. Organizata po ashtu ka botuar një humlumtim të shkurtë dhjetor të 2018 të titulluar

“Legjislacioni aktual dhe politikat që rregullojnë punën e Inspektoratit Sanitar në Kosovë”.

Moduli i fundit i realizuar si pjesë e nënprogramit “Thellimi i njohurive për BE-në,” është përgatitur nga **Grupi për Studime Juridike dhe Politike, GLPS**, i cili ka organizuar një punëtor tre ditore në Durrës, Shqipëri me temën “Rishikimi Funkcional i Sektorit të Drejtësisë si pararendës i procesit drejt Integritimit Evropian” në dhjetor. Duke i bërë bashkë hisedarë dhe akterë kyç në sektorin e drejtësisë - përfshirë këtu prokurorë dhe ekspertë të ndryshëm juridik, punëtorja ka krijuar hapësirë për të diskutuar edhe vetingun e sektorit gjyqësor në Kosovë, dhe problemet me moszbatimin e plotë të reformave në këtë sektor.

1. Tabela e granteve dhe shpenzimeve tjera:

Emri i Projektit	Grantist	Shuma Euro
Integriteti dhe pandëshkueshmëria në prokurim publik	Instituti Demokratik i Kosovës, KDI	4,950.00 €
EU shkolla e gazetarisë hulumtuese: Sulmet ndaj gazetareve	Organizata Demokraci, Anti-Korrupsion, dhe Dinjitet ÇOHU!	10,000.00 €
Mundësitë e Kosovës për pjesëmarrje në misionet paqeruajtëse të BE-së	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, QKSS	9,000.00 €
KDI Punëtori: "Integriteti dhe pandëshkueshmëria në prokurimin publik"	Operacional	9,990.00 €
Monitorimi i rasteve të kontratave mbi vepër dhe ushtruesve të detyrës jashtë rregullave të Ligjit për shërbimin civil dhe avokii për rregullim ligjor dhe praktik të tyre	Demokraci +	10,840.00 €
Standardet evropiane për parandalimin e keqpërdorimeve në sektorin e ndërtimit	EC Ma ndryshe	9,940.00 €
Çohu Punëtori: "Shkolla për Gazetarinë Hulumtuese"	Operacional	11,409.55 €
QKSS Punëtorja: "Definimi i së ardhmes: Rugëtimi i Kosovës drejt BE deri me 2025"	Operacional	6,250.00 €
Zbatimi i ligjit për kontrollin e duhanit	Qendra Kosovare për Avokim dhe Zhvillim, KADC	6,000.00 €
D+ Punëtorja: "Praktikat e rekrutimit në shërbimin civil: Marrëveshjet për shërbime të veçanta (kontratat mbi vepër) dhe Ushtruesit e detyrës (U.D) – rruga përpara?"	Operacional	6,080.00 €
KADC Punëtorja: "Ligji për kundërvajtje, zbatimi dhe ndërlidhja me ligjet tjera bazike"	Operacional	8,128.72 €
EC Ma ndryshe punëtori: "Standardet Evropiane në Planifikim Urban dhe parandalimi i keqpërdorimeve në sektorin e ndërtimit"	Operacional	4,415.58 €
GLPS Punëtori: "Rishikimi FunkSIONAL i Sektorit të Drejtësisë si pararendës i procesit drejt Integritit Evropian"	Operacional	7,580.00 €
	Subtotal:	98,988.86 €
Shpenzime operacionale programore		
Takimi i Ballkanit Perëndimor	Operacional	989.50 €
Takim me OSFA	Operacional	1,786.50 €
Punëtoritë për thellimin e BE-së dhe shpenzime konferencash	Operacional	2,486.20 €
Konsulenca	Operacional	2,262.12 €
Publikim për punëtori të Thellimi i njohurive për BE	Operacional	2,388.28 €
Shërbime të përkthimit	Operacional	2,071.21 €
Furnizim për zyre	Operacional	618.20 €
	Subtotal	12,502.01 €
	Grand Total	111,590.87 €

Monitorimi i procesit të integritit evropian dhe avokimi për reforma

Që para themelimit të programit evropian, Fondacioni e ka parë kushtëzimin e BE-së si një mjet të fuqishëm për të shtyrë përpara reforma institucionale që janë parakusht i zhvillimit të shtetit të Kosovës. Në vijë me Strategjinë, gjatë vitit 2018 Fondacioni ka përkrahur organizata dhe akterë të shoqërisë civile për të bërë monitorimin e implementimit të prioritetëve të Marrëveshjes për Stabilizim Asociim (MSA). Fondacioni ka përkrahur hulumtime, publikime, punëtori dhe tryeza që kanë adresuar pozitën e Kosovës karshi BE-së dhe prapambetjen e Kosovës në procesin e integritit evropian. Kjo ka kërkuar një përkrahje të projekteve në disa nivele: prej monitorimit të aksioneve dhe prioritetëve të parapara në dokumente shtetërore, e deri tek prodhimi i hulumtimeve në lidhje me pozitën gjeostrategjike të Kosovës drejt BE-së.

Një nga projektet që kanë hedhur një shikim nga lartë, është projekti i **Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED)** i cili adreson kërcënimet dhe sfidat ndaj sovranitetit të Kosovës përmes një botimi të përgatitur në bashkëpunim me Programin e Paqe-ndërtimit dhe Drejtat e Njeriut në **Columbia University** të Nju Jorkut. Ky projekt hulumtimi mblodhi 15 akademikë ndërkombëtarë e vendorë, për të shqyrtuar nga prizma të ndryshme sfidat që Kosova i ka në raport me Serbinë, Bashkimin Evropian, Rusinë, dhe Turqinë. Në tetor 2018, libri afro 200-faqësh u lanua në një konferencë tërë-ditore ku morën pjesë 64 përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Parlamentit të Kosovës, korit diplomatik në Prishtinë dhe dhjetra akademikë. Përveç, përmes KIPRED-

it, libri elektronik dhe i shtypur janë shpërndarë edhe përmes Columbia University dhe Komiteti i Helsinkit në Serbi.

Prej një prizmi më të ngushtë, **Grupi për Studime Ligjore dhe Politike, GLPS**, kanë bërë monitorimin e përmbushjes së kriterëve të vendosura nga BE-ja në MSA, duke mbështetur plotësimin e tyre përmes avokimit tek institucionet përkatëse të përfshira në këtë proces. Nga maji 2018, GLPS ka monitoruar vazhdimisht implementimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA), dhe do të vazhdojë të bëjë këtë edhe për gjysmën e parë të vitit 2019. Për të bërë monitorimin - GLPS kanë përpiluar një matricë origjinale dhe do të realizojnë raporte 6-mujore për të vlerësuar se sa janë përfunduar veprimet e mara përsipër nga institucionet e Kosovës. Në tetor, GLPS publikuar raportin e parë 6 mujor - i cili tregon se institucionet e Kosovës kanë bërë përparime në implementim e PZMSA-së me 52 % të veprimeve të plotësuara pjesërisht, ndërsa gati 30 % plotësisht. Rezultatet e monitorimit janë përdorur për të avokuar tek të gjithë akterët shtetëror e ndërkombëtar dhe janë shpërndarë përmes mediave pas një konference për shtyp. Në vazhdë të avokimit për reforma të sektorit publik, GLPS ka organizuar edhe një punëtori tre ditore në Durrës, Shqipëri me temën “Rishikimi Funkcional i Sektorit të Drejtësisë si pararendës i procesit drejt Integritit Evropian” - ku edhe u diskutua nevoja e vetingut në sektorin gjyqësor në Kosovë, dhe problemet me moszbatimin e plotë të reformave në këtë sektor.

Duke vazhduar, punën e filluar në fund të vitit 2017, **Momenti i ri për zgjerimin në BE: Çfarë mund të përfitojë Kosova** është një publikim i përgatitur nga korrespondentët nga Brukseli dhe ekspertët e çështjeve të BE-së, Gjeraqina Tuhina dhe Augustin Palokaj, me qëllim që të

“ Është krijuar një kanal dinamik për avokim mes organizatave të shoqërisë civile, qeverisë së Kosovës dhe institucioneve të BE-së edhe në Prishtinë dhe në Bruksel.

nisë diskutimin për strategjinë e re të Komisionit Evropian në ri-afirmimin e procesit të zgjerimit. Publikimi është prezantuar në Forum 2015 të mbajtur me 20 shkurt 2018. Publikimi analizon se çfarë benefite mund të ketë Kosova nga strategjia e re e komunikimit të Komisionit Evropian dhe perspektivën për vitin 2025 për shtetet kandidate që janë ‘front-runners’.

Korniza shumëvjeçare buxhetore e BE-së dhe zgjerimi- Përfitimet e Kosovës është vazhdim i punës së ekspertëve të çështjeve të BE-së Gjeraqina Tuhina dhe Augustin Palokaj, të cilët kanë përgatitur botimin “ Buxheti i BE-së: A i justifikon Korniza 2021-2027 politikat e Zgjerimit”. Ky publikim analizon ndryshimet në kornizën buxhetore të propozuar të BE-së dhe se si kjo e afekton zgjerimin e BE-së dhe integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor në përgjithësi dhe Kosovës në veçanti. Rezultatet e publikimit janë përmendur gjatë vizitave avokuese në Bruksel dhe Bukuresht gjatë vitit 2018, dhe në fillim të vitit 2019 publikimi pritet të lanohet në Prishtinë. Botimi vjen në një moment shumë të rëndësishëm për vet BE-në e cila do të hyjë në zgjedhje parlamentare në pranverën e vitit 2019.

Një botim tjetër që është përgatitur gjatë vitit 2018, është publikimi “Kuptimi i fuqisë nego-

ciuese të Kosovës në relacion me BE-në dhe imazhi i saj ndërkombëtarisht” i shkruar nga Gëzim Krasniqi, ko-drejtor i departamenti të studimeve nacionaliste në Edinburgh University. Ky botim do lanohet në pjesën e parë të vitit 2019.

Në dhjetor, rrejtet të **OJQ-ve të Grave “Qeliza”** u është dhënë përkrahje financiare për të avokuar në lidhje me përmirësimin e shërbimeve sociale në tri komuna të Kosovës. Pjesët avokuese të projektit do të zhvillohen gjatë pjesës së parë të vitit 2019.

2. Tabela e granteve dhe shpenzimeve tjera:

Emri i Projektit	Grantist	Shuma Euro
Pjesëmarrje në "Lincoln Center" Laboratori për Teatër	Agon Myftari (DR)	4,054.16 €
Pjesëmarrje në "Lincoln Center" Laboratori për Teatër	Blerta Rrustemi Neziraj (DR)	4,054.16 €
Ekspozita: Fushata e Pajtimit të Gjaqeve 1990-1991	Oral History Initiative	2,000.00 €
Transparenca dhe Llogaridhenia në zbatimin e ligjit për grupe të marginalizuara	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut, KMDLNj	9,990.00 €
Projekt hulumtimi dhe botimi "Threats to Kosovo's sovereignty"	Kosovo Institute for Policy Research and Development, KIPRED	7,800.00 €
Monitorimi i Planit Kombëtar për zbatimin e MSA-së, Thellimi Njohurive rreth Procesit të integritimit Evropian dhe Rritja e diskursit publik lidhur me dialogun Prishtinë-Beograd	Grupi për Studime Juridike dhe Politike, GLPS	20,000.00 €
Për shërbime më cilësore sociale dhe familjare	Rrjeti i OJQ-ve "Qeliza"	16,940.00 €
	Subtotal	64,838.32 €
Shpenzime operacionale programore		
Shpenzime nga tryezat për Forum2015	Operacional	4,033.92 €
Punëtori me OSFA 07.02-09.02.2018	Operacional	4,679.99 €
Konsulenca	Operacional	8,289.26 €
Raporti vjetor	Operacional	1,430.00 €
Publikim për Forumin 2015	Operacional	3,331.00 €
Shërbime të përkthimit	Operacional	961.20 €
Furnizim për zyre	Operacional	756.40 €
	Subtotal	23,481.77 €
	Grand Total	88,320.09 €

Relacionet mes Kosovës dhe BE-së: Të lidhemi me Evropën

Ndonëse Kosova ka arritur të vendosë marrëdhënie kontraktuale me Bashkimin Evropian, duke nënshkruar Marrëveshjen për Stabilizim Asociim në vitin 2015, dhjetë vite pas pavarësisë perspektiva evropiane e Kosovës mbetet e mjegullt, sidomos për shkak të mungesës së konsensusit brenda vet BE-së. Specifikisht, pesë vende të BE-së dhe dy shtete që synojnë anëtarësimin në BE, nuk e njohin Kosovën. Duke qenë që kanalet zyrtare me këto vende janë kryesisht të mbyllura, një nga qëllimet strategjike të Fondacionit është të trasojë rrugë të reja përmes të cilave mund të arrihen politkberësit, shoqëria civile dhe qytetarët e thjeshtë në këto vende. Si rrjedhojë, Fondacioni ka themeluar një rrjet të akademikëve nga vende të ndryshme të rajonit dhe ato mosnjohëse, ka përkrahur shkëmbime dhe organizime që e sjellin Kosovën dhe perspektivën e saj evropiane në qendër të vëmendjes, duke kontribuar kështu në forcimin e perspektivës së saj evropiane. Nënprogrami për zhvillimin e lidhjeve dhe shkëmbimeve me shoqëritë civile në shtatë vendet që s'e kanë njohur Kosovën përkrahët nga buxheti bazë dhe fondi Think-Tank nga OSIFE.

Zhvillimi i njohurive të shtetësisë së re në Evropën Juglindore: Politikat e jashtme dhe të brendshme të Kosovës

Ky projekt i nivelit rajonal ka për qëllim të plotësojë një boshllëk në bazën e njohurive që disa vende të rajonit të Ballkanit kanë

Me rrjetin e hulumtuesve, Fondacioni mbështet zërat me influencë nga vendet mosnjohëse të veprojnë si jehues për të ndihmuar që të ndryshohet opinioni publik.

për Kosovën bashkëkohore. Në një numër të projekteve të mëparshme (për shembull, në projektet e zbatuara nga ELIAMEP dhe CRPE) është bërë e qartë se vendet që nuk e kanë njohur Kosovën ose mbajnë interaksion të kufizuar me te, ose të dyja, ka një deficit serioz të studimeve profesionale jo-stereotipike rreth shtetit të ri të pavarur. Përndryshe, debati publik është ende i dominuar nga mitet dhe stereotipet që kanë qarkulluar që nga fillimi i krizës jugosllave rreth 25 vjet më parë. Ky projekt ka për qëllim që pjesërisht të përmirësojë këtë problem, por edhe të ndihmojë hulumtuesit e rinj dhe dinamikë, që të prodhojnë dije të re për Kosovën moderne. Pas përfundimit me sukses të ciklit të parë "Building Knowledge of new statehood in Kosovo", projekti vazhdon të ketë për qëllim ekspozimin e 12 hulumtuesve të rinj nga Rumania, Greqia, Serbia, Maqedonia, Kosova, Italia, Rumania, Bosnja dhe Hercegovina me përvijën direkte të Kosovës, koordinimin e hulumtuesve nga Kosova dhe vendet tjera, si dhe formimin gradual të një rrjeti të hulumtuesve të përbashkët. Profesorë të kualifikuar nga Universitet me repute botërore - Arolda Elbasani, Stephanie Schwandner-Sievers, dhe Agon Demjaha – janë angazhuar për t'i mbikqyrur hulumtuesit me planet e hulumtimit, literaturës relevante

dhe i ndihmuan të përcaktojnë pyetjet e tyre kërkimore. Gjatë vitit 2018, pas përpilimit të planit të avokimit, janë organizuar aktivitetet konkrete avokuese, të cilat do të vazhdojnë edhe përtej periudhës së implementimit, të mbështetura me kampanja mediale dhe media sociale.

- Në maj, është organizuar punëtorja e parë, në Universitetin Aristoteles në Selanik, me ç'rast hapsirat e Universitetit na janë ofruar pro-bono. Gjatë kësaj punëtorie, pjesëmarrësit janë njoftuar me projektin dhe objektivat, dhe është dakorduar për temat me të cilat do të punojnë.
- Gjithashtu, gjatë punëtorisë në Selanik, pjesëmarrësve u është ofruar një program shtesë me ekspertë grekë, në fushat: teknikat e hulumtimit, qasja efektive dhe metodat e diseminimit, si dhe një ligjeratë për historinë e Ballkanit dhe lidhjet mes popujve fqinje me Kosovën.
- Në shtator, hulumtuesit janë ftuar për vizitë studimore një javore në Kosovë, me ç'rast e kemi organizuar edhe një punëtori, për të diskutuar progresin dhe ngeçjet eventuale të hulumtuesve.
- Draftet finale janë dorëzuar nga të gjithë hulumtuesit në fund të dhjetorit.

Gjatë fillimit të vitit 2019:

- Shkrimet do të redaktohen
- Shkrimet do të përmbledhen dhe do të botohen në format të librit

Mungesë angazhimi? Një vështrim mbi politikat e shteteve anëtare të BE-së ndaj Kosovës.

Projekti tjetër që gjatë vitit 2017 ka mbledhur 10 ekspertë europianë për të vlerësuar dhe avokuar për pozitën diplomatike të Kosovës karshi vendeve anëtare të BE-së që nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës, por edhe ato që e kanë njohur por nuk tregojnë përkrahje, ka sjellur rezultate shtesë në fund të këtij viti. Në nëntor 2018, kemi arritur marrëveshje me shtëpinë botuese Palgrave McMillan, ka pranuar që ta botojë librin dhe ta vendosë në një numër bibliotekash universitare në Angli, por edhe online për të gjithë të interesuarit e tjerë. Libri është redaktuar dhe pritet të botohet në pranverën e vitit 2019.

Prapë në agjendë: Zgjerimi i BE-së drejt Ballkanit Perëndimor

Një projekt tjetër që është shembull i mirë i punës së Fondacionit për të bërë ndërlidhje të mëtutjeshme me shoqërinë civile në rajon është projekti i implementuar nga Global Focus, shoqatë rumune e bazuar në Bukuresht. Projekti i realizuar në prag të marrjes së Presidencës evropiane nga Rumania, mbledhi me dhjetra politikbërës, akademikë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe politikanë nga Rumania dhe rajoni, për të diskutuar agjendën rumune gjatë presidencës, dhe marrëveshjet historike në mes të Greqisë dhe Maqedonisë si dhe Kosovës dhe Serbisë.

Ngjarja dy ditore, e realizuar në bashkëpunim edhe me organizata tjera nga Bullgaria dhe

Austria, dhe akademikë rumunë, rezultoi në një seri ngjarjesh me 29-30 tetor 2018 në Bukuresht, përmes të cilave u avokua procesi i integritimit evropian për Kosovën, nevoja për njohuri më të madhe në lidhje me zhvillimet e fundme në Kosovë dhe rajon, si dhe kulturën kosovare.

Projekti rezultoi me një seminar të mbyllur ekspertësh në Komisionin Evropian në Bukuresht, në mes të cilëve ishin përfaqësues të shteteve anëtarë të BE-së si dhe përfaqësues të lartë politik të Rumanisë. Diskutimi një-ditor ka rezultuar në dy raporte përgatitore dhe një white paper.

Përveç kësaj, bashkë me Global Focus partnerët akademikë të projektit organizuan një panel diskutim "Artistët në mes të kufijve të Ballkanit" si pjesë të festivalit të filmit dokumentar "Culesi di Balkani," në të cilën morën pjesë artistë kosovarë. Si pjesë e programit të festivalit u hap edhe ekspozita e fotografive për festivalin e filmave dokumentar, Dokufest. Në ditën e fundit të organizimit, u mbajt edhe një takim akademik në bashkëpunim me and the National School for Political and Administrative Studies (SNSPA), që bëri bashkë hulumtues të vjetër e të rinj që kanë interesim Kosovën duke përfshirë këtu edhe përfitues të skemës së parë të "Building knowledge about Kosovo". Kjo ngjarje mbledhi një grumbull të rinjsh, kurioziteti dhe entuziazmi i të cilëve indikon rëndësinë e vazhdimit të përkrahjes së hulumtuesve të rajonit për të prodhuar dijeni për Kosovën dhe për të avokuar njohjen më të mirë të saj.

Festivali i përvjetshëm "Mirëdita, dobar dan!" që mbahet në Beograd ndër vite është shndërruar në një nga ngjarjet më të mëdha kulturore që lidhin dy vendet fqinje - Kosovën dhe Serbinë. Në vitin 2018, relacionet në mes

dy vendeve mbetën të ashpërsuara, gjersa dialogu në Bruksel u la kryesisht i injoruar nga të dy palët. Në këtë kontekst, edicioni i pestë i festivalit u mbajt në një atmosferë të rëndë politike: para nisjes së tij partitë e djathta shpërndanë propagandë kundër festivalit dhe organizatorët morën kërcënime nga Partia Radikale Serbe (SRS). Rrugës për në Beograd, artistët kosovarë u ndaluan nga policia serbe dhe dy nga veprat e artistes Eliza Hoxha - paraqitje fotografike të protestave në Kosovë gjatë viteve të '90ta - u morën nga policia serbe. Megjithatë 30 artistë kosovarë arritën në Beograd dhe së bashku me 20 gazetarë serbë dhe kosovarë, morën pjesë në panel diskutime, shfaqje filmike, ekspozita dhe koncerte të organizuara prej 30 maj deri më 2 qershor. Përkundër presionit politik (protestave jashtë Qendrës për Dekontaminim Kulturor, CZKD, gjatë hapjes dhe pranisë së Vojislav Seseljit, përcjelljes konstante policore), festivali u mbajt në tërësi dhe me sukses dhe arriti të mbledhte një audiencë të madhe dhe gjenerojë debat publik për marrëdhëniet mes dy shteteve - mbi 400 raportime mediale e përfolën festivalin.

Between the Seas - punëtori e skenaristi Jeton Neziraj në Athinë

Në vazhden e punës së vet për të lidhur shoqërinë civile të Kosovës me atë të vendeve të rajonit, e në veçanti të pesë vendeve anëtare të BE-së që nuk e njohin Kosovën, Fondacioni përkrahu pjesëmarrjen dhe punëtorinë e skenaristit Jeton Neziraj si pjesë e festivalit të artit performues "Between the Seas". Punëtorja u mbajt prej 5 deri në 10 nëntor, ndërsa gjatë festivalit Neziraj arriti të bënte paraqitje të tjera publike duke e bërë një lexim publik të skenarit të tij "Department of Dreams" e

cila u shfaq në përkthim për herë të parë para publikut grek.

Shkëmbimi rajonal rinor Dokufest 2018 është implementuar nga Iniciativa Rinore për të Drejtat e Njeriut, e cila ka sjellur 21 të rinj nga rajoni me qëllim për të krijuar një rrjetëzim të rinjve nga shtetet e Ballkanit Perëndimor. Gjatë qëndrimit një javor, pjesëmarrësit janë takuar me organizata lokale, kanë mësuar më shumë për kontekstin socio-ekonomik në Prizren dhe në Kosovë dhe në përgjithësi.

3. Tabela e granteve dhe shpenzimeve tjera:

Emri i Projektit	Grantist	Shuma Buxheti bazë	Buxheti nga OSIFE
Festivali Miredita Dobar Dan! 2018	OJQ Integra	21,800.00 €	
Projekti "Building Knowledge about Kosovo" Pjesa e dytë	Operacional	23,019.28 €	56,019.99 €
Konsulenca për projektin "Building knowledge about Kosovo vol. 2"	Operacional	20,150.00 €	
KIPRED Tryezë me Daniel Serwer: "Ballkani, BE-ja dhe SHBA-të: A mund të sinkronizohen përsëri?" (salla, zërimi & përkthimi)	Operacional	1,223.51€	
Punëtori e skenaristit Jeton Neziraj në Athinë	Between the Seas	1,010.00 €	
Shkëmbimi rajonal rinor Dokufest 2018	Iniciativa Rinore për të Drejtat e Njeriut, YIHR	5,250.00 €	
Pagesa për hulumtuesit pjesëmarrës në "Building Knowledge about Kosovo vol. 2"	Operacional	12,369.77 €	
"Back on the Agenda: European enlargement and the Western Balkans"	Global Focus	40,028.72 €	2,007.32 €
	Subtotal:	124,851.28 €	58,027.31 €
Shpenzime operacionale programore			
Konsulenca	Operacional	1,140.12 €	
Publikime të hulumtimeve	Operacional	5,959.00 €	
Shërbime të përkthimit	Operacional	1,006.45 €	
Furnizim për zyre	Operacional	803.83 €	
	Subtotal	8,909.40 €	
	Grand Total	133,760.68 €	58,027.31 €



TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA



TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA

// Fondacioni ndërton kapacitetet e sektorit publik për të zbatuar standardet, ndërsa në të njëjtën kohë mbështet shoqërinë civile për të mbajtur zyrtarët përgjegjës.

Sfidimi i mosndëshkimit të korrupsionit

Në fushën e ngritjes së transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve qeveritare, gjatë vitit 2018 Fondacioni ka vazhduar me implementimin e strategjisë dhe planit të veprimit. Strategjia është përqëndruar në sistemin e (1) prokurimit publik në Kosovë, specifikisht me analizimin e rasteve konkrete të shkeljeve gjatë procedurave të prokurimit, (2) në përgatitjen sa më të mirë për nismat ndërkombëtare nga e cila do të përfitojë shoqëria Kosovare, Open Data (hapja e të Dhënave) si pjesë

e iniciativës globale OGP (Open Government Partnership) dhe (3) EITI (Extractive Industry Transparency International). Koalicioni Pro Open, i themeluar nga Fondacioni në vitin 2017, ka përmbushur të gjitha kërkesat për anëtarësim në organizmin Publish What you Pay, një iniciativë e OJQ-ve ndërkombëtare tashmë e njohur, për llogaridhënie në sektorin nxjerrës, ndërsa vendimi për anëtarësim do të merret në në pjesën e parë të vitit 2019.

Fusha e ngritjes së transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve qeveritare ka vazhduar gjatë vitit të ndajë grante për organizatat e parapara me Strategji, për projektet e tyre që synojnë të ngrisin Integritetin e vendit. Gjithashtu, në tetor 2018, Fondacioni ka hapur thirrje për aplikim për fonde, nga e cila janë dhënë një numër grantesh.

Grantet që janë ndarë në shtyllën e Prokurimit Publik gjatë vitit 2018 janë:

Iniciativa Qytetare Skenderaj - IQS: Prokurimi transparent dhe llogaridhënës në komunën e Skenderajt

Qëllimi i projektit është vlerësimi i nivelit të përmbushjes së zotimit të kryetarit për prokurim transparent dhe llogaridhënës, si dhe të matet paanshmëria e komunës në

dhënien e tenderëve dhe respektimin e Ligjit të Prokurimit Publik. Përmes këtij projekti, IQS ka ndërmarrë këto aktivitete:

- Monitorimin e kontratave publike që nga shpallja për dhënie të kontratës e deri tek nënshkrimi i saj. Nëpërmes këtij aktiviteti IQS ka monitoruar kriteret që Komuna ka vendur për ofertë, mënyrën e vlerësimit të kompanive fituese, respektimin e këtyre kriterëve dhe mundësitë e shmangies së tyre për t'i dhënë përparësi një kompanie të caktuar dhe gjithashtu është monitoruar edhe nënshkrimi i tyre.
- Analizimin e tenderëve që Komuna e Skënderaj ka përzgjedhur si fitues.
- Publikimin e shkeljeve flagrante që janë bërë në procesin e prokurimit publik. IQS me qëllim të informimit të qytetarëve për numrin e kontratave publike që Komuna e Skënderaj ka nënshkruar, ka bërë publikime periodike në lidhje me këto kontrata dhe mënyrën e përzgjedhjes së tyre.
- Organizimin e 2 debateve publike nga të cilat janë nxjerrë rekomandime të qytetarëve përkitazi me këtë temë. Përmes 10 ligjëratave me nxënës të shkollave të mesme të cilat janë mbajtur janë informuar nxënësit për mënyrën e funksionimit të institucioneve lokale dhe format se si ata mund të kërkojnë llogari nga akterët relevantë për kërkesat dhe pakënaqësitë e tyre.
- Organizimin e një konference për media me qëllim të informimit të sa më shumë qytetarëve për çështjen e përgjegjësisë që komuna duhet të ketë karshi tyre, për mënyrën se si duhet të funksionojë sistemi i prokurimit publik, si përzgjidhet një kompani përfituese për kryerjen e punëve të caktuara etj.
- Ligjëratat me nxënës dhe student. Ky aktivitet është zhvilluar në shkollat e mesme dhe ambiente të hapura me audiencë të përbërë nga të rinj, kryesisht nxënës dhe studentë, me qëllim të sensibilizimit të tyre për rëndësinë e transparencës në kontratat publike. Aktiviteti ka pasur ndikim tek të rinjtë pasi që është rritur interesi për qasje në dokumente publike si dhe niveli i transparencës.
- Organizimin e tryezave të rrumbullakëta. Gjatë periudhës së implementimit të projektit IQS ka mbajtur dy tryeza të rrumbullakëta me një pjesëmarrje gjithpërfshirëse. Në këto tryeza është diskutuar për gjendjen në prokurimin publik në Komunën e Skënderaj nga ku janë nxjerrë rekomandime të cilat u janë adresuar organeve përgjegjëse me qëllim të bërjes publike të kontratave. Si rezultat i kësaj, Komuna e Skënderaj ka nisur publikimin e kontratave publike në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Përmes realizimit të projektit IQS ka arritur të bëjë ngritjen e transparencës në procesin e nënshkrimit të kontratave të cilat më pas edhe janë bërë publike në faqen e Komunës së Skënderaj.

Çohu: Llogaridhënia në Prokurim Publik

Projekti ka pasur për synim që vizualisht të argumentojë formën e debatit që duhet vendosur, me theks të veçantë në mënyrën se si trajtohet prokurimi publik në prizmin e luftimit të korrupsionit nga aspekti legal (Kodi Penal dhe ligjet përkatëse) në mënyrë që procesi i prokurimit publik në Kosovë të lirohet nga “perceptimet” dhe të rikthejë kredibilitetin e nevojshëm institucional dhe publik. Qëllimi i projektit ka qenë avokimi përmes video dokumentarit për adresimin e çështjeve në drejtim të institucioneve të drejtësisë, të cilat janë në kompetencë të institucioneve të drejtësisë dhe të cilat kanë të bëjnë procedurat dhe rastet e prokurimit publik.

Forum 2015: Integriteti dhe (mos) ndëkueshmëria në prokurim

Pas një pune disa muajshe të anëtarëve të koalicionit Pro Open, është organizuar tryeza e parë publike e tij, duke i publikuar të gjitha analizat në një paraqitje të përbashkët, nëpërmjet platformës avokuese të Fondacionit – Forum 2015. Për ta bërë më të lehtë për lexuesin, është prodhuar edhe një përmbledhje me shkeljet më të përsëritshme nga të gjitha analizat e partnerëve të koalicionit, e cila është botuar në formë të një libërthi të shkurtër, me qëllim që të kuptohet sa më mirë nga qytetarët. Gjithashtu, janë prodhuar edhe 3 filma të shkurtër dokumentar, për ti vizualizuar më qartë shkeljet që janë bërë gjatë procedurave të prokurimit.

Temat që janë shtjelluar janë:

- Përmbledhja-Integriteti dhe (pa) ndëkueshmëria në prokurim
- Tenderomania në ndjekje – punuar nga organizata Çohu
- Shkeljet dhe mosrespektimi i ligjit për prokurim publik në Kosovë – punuar nga organizata Demokraci +
- Monitorimi i Prokurimit Publik në Kosovë: Ngritja e llogaridhënies së institucioneve për mënyrat e shpenzimit të parasë publike punuar nga organizata FOL!
- Investimet e Arnuara – punuar nga Instituti Demokratik i Kosovës
- Blerjet e barnave të listës esenciale shumëfish më shtrenjtë se sa çmimet në treg – punuar nga Instituti Columbus
- Integriteti në Prokurimin Publik të komunave (Ferizaj, Shtime, Prishtinë) punuar nga Iniciativa për Progres

Forumi kishte mbledhur më shumë se 100 pjesëmarrës, ndërsa është transmetuar direkt në KTV.

Çohu: Shkatërrimi i mjedisit dhe efekti negativ i gurthyesve: cili është kontributi i prokurimeve abuzuese dhe transparencës së munguar?

Organizata ÇOHU – Preportr, e ka kryer një pjesë të mirë të punës në terren për të parë gjendjen e lumenjve – si rezultat i nxjerrjes dhe eksploatimit të rërës dhe zhavorrit, dhe se në çfarë gjendje është degraduar mjedisi nga gurthyesit në të gjitha anët e Kosovës. Preportr ka analizuar të dhënat e mbledhura nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale për rastet ilegale të evidentuara të nxjerrjes së zhavorrit dhe të rërës si dhe rastet e gurthyesve ilegale, për periudhën 2005-2018.

Nga të dhënat e shqyrtuara Preportr ka gjetur se janë evidentuar 495 raste ilegale gjatë viteve 2009-2018, ku prej tyre 166 raste janë për nxjerrje të gurit të fortë, ndërsa 329 raste janë evidentuar për nxjerrje ilegale të rërës dhe zhavorrit Gjithashtu, të dhënat e KPMM-së tregojnë se ky institucion ka lëshuar 562 licenca për gurthyerje dhe nxjerrje të rërës dhe zhavorrit (268 për hulumtim dhe 294 për shfrytëzim).

Preportr ka filluar me futjen e të dhënave në platformën online për opendata dhe është në proces të vizualizimit të të dhënave.

Aspekt tjetër me të cilin do të merret Çohu në janar 2019, janë lidhjet politike ndërmjet bizneseve dhe personave fizikë të cilët kanë marrë licenca ose janë evidentuar në rastet ilegale që potencialisht kanë lidhje me subjektet politike.

Demokrasi Plus: Monitorimi i klientelizmit media-institucione publike

Projekti ka për qëllim identifikimin dhe monitorimin e kontratave të institucioneve publike me media për shërbime të marketingut, dhe monitorimin e cilësisë së raportimit të mediave për institucionet publike nga të cilat marrin kontrata:

- Gjatë gjashtë muajve të implementimit të projektit janë monitoruar pesë gazetat ditore dhe janë evidentuar të gjitha shpalljet, reklamat, konkurset e mediave për institucionet publike;
- Janë monitoruar 14 portale dhe janë evidentuar të gjithë banerët, shpalljet apo reklamat e institucioneve publike në këto portale;
- Janë dorëzuar 66 kërkesa në institucione publike, së bashku me kërkesat rikonfirmuese për qasje në kontratat e tyre për shërbimet e reklamimit apo marketingut në media;
- Janë dorëzuar 19 kërkesa për informata tek 14 portale dhe 5 gazeta ditore;
- Janë zhvilluar 10 intervista me përfaqësues të institucioneve, media dhe palë të tjera, për marrjen e informatave për raportin e mediave me institucionet të cilat ofrojnë reklama;
- Janë identifikuar të gjithë artikujt e mediave për institucionet të cilat u kanë dhënë atyre reklama për tu analizuar se sa janë të balancuara raportimet në këto raste;
- Janë prezentuar të gjeturat fillestare të raportit në tryezën e organizuar nga OSBE dhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës;
- Raporti final është duke u përpiluar dhe analizuar, dhe në shkurt do të lansohet.

INPO: Llogaridhënia në kontratat e ndërtimit Qëllimi i projektit ishte ngritja e debatit publik për dështimet e vazhdueshme të Ministrisë së

Kulturës, Rinisë dhe Sportit në shpenzimin e parasë publike përmes investimeve kapitale për ndritimin e palestrave sportive dhe “mobilizimi” i shoqërisë civile për të kërkuar llogaridhënie. Analiza është në fazën e përfundimit dhe do të publikohet gjatë pjesës së dytë të janarit.

KAND: Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimarrje në Regjionin e Gjilanit

Projekti është fokusuar në ngritjen e vetëdijes së të rinjve dhe zyrtarëve nga Komuna që të jenë bashkëpunues në procese vendimarrëse që inkorporojnë interesat e të rinjve, në veçanti dhënies së bursave për të rinjtë e Gjilanit, Vitisë dhe Kamenicës. Aktivitetet e projektit

- Avokimi tek Komuna e Gjilanit, Vitisë dhe Kamenicës për procesin e shpërndarjes së bursave për studentët: Në këtë fazë ekipi i projektit ka filluar procesin e avokimit përmes Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare duke kërkuar dokumente për procesin e shpërndarjes së bursave për studentët në Komunën e Gjilanit, Vitisë dhe Kamenicës. Të gjeturat nga hulumtimi janë përdorur për të diskutuar në takimet me zyrtarë nga Komunitat Gjilan, Viti, Kamenice dhe të rinjtë në muajin e tretë të projektit.
- Organizimi i tre (3) takimeve me studentë dhe zyrtarë nga Komuna e Gjilanit, Vitisë dhe Kamenicës: Ky aktivitet ka sjellur qeverinë afër të rinjve në mënyrë që kërkesat dhe rekomandimet e tyre për dhënjen e bursave të jenë sa më të qarta për udheheqësit e Komunës. Në takimet “Të rinjtë therasin” ka marrë pjesë Kryetari i Komunes së Vitise, Sokol Haliti ku kanë marrë pjesë me shume se 100 të rinje/studente.
- Krijimi i videos me rezultatet e projektit: Ky aktivitet ishte faza finale e projektit. Të gjetu-

rat që ekipi i projektit i ka bërë në muajin e parë të implementimit rreth kërkesave për qasje në dokumente publike i ka adresuar pastaj në takimet me Kryetarin e Komunës së Vitisë, Kryetarin e Komunës së Kamenicës dhe Drejtorin e Arsimit në Gjilan. Në video gjithashtu janë përmbledhur edhe të gjitha rekomandimet dhe të gjeturat e këtyre takimeve në 3 komuna. Video është postuar në rrjetet sociale të KAND në Facebook dhe Instagrami.

Instituti Columbus: Monitorimi i prokurimit për Sistemin e Sigurimeve Shëndetësore

Instituti “Columbus” prej muajit gusht ka filluar hulumtimin në lidhje me ndërtimin e infrastrukturës së Sigurimeve Shëndetësore. Përkundër se ka pasur probleme në qasjen në informata nga MSH-ja, nga dokumentet që Columbus ka siguruar argumentohet humbja e shumë miliona eurove pa asnjë rezultat. Tani Instituti Columbus vetëm se ka gjetjet e para, dhe është në fazën e intervistimit të persona përgjegjës.

Si i tillë hulumtimi final do të këtë gjetje për angazhimet e pesë ministrave të fundit në funksionalizimin e Sigurimeve Shëndetësore. Strategjia e ish-ministrave Alush Gashit e Bujar Bukoshi në vitin 2019 rezulton plotësisht e dështuar. Për implementimin e kësaj strategjie janë shpenzuar disa miliona euro e për të cilat nuk ka raport të saktë se si janë shpenzuar.

Ish-ministri, Ferid Agani ka tentuar të modifikojë këtë strategji dhe i pasuar nga ish-ministri, Imet Rrahmani kanë shpenzuar rreth 6 milionë euro në krijimin e një sistemi i cili do të duhej të fillonte punën në dhjetor të 2017-ës. Por sistemi elektronik që kanë krijuar, nga 22 module, vetëm dy kanë arritur të bëhen funksionale.

Ministri aktual, Uran Ismail gjithë investimin e dy paraardhësve të tij e ka cilësuar si të dështuar dhe ka nisur nga zeroja një tjetër sistem, për funksionalizimin e të cilit kostoja është miliona euro.

Ministri aktual nuk ka bërë asnjë lëvizje në komponentet tjera të funksionalizimit të Sigurimeve Shëndetësore siç janë: çmimorja e shërbimeve, lista e shërbimeve, amandamentimi i ligjeve, nxjerrja e udhëzimeve administrative. Një ritëm i tillë i ngadaltë e bënë edhe për disa vite të pamundshëm fillimin e implementimit të Ligjit për Sigurime Shëndetësore, e që sipas zotimeve zbatimi do të duhej të filloonte që në vitin 2015.

Forum 2015 - Kontratat e dëmshme të Kosovës: kush ka faj?

Kohëve të fundit Qeveria e Kosovës është përballur me konteste gjyqësore, të cilat rrjedhin si pasojë e formulimit dhe zbatimit joadekuat të kontratave publike. Këto konteste gjyqësore tregojnë se Qeveria e Kosovës dhe institucionet tjera publike nuk kanë arritur të dizajnojnë kontrata të plota dhe të respektojnë detyrimet që dalin nga marrëdhëniet e tilla kontraktuale. Përderisa rezultatet nga këto konteste potencialisht mund t'i kushtojnë jashtëzakonisht shumë buxhetit të Kosovës, ende nuk është vënë askush para një përgjegjësie as politike e aq më pak penale për këto raste.

Gjatë kësaj tryeze u prezentuar studimi i hartuar nga Instituti Riinvest, ndërsa për të diskutuar rreth këtyre problemeve, panelistë ishin: Pal Lekaj – Ministër i Infrastrukturës; Valdrin Lluka – Ministër i Zhvillimit Ekonomik; Korab Sejdiu – Deputet në Kuvendin e Kosovës; dhe Alban Hashani – Drejtor Ekzekutiv, Instituti Riinvest.

Balkan Tender Watch

Në vitin 2018, Fondacioni i është bashkuar koalicionit rajonal Balkan Tender Watch, i cili ishte themeluar disa vite më parë nga Serbia, Bosnja e Hercegovina, Maqedonia dhe Mali i Zi. Në 2018, edhe Kosova iu bashkua grupit të Ballkanit në këtë koalicion në projektin e dytë të realizuar nga Balkan Tender Watch.

Projekti që zgjatë 4 vite, ka për qëllim përmirsimin e sistemeve të prokurimit në Ballkan. Projekti që financohet nga Komisioni Evropian do të bëjë krahasimin dhe vlerësimin e sistemeve kombëtare të prokurimit në këto shtete, duke aplikuar një sërë indikatorësh matës, të cilët janë zhvilluar gjatë vitit 2018.

Takimi i parë iniciues është mbajtur në Beograd në pranverë, ndërsa takimi i dytë është mbajtur në Prishtinë. Anëtarët e koalicionit janë mbledhur në Prishtinë për të diskutuar rreth indikatorëve matës, të cilët pastaj janë finalizuar në vjeshtë në takimin e koalicionit në Sarajevë.

Gjatë pjesës së dytë të vitit janë prodhuar një Media Brief, një Policy Brief, si dhe një Shadow Report, të cilat pastaj janë paraqitur në një raport krahasues për të gjitha shtetet e koalicionit.

Në fund të dhjetorit, është mbajtur edhe konferenca e parë rajonale në Shkup, në të cilën kanë marrë pjesë hisedarët kryesor nga sektori publik, shoqëria civile dhe mediat nga i tërë rajoni. Nga Kosova, përfaqësues ishin: Zyra Kombëtare e Auditimit, Agjencia Anti-Korrupsion, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Organi Shqyrtues i Prokurimit, Instituti Demokratik i Kosovës, BIRN, FOLI, Demokraci Plus, dhe Çohu.

Projektet e aprovuara në fund të 2018, e që do të implementohen gjatë vitit 2019:

Advocacy Center for Democratic Culture (ACDC): Prokurimi Publik në veri të Kosovës

Qëllimi i projektit është ngritja e transparencës dhe pjesëmarrja më e madhe e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme lokale në procesin e prokurimit publik në veri të Kosovës. Objektivat specifike të projektit: (1) Hulumtimi i sa NVM lokale marrin pjesë në prokurimin publik; (2) Eksplorimi i transparencës së procesit të prokurimit publik; (3) Forcimi i rolit të publikut dhe NVM-ve në monitorimin e procesit të prokurimit publik; (4) Përmirësimi i pjesëmarrjes së NVM-ve vendore në procesin e prokurimit publik, si dhe (5) Lehtësimi i ndërveprimit të strukturave komunale dhe NVM-ve me qëllim zhvillimin më të shpejtë ekonomik, dhe punësim më të madh. Projekti do të zbatohet gjatë vitit 2019.

Internews Kosova: Manipulimet e Kontraktuar

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik e ka bërë të obligueshme për të gjitha institucionet buxhetore që t'i publikojnë të gjitha kontratat që i lidhin me Operatorët Ekonomik për kryerjen e punëve, marrjen e shërbimeve apo furnizimin.

Përkundër që publikimi i kontratave është një lajm i mirë për shoqërinë civile dhe gazetarët, deri më tani ato nuk janë shfrytëzuar për t'i thelluar hulumtimet e bëra në këtë fushë me qëllim të gjetjes së aferave korruptive apo lidhjen e kontratave të dëmshme.

Internews Kosova do të bëjë analizimin e kontratave të lidhura nga institucionet që janë të natyrës së ngjajshme dhe që janë të krahasueshme. Koncentrimi do të jetë tek Kontratat Kornizë. Kontratat Kornizë bëhen kur institucionet nuk mund të parashikojnë numrin e saktë të mallrave që duhet të furnizohen. Në këtë kontratë, Operatorët Ekonomik ofertojnë me çmime specifike për secilin produkt. Një prej problemeve të evidentuara ndër vite kanë qenë çmimet jo-normalisht të ulëta për disa produkte në rastin e kontratave kornizë. Nuk janë të pakta rastet kur brenda një oferte janë gjetur çmime të fryra për një produkt si dhe çmime jo normalisht të ulëta për produkt tjetër.

1. Lista e projekteve të organizatave të mbështetura në shtyllën e hapjes së të dhënave dhe shpenzime tjera:

Emri i Projektit	Grantist	Shuma Euro
Prokurimi transparent dhe llogaridhënës në komunën e Skenderajt	Iniciativa Qytetare Skenderaj	10,500.00 €
Llogaridhënia në Prokurim Publik	Organizata Çohu	3,900.00 €
Shkatërrimi i mjedisit dhe efekti negativ i gurthyesve: cili është kontributi i prokurimeve abuzuese dhe transparencës së munguar?	Organizata Çohu	16,620.00 €
Monitorimi i klientelizmit media-institucione publike	Demokrasi Plus	14,980.00 €
Llogaridhënia në kontratat e ndërtimit	INPO	9,237.00 €
Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimarrje në Regjionin e Gjilanit	KAND	2,965.00 €
Monitorimi i prokurimit për Sistemin e Sigurimeve Shëndetësore	Instituti Columbus	23,400.00 €
Prokurimi Publik në veri të Kosovës	Advocacy Center for Democratic Culture	9,980.00 €
Manipulimet e Kontraktuara	Internews Kosova	10,000.00 €
	Subtotal	101,582.00
Shpenzime programore		
Punëtori planifikuese e koalicionit Pro Open	Operacional	6,741.22 €
Takimi i Western Balkan	Operacional	1,678.91 €
Sponsorim në media sociale	Operacional	2,744.72 €
Shërbime të përkthimit	Operacional	779.09 €
Furnizime të zyrës	Operacional	348.99 €
	Subtotal	12,292.93 €
	Total	113,874.93 €

Në fushën e hapjes së të dhënave pas përgatitjes nga ana e Fondacionit e Planit të Veprimit për hapjen e të dhënave, institucioni bartës – Ministria e Administratës Publike, ka vazhduar ta shtyjë këtë iniciativë tutje, duke ndarë fonde nga buxheti bazë për implementimin e Planit të Veprimit, të cilin e kemi punuar ne. Gjatë disa takimeve të zhvilluara nga MAP rreth inventarizimit të të dhënave, është vërejtur se ka ende shumë pak informacion rreth hapjes së të dhënave nga zyrtarët publik.

Trajnim/Punëtori - Ekosistemi i Hapjes së të Dhënave

Për t'i dhënë një shtytje shtesë kësaj iniciative, kemi ftuar ekipin e ekspertëve nga Open Data Institute në Londër, që të na ndihmojnë në forcimin e ekosistemit të të dhënave të hapura në Kosovë, duke i ndërtuar pikat e forta ekzistuese dhe mundësitë e ardhshme. Dita e parë ishte ditë e plotë trajnimi që kryesisht mbulonte informacione kyçe për ekosistemin e të dhënave të hapura. Pjesëmarrësit mësuan se çka janë të dhënat e hapura, çka është spektri i të dhënave, dhe si teoria e ndryshimit e të dhënave të hapura lidhet me gjerësisht me ekosistemin e të dhënave. Po ashtu u shtjelluan shumë shembuj të ekosistemit të të dhënave. Certifikatat dhe licencimi u mbulua pasdite, dhe pjesëmarrësit mësuan për llojet e ndryshme të licencave. Dita u përmbyll me të kuptuarit se si të matet sukcesi në të dhënat e hapura duke përdorur Open Data Barometer.

Dita e dytë u nda në punëtori në mëngjes ku pjesëmarrësit u angazhuan në mënyrë aktive dhe bënë prezantime në grup, derisa pjesa e trajnimit të pasdites u përqendrua në inovacion dhe etikë. Punëtorja në mëngjes u ndihmoi pjesëmarrësve të kuptojnë rolet e tyre

në një ekosistem të të dhënave, si dhe rolet e njerëzve në të cilët mbështeten për suksesin e tyre. Duke u nisur nga kjo, pjesëmarrësit mësuan se si të krijojnë strategji të angazhim-it efikas, dhe krijuan shembuj të strategjive. Trajnimi i pasdites shtjelloi rëndësinë e inovacionit në shoqëri duke u bazuar në dobitë socio-ekonomike të cilat ODI i ka parë në të kaluarën. Trajnimi mbuloi fillet e ekosistemit dhe mënyrën se si të inkurajohet ai, siç janë sfidat e të dhënave të qëndrueshme. Tema e fundit mbuloi etikën e të dhënave, pse ishte e rëndësishme për shoqërinë, dhe dha shembuj ku etika nuk ishte aplikuar si duhet në të kaluarën.

Dita e tretë u nda në punëtorinë e mëngjesit e cila u fokusua t'u ndihmonte pjesëmarrësve të kuptonin dhe të krijojnë strategji komunikimi. Nga pjesëmarrësit pastaj u kërkua t'i përdorin mësimet që i kanë marrë gjatë dy ditëve dhe të krijojnë një numër të besueshëm qëllimesh dhe veprimesh të menjëhershme, afatshkurta dhe afatgjata për t'i adresuar rekomandimet nga ODRA.

Në trajnimin morrën pjesë 35 persona – zyrtarë qeveritar, media, pjesëtarë të shoqërisë civile, si dhe Odat Ekonomike.

Grantet që janë ndarë në shtyllën e Hapjes së të Dhënave gjatë vitit 2018 janë:

FOL! Hapja e të dhënave dhe rritja e transparencës së institucioneve gjatë shpenzimit të parasë publike

Projekti ka për qëllim të bëjë transparent procesin e realizimit të kontratës së Autostradës Prishtinë-Gjilan karshi qytetarëve. Gjatë zbatimit të këtij projekti FOL! është fokusuar në këto katër fusha:

1. Procesi i prokurimit, ku janë vlerësuar procedurat e prokurimit, gjegjësisht përzgjedhja e operatorëve ekonomik për ndërtimin e autostradës, si dhe ankesat e operatorëve tjerë ekonomikë të cilët kanë qenë pjesë e procedurave tenderuese:

Të gjeturat:

- I gjithë procesi rreth ndërtimit të kësaj autostrade është përcjellë me mungesë të theksuar të transparencës.
- Ofrimi i pjesshëm i dokumenteve të kërkuara nga Ministria e Infrastrukturës në kuadër të ndërtimit të autostradës, shton dyshimet për keqpërdorime të mundshme gjatë realizimit të kësaj kontrate, sidomos mungesa e Planit të Menaxhimit të Kontratës, ku sipas zyrtarëve të prokurimit nuk ekziston një plan i tillë.
- Monitorimi i kësaj autostrade ka vëretetur se ndërtimi i saj nuk ka qenë i paraparë në planifikimin e prokurimit të kësaj ministrie.
- Procesi është përcjell me vonesa në fillimin e punimeve sipas kushteve të parapara në kontratë.

2. Procesi i shpronësimi, i cili është vlerësuar për nga forma në të cilën ka ndodhur, kohëzgjatja e procesit të shpronësimi dhe zonat kadastrale në të cilat ka pasur shpronësime. Analizimi i kësaj fushe është bërë duke marrë parasysh kornizën ligjore mbi shpronësimin, vendimeve qeveritare, si dhe në bashkëpunim me dy nga komunat e prekura nga shpronësimi:

Të gjeturat:

- Procesi i shpronësimi është filluar vonë, do të thotë pasi që janë nënshkruar kontratat për ndërtimin e autostradës.
- Përshkak se vendimi përfundimtar për

shpronësim që është marrë shumë vonë nga qeveria e Kosovës, komunat kanë qenë të detyruara të bëjnë ndërtimin e pronësisë së parcelave në zonat kadastrale nëpër të cilat kalon autostrada.

- Është lejuar ndërtimi i pronësisë së parcelave, në zonat kadastrale të prekura nga shpronësimi, deri në momentin e nxjerrjes së vendimit përfundimtar nga ana e qeverisë në fund të muajit Tetor 2018.

3. Vlerësimi i pronës së paluajtshme, përfshirë ndryshimin e pronarëve të pronave, të cilat është tentuar të bëhen në bashkërendim me institucionet të cilat e kanë bërë vlerësimin dhe dy komunat të cilat zonat kadastrale të të cilave kanë kaluar në këtë proces:

Të gjeturat:

- FOL përmes kërkesave për Qasje në Dokumente Publike ka arritë të sigurojë të dhëna rreth shpronësimi të parcelave në zonat kadastrale nga kalon autostrada Prishtinë-Gjilan, për 3 vitet e fundit. Aty vërehet numri i madh i shitblerjeve që kanë ndodhur para dhe gjatë periudhës kur ka filluar ndërtimi i autostradës.
- Pas refuzimit të kërkesës për qasje në vlerësimin e këtyre parcelave nga Ministria e Financave, FOL ka dërguar ankesë tek Avokati i Popullit, të cilët na kanë thënë se për shkak se nuk kanë pasur rast të tillë më herët janë duke e punuar një raport për këtë qështje dhe jo vetëm rekomandim sic zakonisht bëjnë në këso raste.
- Gjithashtu FOL! është në pritje të një interpretimi nga ana e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale rreth refuzimit nga Ministria e Financave për të lejuar qasje në vlerësimin e parcelave të shpronësuara.

4. Dëgjimet publike të monitoruara bazuar në të dhënat, gjegjësisht procesverbalet, e ofruara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor:

Të gjeturat:

- Procesverbalet nga këto dëgjime publike del se janë mbajtur vetëm pse kanë qenë të obliguar dhe jo për informuar qytetarët. Sipas qytetarëve këto dëgjime publike nuk kanë informuar pronarët dhe zotëruesve të interesit me projektin në detaje; nuk kanë qenë të informuar rreth vijës së kalimit të trasesë; ka pasur mospërputhje, në kategorizimin e parcelave, në mes të gjendjes në terren dhe elaborateve; nuk janë informuar mbi procesin, gjegjësisht mbi vijën tokësore e cila shpronësohet; si dhe dërgimi i njoftimeve dhe vendimeve me emër të gabuar tek pronarët ligjor të parcelave.

Projektet e aprovuara në fund të 2018, e që do të implementohen gjatë vitit 2019:

Demokrasi Plus: Digjitalizimi i raportimit të financave të subjekteve politike

Qëllimi i projektit që do të zbatohet në vitin 2019 ka për qëllim ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies së partive politike në mbledhjen dhe shpenzimin e fondeve, duke krijuar një mekanizëm për raportime online të subjekteve politike dhe kandidatëve, me synim rritjen e transparencës në financimin e subjekteve politike në Kosovë. D+ beson se përveç ndryshimeve në legjislacion të cilat janë duke u bërë nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, ka nevojë për ndryshim të prak-

tikave të raportimit të cilat do të lehtësonin raportimin për subjektet politike dhe do të shtonin transparencën për votuesit.

Environmentally Responsible Action Group (ERA): Për një Komunë transparente dhe llogaridhënëse - Aktivizmi mjedisor në Bjeshket e Nemuna

// Gjatë dy viteve të fundit Fondacioni ka mbështetur përpjekjet e shoqërisë civile për ngritje të transparencës në Prokurim Publik, për të prezantuar në Kosovë Iniciativat: Hapja e të Dhënave, Publish What You Pay (PWYP) dhe Iniciativa për Transparencës në Industrinë Nxjerrëse (EITI).

Qëllimi i projektit është ngritja e transparencës dhe llogaridhënies në Komunën e Pejës me arritjen e ketyre objektivave: (1) Mbrojtjen e ambientit në Parkun Nacional Bjeshket e Nemuna përmes prokurimit dhe monitorimit, (2) Vetëdijësimin e qytetarëve për dëmet e shkaktuara nga korrupsioni në prokurim, (3) Sigurimi i zbatimit të mirefillt të kontratave, (4) Analizimi i ligjeve në fuqi.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS): Ngritja e llogaridhënies dhe transparencës së

Qeverisë mbi alokimin e parasë publike

Më anë të këtij projekti GLPS synon që të zvogëlojmë ndikimin negativ të shpenzimit dhe alokimit të pakontrolluar të parasë publike nga ana e Qeverisë, si dhe të krijohet një mekanizëm monitorues me anë të të cilit do të indentifikohen indikatorë lidhur me trendet e llojeve dhe natyrës së alokimit të fondeve nga buxheti i Kosovës. Për të arritur këtë synim, GLPS do ti bëj presion Qeverisë që të jetë më transparente dhe të jap llogari për mënyrën e shpenzimit të parasë publike.

2. Lista e projekteve të organizatave të mbështetura në shtyllën e hapjes së të dhënave dhe shpenzime tjera:

Emri i Projektit	Grantist	Shuma Euro
Hapja e të dhënave dhe rritja e transparencës së institucioneve gjatë shpenzimit të parasë publike	FOL!	14,100.00 €
Digjitalizimi i raportimit të financave të subjekteve politike	Demokrasi Plus	18,280.00 €
Për një Komunë transparente dhe llogaridhënëse - Aktivizmi mjedisor në Bjeshket e Nemuna	Environmentally Responsible Action Group	6,415.00 €
Monitorimi i klientelizmit media-institucione publike	GLPS	14,195.00 €
	Subtotal	52,990 €
Shpenzime programore		
Punëtori/Trajnim - Open Data	Operacional	16,667.90 €
Open Data Institute London	Operacional	18,219.17 €
Shërbime të përkthimit	Operacional	2,105.28 €
Furnizime të zyrës	Operacional	488.45 €
	Subtotal	37,480.80 €
	Total	90,470.80 €

Në fushën e sektorit nxjerrës, Fondacioni së bashku me partnerët strategjik kanë vazhduar përgatitjet për anëtarësim të koalicionit Pro Open në organizmin Publish What You Pay. Është përpiluar statuti i koalicionit, është punuar gjatë me sekretariatit, deri në dorëzimin e aplikacionit, që është bërë në nëntor. Vendimi për anëtarësim i koalicionit Pro Open në Publish What You Pay pritet në fillim të vitit 2019.

Grantet që janë ndarë në shtyllën e sektorit nxjerrës gjatë vitit 2018 janë:

Ec Ma Ndryshe: Sfidat e prokurimit publik në komunën e Prizrenit

Qëllimi i projektit është evidentimi i shkeljeve që po bëhen në sektorin e ndërtimit në qendrën e Prizrenit, duke pasë parasysh se qendra është e mbrotjur me ligj të veçantë dhe se çdo intervenim duhet ti nënshtrohet Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit. Kohëve të fundit kemi qenë dëshmitarë të shumë ndërtimeve ilegale që janë bërë në qytet, mirëpo askush deri tash nuk ka marrë përgjegjësi për këtë degradim. Aktivitetet e projektit:

- Hulumtimi i rasteve specifike të shkeljeve ligjore dhe procedurale të prokurimit publik në komunën e Prizrenit: Ky aktivitet ka përfunduar dhe është publikuar. Gjithashtu ky hulumtim/analizë do të publikohet/promovohet edhe në tryezën përmbyllëse.
- Monitorimi i organeve të prokurimit publik në Prizren: Është bërë në mënyrë të vazhdueshme dhe të gjeturat i kanë shërbyer edhe hulumtit.
- Avokimi ndaj komunës së Prizrenit për përmirësimin e transparencës online në fushën e prokurimit publik: Janë organizuar disa takime me kryetarin, kryesuesin e komunës së Prizrenit dhe drejtorë të disa drejtorive për rëndësinë e plotësimit dhe pasurimit të platformës online me dokumente të publikuara nga zyrtarët përgjegjës. Gjithashtu janë realizuar takime edhe me drejtorët relevant për mundësinë e pasurimit të platformës si dhe mundësitë që dokumentet të jenë më lehtë të qasshme dhe të kuptueshme për qytetarët. Komuna, përveq publikimit të njoftimeve të prokurimit, nga mesi i gushtit ka filluar që ti publikojë edhe kontratat e caktuara.
- Prodhimi i Video-dokumentarit: Ky aktivitet është në fazën finale të skenarit të dokumentarit dhe së shpejti pritet të kontraktohet kompania për realizim. Ky dokumentar do të përmbajë të gjetura/ raste specifike të keqpërdorimeve dhe shkeljeve ligjore në fushën e prokurimit publik, disa prej të cilave janë publikuar edhe në hulumtim.
- Tryezë diskutimi: është parashikuar të mbahet në fund të projektit me qëllim të prezantimit të analizës/hulumtit, video-dokumentarit dhe aktiviteteve tjera të cilat janë realizur në kuadër të projektit.

Projektet e aprovuara në fund të 2018, e që do të implementohen gjatë vitit 2019:

BIRN: Dosja “Sa Han Shefi”

“Sa Han Shefi” ka pasur një sukses dhe interesim mjaft të madh të publikut, ku shpenzimet e qeveritarëve kosovarë janë publikuar, të gjitha të bazuara në qindra fatura të siguruar nga BIRN. Qëllimi i këtij projekti është avancimi i llogaridhënies për shpenzimin e parasë publike dhe rritja e transparencës në nivel lokal për shpenzimet e parasë publike. Në zgjedhjet e fundit lokale BIRN ka kërkuar nga kryetarët e komunave të publikojnë faturat e shpenzimeve me paratë e buxhetit. Një pjesë e madhe e tyre janë zotuar se të njëjtat do t’i publikojnë ose do krijojnë qasje për shoqërinë civile. Kjo ka krijuar një obligim publik për krerët e komunës i cili do garantojë qasje në publik. Projekti aktual i BIRN ka për qëllim të bëjë publike shpenzimet e krerëve të komunave. Projekti realizohet gjatë pjesës së parë të vitit 2019.

Instituti Riinvest: TEM – Tema Ekonomike e Muajit

Projekti, që zbatohet në vitin 2019, synon të krijojë një hapësirë - platformë - për një debat domethënës e të angazhuar për të shfrytëzuar burimet dhe kompetencat e tij por edhe të ekonomistëve më të njohur. TEM do të debatojë rreth 8 temave/çështjeve brenda vitit dhe do të diseminojë me kanale të përshtatshme qëndrime e rekomandimet tek institucionet qeveritare dhe në opinion publik. Qëllimi i projektit është përmirësimi i politikave ekonomike nëpërmjet rekomandimeve

përkatëse nga një debat i informuar mirë dhe sistematik mbi çështjet më të rëndësishme ekonomike dhe zhvillimore.

Kosovalive: Femsamble - Grupi i Grave Asambleiste të Kosovës me gazetaret e reja nga Byroja e Vajzave GlobalGirl Media Kosova (GGM) punojnë në rritjen e vetëdijës së grave anembanë Kosovës për identifikimin e fakenews në internet, media sociale dhe në portale

Synimi i projektit është të mundësoj bashkëpunimin e Grupit të Grave Asambleiste të Kosovës dhe gazetareve të reja nga Byroja e Vajzave GlobalGirl Media Kosova të punojnë në rritjen e vetëdijës së grave anembanë Kosovës për identifikimin e fakenews në internet, media sociale dhe në portale, si dhe vlerësimin të cilësisë së lajmeve/informatave. KosovaLive, ka për qëllim të punoj në rritjen e nivelit të lexuesve, të formësoj mendësinë e tyre për rolin e tyre si lexues, kontribues, distribues, dhe konsumues të produkteve mediale. Këtë, ne do të mundohemi ta arrijmë përmes krijimit të bashkëpunimit të sektorit publik, shoqërisë civile dhe qytetarëve të rëndomtë, duke aktivizuar gratë asambleiste, anëtarët e byrosë GlobalGirl Media Kosova, mësimmhënësit dhe shkollat. Qëllimi është që t'u bëhet presion lidereve në sektorin publik që ta adresojnë çështjen e informimit dhe fakenews, dhe dezinformative dhe ta ngrisin si çështje në institucionet lokale në komunitatet e tyre.

George Williams Youth Association in Kosovo: Roli i rinisë për ndryshim social

Qëllimi i projektit është monitorimi i komunës së Gjakovës dhe Pejës në zbatimin e rregullores 04/2017 për kriteret dhe procedurat dhe standardet e financimit publik të OJQ-

ve, duke qenë se kjo drejtori është një ndër më të prekurat nga kjo rregullore dhe jep më së shumti subvencione për të trija kategoritë. Poashtu, do të punohet në hartëzimin e institucioneve që punojnë me rini në këto komuna, për t'i matur investimet direkte në dy vitet e fundit në sektorin e rinisë dhe pjesëmarrjen e tyre në proceset vendimmarrëse.

3. Lista e projekteve të organizatave të mbështetura në shtyllën e hapjes së të dhënave dhe sektorit nxjerrës dhe shpenzime tjera

Emri i Projektit	Grantist	Shuma Euro
Sfidat e prokurimit publik në komunën e Prizrenit	Ec Ma Ndryshe	9,850.00 €
Dosja “Sa Han Shefi”	BIRN	14,850.00 €
TEM – Tema Ekonomike e Muajit	Instituti Riinvest	17,010.00 €
Femsamble - Grupi i Grave Asambleiste të Kosovës me gazetaret e reja nga Byroja e Vajzave GlobalGirl Media Kosova (GGM) punojnë në rritjen e vetëdijës së grave anembanë Kosovës për identifikimin e fakenews në internet, media sociale dhe në portale	Kosovalive	8,200.00 €
Roli i rinisë për ndryshim social	George Williams Youth Association in Kosovo	9,530.00 €
	Subtotal	59,440.00 €
Shpenzime programore	Operacional	
Takim me OSF Albania	Operacional	3,252.40 €
Dizajnimi dhe shtypja e Raportit Vjetor	Operacional	2,300.00 €
Shërbime të përkthimit	Operacional	840.00 €
Furnizime të zyrës		708.40 €
	Subtotal	7,100.80 €
	Total	66,540.80 €





EDUKIMI I LARTË



EDUKIMI I LARTË

Sfidimi i Korrupsionit në Arsimin e Lartë

Është viti i dytë i realizimi të Programit Sfidimi i Korrupsionit në Arsimin e Lartë. Fokusi më i madh brenda këtij programi është mbështetja e punës të cilën e bën Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet – KITU. KITU është rrjet i OHC-ve që vepron nga fillimi i vitit 2017 dhe, deri tani, ka krijuar reputacionin e avokuesit kryesor për respektim të standardeve të transparencës, integritetit dhe llogaridhënies në arsimin e lartë. Për gati dy vjet Koalicioni ka publikuar një numër të konsiderueshëm të raporteve dhe studimeve, si dhe ka ndërmarrë hapa të tjerë vetëdijësues për çështje të ndryshme që ndërlidhen me integritetin akademik.

// Duke e lidhur punën hulumtuuese me debate të profilizuara në platforma mediale, është arritur që të përfitohet një pjesë e rëndësishme e opinionit publik në përkrahje të kërkesave që janë shtruar para zyrtarëve të Universitetit.

Misioni i KITU-së vazhdon të jetë kontributi në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhë-

nie brenda sistemit të arsimit të lartë në Kosovë dhe Universitetit të Prishtinës në mënyrë specifike. Koalicioni gjatë vitit 2018 prodhoi një sërë studimesh dhe raporte dhe ndërmori hapa të tjerë për të rritur ndërgjegjësimin për çështje të ndryshme që lidhen me integritetin akademik, i cili më në fund u bë çështje e debatit publik në Kosovë. KITU vazhdon ta ketë reputacionin e një avokati të fortë kundër të gjitha formave të abuzimit akademik dhe është i njohur si i tillë nga të gjithë aktorët relevantë në Kosovë, duke përfshirë publikun e gjerë, mediat, institucionet e arsimit të lartë, studentët dhe agjencitë qeveritare përgjegjëse.

Objektivi specifik i KITU's është nxitja e zbatimit të standardeve të transparencës, integritetit dhe llogaridhënies në sektorin e arsimit të lartë, duke zgjeruar pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile, grupeve studentore dhe subjekteve tjera në vendimarrje dhe monitorim, përmes bashkëpunimit dhe dialogut me institucionet publike.

Puna e KITU's

KITU gjatë vitit 2018 kanë qenë shumë i angazhuar në aktivitete të cilat kanë qenë reageime ndaj një procesi të caktuar, takime me hisedarë si dhe punëtori të cilat kanë pasë synim propozimet për ndryshim të Projektligjit për Arsimin e Lartë si dhe planin e veprimit të KITU's.

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA)

KITU përmes delegacionit të vet përfaqësues

në prill ka vizituar në Bruksel selinë e EQAR dhe ENQA para se të merrej vendimi për shqyrtimin e statusit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) nga asambleja e përgjithshme e ENQA. AKA nuk është përjashtuar nga ENQA, por ka dalë në statusin e anëtarit në shqyrtim.

Për t'i kontribuar shtimit të transparencës dhe besueshmërisë së procesit të akreditimit, KITU ka shprehur gatishmëri që pas funksionalizimit të AKA, të bëj monitorimin e punës së Agjencisë. Për këtë qëllim, do të lidhet një marrëveshje mirëkuptimi në mes të KITU, MASHT dhe KKC, e cila saktëson modalitetet e procesit të monitorimit. Jemi të mendimit se monitorimi i tillë do të ndikojë në rritjen e përgjegjësisë nga ana e zyrtarëve të AKA, anëtarëve të KKC, por edhe të vet institucioneve të arsimit të lartë që janë subjekt i vlerësimit. Pas emërimit të anëtarëve të ri të bordit të AKA's, anëtari i KITU's, ORCA ka filluar monitorimin e këtij Agjencioni. Së shpejti do të nënshkruhet marrëveshja e mirëkuptimit në mes të KITU's, MASHT-it dhe KKC-së.

Ndërkohë, iniciativa e MASHT-it për hartimin e ligjit të ri për AKA ka përfshirë edhe ORCA'n si anëtare e KITU's e cila po merr pjesë në hartimin e ligjit i cili pritet të votohet në Kuvend në prill-maj të vitit 2019.

Projektligji për Arsimin e Lartë

Në muajin mars është mbajtur punëtorja planifikuese e KITU's, në të cilën është shqyrtuar drafti i Projektligjin për Arsimin e Lartë - PAL. Të gjitha komentet tona të bëra në PAL janë marrë parasysh dhe janë në draftin final i cili do të shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Kosovës.

KITU punëtori planifikuese

Në shtator, KITU mbajti punëtori planifikuese për ta hartuar planin e punës së tij. Ky plan i punës është hartuar nga përfaqësuesit e Koalicionit, duke u bazuar në strategjinë afatmesme të KFOS, por edhe në strategjitë dhe planet e organizatave anëtare të tij. Qëllimi i planit është që të ofrojë një kornizë për veprimin e koalicionit brenda periudhës 2019-2021. Për t'u zbatuar në mënyrë të efektshme, krahas këtij plani të punës duhet të zhvillohen edhe plane vjetore veprimi, me të cilat përcaktohet afatet për zbatimin e aktiviteteve të caktuara, buxhetet e nevojshme për mbështetje dhe bartësit e tyre.

Një nga mësimet e nxjerra është se Koalicioni duhet të punojë me grupe të ndryshme, për të nxitur kërkesën e tyre për ndryshim. Për këtë arsye, kemi identifikuar pesë grupe të synuara për aktivitetet e Koalicionit: 1) Studentët 2) Institucionet e arsimit të lartë 3) Autoritetet 4) OSHC-të dhe dhe 5) Publiku i gjerë.

Koalicioni ka definuar katër rezultate të pritshme për periudhën vijuese: 1. Lëvizje e fuqishme e grupeve studentore dhe të stafit akademik që adresojnë çështjet e transparencës, integritetit dhe llogaridhënies në arsimin e lartë 2. Grupe të organizuara mirë dhe të përgatitura që, në mënyrë të pavarur dhe me entuziazëm ta monitorojnë arsimin e lartë 3. Vetëdijesim i shtuar i të gjitha palëve relevante për rreziqet e korrupsionit dhe nevojën e shtimit të transparencës, integritetit dhe llogaridhënies në arsimin e lartë 4. Fuqizimi i koalicionit KITU për të adresuar çështjet e transparencës, integritetit dhe llogaridhënies në arsimin e lartë.

Pjesëmarrja e KITU's

Përfaqësues të Koalicionit kanë marr pjesë në Konferencën: *Dangerous Questions: Why Academic Freedom Matters*. Kjo konferencë është organizuar nga Universiteti i Lublanës, në muajin qershor.

Reagim për OJQ Admovere

Anëtari i KITU's, OJQ Admovere është urdhëruar nga gjykata për tërheqjen e një pjese të raportit nga qarkullimi si masë mbrojtëse e padisë së një profesori. Përveç Admovere's padia është ngritur edhe ndaj Luan Shllakut, Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS. KITU ka reaguar pasi artikulli të cilit i referohet pjesa e raportit të Admoveres është publik dhe ndaj atij artikulli apo autorëve të tij asnjëherë nuk është ngritur asnjë padi. KITU e ka cilësuar këtë si cenim të lirisë së shprehjes.

Koalicioni vazhdon të jetë i hapur për të zgjeruar radhët e veta me anëtarë të rinj të cilët kane interesim për të kontribuar në fushëveprimin e Koalicionit.

Koalicioni do të vazhdojë të monitorojmë proceset e lidhura ngushtë me integritetin akademik, si promovimi i stafit akademik. Do të identifikohen dhe denoncohen praktikat korruptive në arsimin e lartë, pandershmëria akademike dhe plagjiatura. Gjithashtu, do të avokohet që Universiteti të paraqesë procedura efikase për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie dhe për të mbrojtur integritetin akademik. Për këtë qëllim janë bërë dhe do të vazhdohet mbështetja e Fondacionit për hulumtime të cilat do të sigurojnë bazën për avokim të bazuar në dëshmi, për të rritur ndërgjegjësimin mbi çështjet që lidhen me integritetin akademik dhe për të fuqizuar grupet

e studentëve për t'u marrë me çështje të tilla nga pozicioni i përfaqësuesve të klientëve.

Më poshtë janë përmbledhjet e raporteve të secilit grantist.

OJQ Admovere

Gjatë vitit 2018 organizata joqeveritare Admovere ka realizuar projektet «Stafi akademik i UP-së», «Universiteti i Prishtinës – raportet e akreditimit, revistat dhe bibliotekat», si dhe ka marrë mbështetje për zhvillimin e projektit «Profesorët përballë ligjit», në vitin 2019.

Projekti «Stafi akademik i UP-së» u realizua për gjashtë muaj, kurse raporti u publikua më 21 shtator 2018. Ky projekt kishte për qëllim evidentimin e problemeve kyçe me të cilat ballafaqohet secila njësi akademike e UP-së dhe nxjerrjen e të dhënave sa i takon përpjesës staf-studentë e studentë-hapësirë, statistikave rreth studimeve, angazhimeve tjera, plagjiaturave dhe vlerësimeve të stafit akademik. Për këtë janë zhvilluar intervista shtruese me udhëheqësit e njësive akademike dhe profesorëve kritikë brenda fakulteteve përkatëse, si dhe janë analizuar materiale si statuti i UP-së, CV-të e profesorëve, gazetatat dhe portalet relevante me temën në fjalë. Raporti i këtij hulumtimi u publikua në shqip e anglisht, kopje të të cilave u janë dërguar hisedarëve (rektoratit, dekanateve, profesorëve, etj.). Duhet theksuar se ky projekt ka pasë mbulueshmëri të madhe mediale dhe ka nxitur debat e reagime të shumta si në mesin e profesoriatit, ashtu edhe në shoqëri civile. Në këtë vazhdë, vlenë të përmendet se rezultatet e gjetjeve të raportit kanë nxitur reagimin e një profesori edhe përmes padisë, gjë për të cilën organizata vazhdon të jetë në kontekst gjyqësor me personin në fjalë.

Projekti «Universiteti i Prishtinës – raportet e akreditimit, revistat dhe bibliotekat» u realizua po ashtu për gjashtë muaj, kurse raportet u publikua më 13 dhjetor 2018. Ky projekt kishte për qëllim trajtimin e raporteve të Agjencisë Kosovare të Akreditimit (AKA) për drejtimet më të kërkuara në secilin fakultet të UP-së dhe deklaratimet e dekanëve se sa progres është arritur në zbatimin e rekomandimeve të ekspertëve të AKA-së, që nga akreditimi i fundit. Një tjetër qëllim ishte identifikimi i gjendjes në bibliotekat dhe sallat e leximit të fakulteteve të UP-së. Ndërsa qëllimi i fundit ishte shqyrtimi i revistave të fakulteteve të UP-së, ku publikohen punimet eventuale të stafit akademik. Metodologjia hulumtuese e këtij raporti përfshin shqyrtimin e raporteve të AKA-së, intervista shterruese (me udhëheqësit e njësive akademike, shefa të departamenteve, profesorë, udhëheqës të revistave dhe bibliotekiste) dhe analiza krahasuese (në mes revistave akademike shkencore ndërkombëtare dhe revistave të UP-së). Raporti u mbulua nga medime të ndryshme, duke përfshirë gazetën Koha Ditore e cila ia dedikoi një faqe promovimit të raportit, Urban FB dhe Rrokum TV, Radio Kosova, televizioni T7 përmes dy lajmeve (storieve), e me radhë.

Kurse projekti «Profesorët përballë ligjit», i cili mori mbështetje nga KFOS-i në fund të vitit 2018, është në realizim e sipër. Ky projekt ka për qëllim identifikimin e anëtarëve të stafit akademik të UP-së që kanë rënë ndesh me ligjin. Për këtë do të sigurohen të dhëna nga gjykatat e ndryshme dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, do të intervistohen udhëheqësit e njësive akademike dhe do të mblidhen prononcimet e pjesëtarëve të stafit akademik që kanë rënë ndesh me ligjin. Publikimi i këtij raporti ka për qëllim nxitjen e debatit për etikën dhe integritetin në UP, efikasitetin e sistemit

gjyqësor dhe gjendjen e përgjithshme në fushën e arsimit dhe të gjyqësorit në vend.

Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim – ORCA

Në 2017, ORCA hulumtoi edhe procesin e emërimeve të profesorëve, ku 131 kishin marrë rekomandim pozitiv nga komisionet vlerësuese, ndonëse 74 prej tyre u vlerësuan negativisht nga ORCA. Nga këta 74, 70 nuk u avancuan nga Senati i UP-së, duke ndryshuar në total gjendjen nga vitet e mëparshme kur Senati avanconte në grup profesorët pa i shqyrtuar sipas rastit.

Në vitin 2018, në procesin e avancimeve janë propozuar 199 profesorë pozitivisht nga komisionet vlerësuese. 46 prej tyre nuk i plotësojnë kriteret për avancim sipas ORCA-s, që shënon ulje nga viti 2017. Sapo të përfundojë procesi i avancimeve, ORCA do dalë me një analizë të përputhjes së vendimeve të Senatit me rekomandimet e ORCA-s. Është e rëndësishme të theksohet që përmes presionit publik dhe institucional ORCA ka arritur të zvogëlojë numrin e tentimeve të avancimeve jomeritore, nga 55% në 23%.

Një tjetër rast suksesi është operacioni për demaskim të revistave të dyshimta që formalisht i plotësojnë rregullat, nga ORCA dhe bashkëpunëtorët e saj. Operacioni “Vreshtat” arriti të demaskonte revistën International Journal of Pharmaceutical Sciences Review and Research në të cilën ORCA dërgoi një punim pa asnjë vlerë shkencore me autor (fiktiv) Dr. Rrush Kalaveshin, nga Universiteti (inexistent) i Ranillukut, punim i cili është publikuar.

Menjëherë pas publikimit mediet raportuan

për rastin, ndërkohë që ORCA dhe “Rrush Kavalashi” i kanë kërkuar Senatit të marrë masa dhe ta fus në listë të revistave të dyshimta revistën në fjalë. Si rezultat i kësaj, Senati i UP-së për herë të parë vendosi për futjen në listë të revistave të dyshimta revistën në fjalë dhe për më tepër nuk i avancoi profesorët që kanë pasur punime të publikuara në atë revistë.

Ngritja e numrit të publikimeve shkencore dhe justifikimit të titujve akademik në UP

Në vitin 2017 ORCA gjeti se 72% e stafit akademik në UP nuk i justifikonin titujt e tyre akademik. Në 2018 si rezultat i presionit dhe fushatës vetëdijësuese të ORCA-s kjo përqindje ra në 59%, duke bërë që numri i publikimeve shkencore të rritet nga 1320 në 2017, në 1735 në 2018.

Kallëzimet penale dhe ankesat

ORCA ka bërë kallëzim penal në Prokurori ndaj një profesori të UP-së për plagjiaturë dhe falsifikim të dokumenteve, në janar. Ky rast është ende nën hetime dhe nuk ka zhvillime më të reja nga ana e prokurorisë.

ORCA gjithashtu ka luftuar deklaratat seksiste të menaxhmentit të UP-së, ku me një grup studentësh dhe organizatash tjera jo qeveritare dhe studentore, kanë arritur që të shkaktojnë shkarkimin e prorektores Pustina-Krasniqi. Ky grup që përfshin ORCA-n ka parashtruar edhe kërkesa tjera, që përfshijnë kërkim faljen nga Universiteti për të gjitha rastet e ngacmimeve seksuale që nuk janë trajtuar në të kaluarën, si dhe krijimin e një komisioni hetues që do të merret me ngacmimet seksuale në të ardhmen. Një grup punues është formuar për të trajtuar këto kërkesa dhe ORCA është monitoruese e saj.

ORCA ka sensibilizuar opinionin akademik për procedurat e avancimeve dhe mënyrat e

ankimimit përmes udhëzuesit të saj për ankesë, duke u bërë kështu një adresë për palët ankuese. Deri tani 25 kandidatë kanë marrë asistencën ligjore nga ORCA.

Në mbledhjen e datës 23 korrik, Senati ka vendosur pozitivisht për të gjithë profesorët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, për të cilët ORCA ka bërë aksion duke thënë që nuk i plotësojnë kriteret; si dhe për disa profesorë nga Fakulteti Filologjisë dhe Filozofik, të cilët nuk kanë botimet e duhura sipas rregullativave në fuqi. Ky dështim i Senatit në mbrojtjen e integritetit akademik ka detyruar ORCA-n të deponojë shtatë ankesa në Inspektoratin e Arsimit për t'i shqyrtuar këto vendime.

Inspektorati i Arsimit duke vendosur pro ankesës së ORCA-s, ka anuluar rregulloren e Fakultetit të Arteve që ekuivalentonte gradën masteri i arteve me atë të doktorit të arteve.

Shkolla verore dhe angazhimi i studentëve

Në vitin 2018 ORCA ka angazhuar tre organizata studentore dhe mbi 200 studentë në kërkimin e arsimit cilësor.



Koalicioni KITU ka ndwrtuar lidhje tw frytshme me institucione dhe nisma të ngjashme rajonale si dhe me rrjete studentësh për t'i këmbyer praktikat më të mira

Shkolla verore është mbajtur nga 5 shtatori deri më 10 shtator. Në këtë shkollë ndër aktivitete të tjera janë organizuar ligjërata për: historikun e Universitetit të Prishtinës, aktivizmin studentor dhe statistika për arsimin e lartë në Kosovë nga njohës të fushave. Gjatë shkollës gjithashtu kanë prezantuar përfaqësues të Youth Educational Forum nga Maqedonia, dhe përfaqësues të Organizatës Politike nga Shqipëria.

Një raport mbi situatën e aktivizmit studentor në Kosovë është përpiluar në bazë të diskutimeve të shkollës verore.

Sukses i këtij projekti mund të konsiderohet fakti që tashmë ka studentë aktivistë në Universitet të Prishtinës, që kanë shpërndarë dijen e tyre të përfitur në shkollë verore me kolegët e tyre në fakultetet respektive. Më shumë se 50 studentë tashmë janë aktivistë të ORCA-s.

Studentët e shkollës verore pas përfundimit të saj kanë vazhduar të angazhohen në aktivizëm studentor, duke organizuar aktivitete, takime dhe një marsh përkujtimor për 1 tetor 1997 e organizuar me 1 tetor 2018. Këta studentë vazhdojnë të jenë pjesë e aktiviteteve të ORCA-s duke u angazhuar në kërkimin e arsimit cilësor.

Janë publikuar tetë analiza/raporte që ndër të tjera kanë të bëjnë me stafin akademik dhe financat e UP-së, dhe aktiviteteve të ORCA-s janë mbuluar mbi 400 herë nga mediet.

Qendra për Kurajo Politike - CPC

Qëllimi i përgjithshëm i projektit “Prej gjetjeve drejtë avansimit të politikave dhe integritetit në arsimin e lartë” është që të kontribuoj në

tejkalimin e mungesës së një dialogu mes palëve drejtë përmirësimit të cilësisë dhe integritetit shpesh të munguar në arsimin e lartë në Kosovë. Projekti ka dy objektiva: 1. Ngritjen e nivelit të bashkëpunimit mes palëve relevante në arsimin e lartë dhe 2. Ngritjen e nivelit të jetësimit të rekomandimeve nga palët vendimmarrëse bazuar në gjetjet e hulumtimeve të viteve të fundit realizuar nga shoqëria civile.

Konsiderohet që objektiva e parë është duke u arritur vetëm pjesërisht për shkak të faktorëve të jashtëm, të cilët nuk mund të kontrollohen nga CPC, meqenëse një pjesë domethënëse e stafit akademik të Universitetit të Prishtinës (UP) heziton seriozisht, deri në bojkotim, të tryezave që synojnë ofrimin e një forumi dialogues mes palëve, staf akademik, shoqëri civile, etj. Rrjedhimisht, me qëllim të maksimizimit të mundësive për arritjen e objektivave, aktiviteteve të projektit është provuar të ju përshtaten rrethanave. Edhe pse paraprakisht ishin planifikuar 3 tryeza me të gjitha palët e interesit, pas mbajtjes së tryezës së parë, takimi i dytë është mbajtur në formë të një fokus grupi me staf akademik të UP-së.

Në UP mungojnë plotësisht organizimet e diskutimeve mes stafit akademik për çështjet që lidhen me integritetin, etikën dhe kërkimet shkencore. Organizimi i diskutimeve të tilla konsiderojmë se është një ndër të arriturat e projektit. Diskutimi në fokus grupin e mbajtur në 27.11.2018 ishte shumë dinamik, ku stafi akademik diskutoi çështjet normative dhe paraqiti një pasqyrë mbi gjendjen e implementimit të tyre bazuar edhe në përvojat personale. Takimi i tretë planifikohet të mbahet në janar/shkurt 2019 në Fakultetin Filozofik, UP me qëllim diskutimi përfundimtar të gjetjeve të hulumtimit.

Gjithashtu, e arritur e projektit konsiderohet

edhe studimi cilësor dhe gjithëpërfshirës që është duke u përgatitur nga CPC, titulluar “Dialog mes të shurdhërve: Integriteti akademik në Universitetin e Prishtinës”. Në studim janë duke u analizuar çështjet e etikës dhe integritetit në UP, çështjet e kapaciteteve hulumtuese si dhe ato të avancimeve të stafit akademik në UP. Të dhënat e prezantuar dhe të analizuar në këtë studim bazohen në: a) një analizë të përmbajtjes së të gjitha dokumenteve që rregullojnë çështjet e etikës dhe integritetit akademik në UP; b) krahasimin e këtyre dokumenteve me dokumente të tjera që rregullojnë çështjet e integritetit në nivel evropian; si dhe c) të dhënat e prezantuar nga një tryezë e diskutuese si dhe dy fokus grupe të organizuar nga CPC.

Studimi në fund paraqet një listë rekomandimesh me hapa konkret dhe të nevojshëm që do të duhej të ndërmerreshin me synim të ngritjes së integritetit akademik në UP.

Qendra për Arsim e Kosovës - KEC

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte që të mësohet më shumë për perceptimet e studentëve lidhur me cilësinë akademike dhe gjendjen e përgjithshme në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”. Në hulumtim kanë marr pjesë 1,492 studentëve nga të gjitha njësitet akademike, për të vazhduar pastaj me intervista në grupe fokusi të përbëra prej studentëve, si dhe me intervista individuale me persona që nuk janë studentë, por që kanë njohuri të mirë për gjendjen në Universitetin e Prishtinës. Të gjeturat kryesore të hulumtimit janë:

Organizimi i procesit mësimor. - Orari mësimor kryesisht shpallet me kohë, ndërkaq

të dhënat për rregullsinë e stafit akademik ndryshojnë sipas njësisë akademike. Një numër i konsiderueshëm i studentëve të anketuar (37.2%) raportojnë se ka lëndë ku më shumë se gjysma e ligjëratarëve, mbahen nga asistentët, në vend të profesorëve. Dukuria e plotësimi të listave të pranisë së profesorëve për qëllim të realizimit të pagesave, edhe pa i mbajtur fare orët, nuk është e pazakonshme. Cilësia e mësimdhënies dhe të nxënies. - Nga sondazhi del se studentët janë, në përgjithësi, të kënaqur me cilësinë e ligjëratarëve dhe ushtrimeve, por kjo demantohet, në masë të madhe, nga intervistat e thelluara. Sipas fjalëve të studentëve, ajo që u mungon ligjëratarëve në UP është ndërveprimi i stafit akademik me studentët. Mbi 65% e studentëve të anketuar konsiderojnë se profesorët ju ofrojnë “shumë “ ose “mjaft” hapësirë për të qenë aktivë në ligjëratat. Nga intervistat individuale dhe në grupe fokusi ku, pothuaj se, të gjithë bashkëbiseduesit pajtohen se studentët nuk janë shumë të përgatitur ose të vullnetshëm për ndërveprim gjatë ligjëratarëve dhe ushtrimeve, përkundër që arsyet për këtë mungesë të gatishmërisë i shohin ndryshe.

Literatura. – Në të shumtën e rasteve profesorët rekomandojnë vetëm literaturë në gjuhën shqipe. Me ndonjë përjashtim, studentët e intervistuar nuk shprehen kundër shfrytëzimit të literaturës në gjuhën angleze; përkundrazi, i vlerësojnë profesorët që ju rekomandojnë literaturë të tillë. Materialet alternative, siç janë sllajdet dhe dispensat, si burime të vetme të literaturës vazhdojnë të shfrytëzohen nga një numër i konsiderueshëm i profesorëve, edhe pse nuk mund të thuhet se ata përbëjnë shumicën e stafit akademik. Puna praktike. - Puna praktike vazhdon të jetë pikë e dobët e programeve studimore në Universitetin e Prishtinës. Një formë e shpërfaqjes së kësaj dobësie është mosinformimi

i studentëve për punën praktike si pjesë e programit mësimor. Dobësia tjetër ka të bëjë me shkallën dhe cilësinë e realizimit të punës praktike. Të intervistuarit pajtohen se puna praktike gjatë studimeve është e mangët ose nuk realizohet fare. Puna praktike mungon edhe në ato fusha ku shpenzimet për organizimin e saj do të ishin relativisht të ulëta, siç janë shkencat shoqërore dhe humane. Si arsye kryesore për mungesën e punës praktike shihet shpërputhja e madhe në mes të numrit të studentëve dhe të stafit akademik, e cila e bën të pamundur organizimin e punës praktike. Arsyeje tjetër është mungesa e interesimit tek stafi akademik.

Vlerësimi i studentëve dhe sfidat e vlerësimit.

- Shumica e të intervistuarve konsiderojnë se sukcesi i studentëve nuk është rezultat i punës së tyre, si për shkak të prezencës së lartë të kopjimit, ashtu edhe për shkak të mënyrës së vlerësimit nga ana e profesorëve. Për vlerësimin e vazhdueshëm ose raportohet se nuk ekziston ose se është me mangësi serioze. Një prej mangësive është mosmbajtja e kolokuiumeve që parashihen me planprogram. Kryesisht, nota e studentit varet nga vlerësimi përfundimtar. Përsëritja e testeve me pyetje kryesisht të ngjajshme nga afatet e kaluara të provimeve raportohet nga më pak se 68% e studentëve të anketuar dhe konfirmohet përmes intervistave në grupe fokusi dhe intervistave me bashkëbiseduesit jostudentë. Kjo shihet si një faktor ndikues në rezultatin joreal të vlerësimit të studentëve.

Dukuria e kopjimit në provime vazhdon të jetë mjaft e përhapur në mesin e studentëve të UP. Rreth 80% e të anketuarve e konfirmojnë këtë, ndërsa 55% e të anketuarve konsiderojnë se në kopjim përfshihen “një numër i madh” ose “rreth gjysma” e studentëve. Të gjithë bashkëbiseduesit, në një mënyrë ose tjetër, e pranojnë se kopjimi konsiderohet “si

aftësi dhe jo si vlerë shoqërore-morale e pa-pranueshme”. Masat ndëshkuese për ata që kopjojnë reduktohen në largimin nga provimi dhe, aty-këtu, ndonjë inicim të procedurës disiplinore, pa rezultat të qartë të saj.

Përfaqësimi studentor. - Studentët nuk janë aktivë në organizatat studentore – këtë e pohojnë 95% të pjesëmarrësve në sondazh. Në përgjithësi, ekziston një perceptim negativ për punën e organizatave studentorë. Kjo nuk vërehet aq shumë nga sondazhi, por del në pah nga intervistat e zhvilluara. Përfaqësuesit studentorë e pranojnë se studentët kanë shumë pak njohuri për punën e organizatave të tyre dhe veprimin e tyre brenda organeve të universitetit.

Organet drejtuese dhe raportet brenda UP.

- Kur bëhet fjalë për raportet në mes të studentëve dhe personelit akademik, shumica e të anketuarve shprehen se ato janë “shumë të mira” ose “të mira” – 75.5% për raportet “profesor-student” dhe 81.8% për raportet “asistent-student”. Shumica e studentëve janë mjaft të kënaqur me punën e shërbimeve të administratës në njësi akademike, ndërsa akoma më të kënaqur me funksionimin e SEMS-it. Vlerësimi i studentëve për punën e organeve drejtuese të niveleve të ndryshme është mesatar, ndërsa rëndom është më i mirë për ato organe që për kah natyra e punës janë më afër studentit, p.sh. notë më të lartë merr departamenti në raport me rektorin ose Këshillin Drejtues.

Hulumtimi lidhur me politizimin e universiteteve publike në Kosovë

Kosova aktualisht ka shtatë universitete publike, gjashtë prej të cilave janë themeluar pas

shpalljes së pavarësisë. Më përjashtim të Universitetit të Prishtinës, që të gjitha janë themeluar më vonë: Universiteti i Prizrenit (në vitin 2010), Universiteti i Pejës (në vitin 2011), Universiteti i Gjilanit, Mitrovicës dhe Gjakovës (në vitin 2013), dhe Universiteti i Ferizajit (në vitin 2015).

Për analizimin e lidhjeve partiake të strukturave udhëheqëse të shtatë universiteteve publike në Kosovë (të Prishtinës, Pejës, Gjakovës, Prizrenit, Mitrovicës, Gjilanit dhe Ferizajit), janë marrë për bazë listat zgjedhore përgjatë viteve 2000 deri më 2017, në nivel lokal dhe qendror, raportimet e mediave dhe dokumente tjera relevante që mbështesin pozitat e tyre politike ndër vite.

Nga 86 zyrtarët e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" të cilët kanë qenë subjekt i analizës në këtë hulumtim, ka rezultuar se 20 syresh ose 23% kanë qenë ose ende janë të lidhur me ndonjë parti politike aktive ose jo aktive. Në struktura udhëheqëse, prinë LDK me shtatë persona që kanë pasur lidhje ose ende kanë lidhje me këtë parti. Tutje, pason AAK dhe PDK me nga pesë, përkatësisht katër anëtarë. Nga një anëtar e kanë AKR, NISMA, PSHDK dhe KDTP. Menaxhmenti i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" ka rezultuar si më i prekuri nga njerëzit me lidhje partiake, sidomos Këshilli Drejtues. Në nivel të fakulteteve, prinë Fakulteti Filozofik ndërsa nuk është evidentuar ndonjë rast në përbërjen aktuale drejtuese të fakulteteve siç janë: Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Fakulteti i Arteve.

Në Universitetin e Pejës janë hulumtuar 25 zyrtarë që përbëjnë strukturën udhëheqëse të Universitetit "Haxhi Zeka". Janë vrojtuar nga afër Rektori, Prorektorët, Sekretari,

anëtarët e Këshillit Drejtues, Senatorët dhe Dekanët. Prej këtyre 25 zyrtarëve, 8 në një formë ose tjetër, kanë pasur lidhje ose ende kanë me ndonjë parti politike. Në UPHZ, me më së shumti zyrtarë që kanë qenë të lidhur ose ende janë, prinë PDK me tre. Me nga dy kanë AAK dhe LDK, ndërsa AKR me një. Në UPHZ, organi më i prekuri nga njerëzit e lidhur aktualisht ose nga e kaluara me ndonjë parti politike është rektorati.

Në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani" (UGJFA), po ashtu janë analizuar të gjithat strukturat udhëheqëse, Rektori, Prorektorët, Dekanët, Sekretarja, Senatorët, Dekanët dhe Udhëheqësit e Programeve. Në krahasim me UPHZ dhe UPHZ, UGJFA qëndron më pak i prekuri nga lidhjet politike në strukturat e saj udhëheqëse. Është evidentuar se nga 24 zyrtarë të hulumtuar, vetëm katër prej tyre kanë pasur, ose vazhdojnë të kenë lidhje me ndonjë parti politike. Ndër tjera, ata janë pjesë e Rektoratit ndërsa për dekanët dhe udhëheqësit e programeve nëpër fakultete nuk është evidentuar ndonjë lidhje partiake. Sidoqoftë, në UGJFA, Këshilli Drejtues dhe Rektorati janë organet barabarësisht të prekura nga njerëzit që kanë pasur lidhje, ose ende kanë me ndonjë parti në vend.

Për hulumtimin e strukturave udhëheqëse të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" (UPUH), janë analizuar 28 zyrtarë, duke filluar nga Rektori, Prorektorët, Sekretari, Këshilli Drejtues, Senatorët, Dekanët dhe Prodekanët. Nga 28 syresh, janë identifikuar shtatë prej tyre ose 25% si të lidhur aktualisht ose në të kaluarën me ndonjërin prej partive politike në vend. Sikurse në universitetet e lartpërmendura, edhe në UPUH organi më i prekuri është Rektorati, përkatësisht Këshilli Drejtues, ndërsa partia që dominon ka rezultuar se është PDK

me tre anëtarë. Në anën tjetër, nga një anëtar me lidhje aktuale partiake ose nga e kaluara janë partitë: VAKAT, NISMA, AAK dhe LDK.

Në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (USHAF), sikurse me metodologjinë e aplikuar në universitetet tjera, për lidhje partiake janë shqyrtuar nga afër Rektori, Prorektorët, Sekretari, Këshilli Drejtues, Senati dhe Dekanët. Nga 22 zyrtarë të hulumtuar, ka rezultuar se gjashtë syresh ose 27% aktualisht kanë lidhje me ndonjë parti ose kanë pasur lidhje në të kaluarën. Në USHAF, dominimin më të madh në struktura udhëheqëse e kanë AKR dhe PDK me nga dy persona që kanë pasur lidhje ose ende kanë me këto parti. Me nga një anëtar me lidhje aktuale ose nga e kaluara me aksh partinë politike, janë LDK dhe PSHDK. Sa i përket fakulteteve, nuk janë evidentuar ndonjë lidhje të dekanëve me ndonjë parti politike.

Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka” (UGJKZ), si mostër për hulumtimin e strukturave udhëheqëse ka pasur 25 zyrtarë, përfshirë Rektorin, anëtarët e Këshillit Drejtues, Senatin dhe Dekanët. Prej 25 të hulumtuarve, 5 syresh apo 20% të kësaj përbërje. Ngjashëm me universitetet e sipërpërmendura, edhe në USHAF dominojnë persona që në të kaluarën ose aktualisht kanë lidhje me AAK, dhe në total janë dy. Me nga një person që në të kaluarën ose aktualisht kanë lidhje partiake pasojnë PDK, NISMA dhe LDK.

Në strukturat udhëheqëse të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB), situata qëndron ndryshe për dallim prej universiteteve tjera. Nga 33 zyrtarë të hulumtuar, 8 prej tyre ose 24% janë me lidhje partiake aktuale ose që kanë pasur lidhje partiake në të kaluarën. Shtatë prej tyre janë anëtar, përkrahës aktual ose nga e kaluara të PDK, përveç njërit që është

të ose ka qenë i lidhur me LDK. Pas vrojtimit të kujdesshëm të Rektoratit, Këshillit Drejtues, Senatit, Prodekanëve dhe Dekanëve, organi më i prekur nga ky politizim ka rezultuar Rektorati.

Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet – ÇOHU!

Metodat e mangëta të vlerësimit

Hulumtimi ka trajtuar mënyrën e vlerësimit të studentëve në Universitetin e Prishtinës. Hulumtimi tregon se pavarësisht rregullimit statutor, shumica e studentëve në UP vlerësohen vetëm me anë të provimit përfundimtar. Kjo mënyrë vlerësimi përbën shkelje të Statutit të Universitetit duke penalizuar në mënyrë direkte studentët.

Pavarësisht që është filluar të përdorën metoda të punës si punimi seminarik apo prezantimi, ato rrallëherë kanë hyrë si formë e vlerësimit sepse zakonisht profesorët nuk i kontrollojnë ato dhe nuk i kthejnë prapa me komente te studentët.

Fokusi i hulumtimit ka qenë i përqendruar në fakultet Juridik, Ekonomik dhe Filozofik, për arsye se këto drejtime kanë numër më të madh të studentëve.

Ekipi i Preportr ka dalë në terren nëpër këto fakultete dhe ka mbledhur të dhëna nga profesorë e studentë për të parë se cilat forma të vlerësimit përdorën dhe sa janë të dobishme. Hulumtimi tregon se metodat aktuale të vlerësimit nxisin edhe dukurinë e kopjimit. Fakti se kalimi ose rënia nga provimi përcaktohet në 45 minuta krijon prirje për të kopjuar dhe për ta “hequr qafe” atë provim.

Gjithashtu kemi biseduar edhe me disa studentë dhe ata kanë deklaruar se vetëm disa nga profesorët e përdorin vlerësimin sistematik dhe se shumica vlerësimin e bëjnë me provimin përfundimtar.

Në kuadër të këtij hulumtimi është realizuar edhe një dokumentar i shkurtër.

UP-ja në dorë të bashkëpunëtorëve të jashtëm

Hulumtimi ka trajtuar mungesën e theksuar të stafit akademik në Universitetin e Prishtinës. Në disa fakultete të këtij Universiteti gati gjysma e mësimit janë bashkëpunëtorë të jashtëm.

Duke marrë parasysh që profesorët e angazhuar, apo siç quhen bashkëpunëtorë të jashtëm, e kanë një punë të rregullt, kjo nënkupton që ajo punë është prioriteti i tyre dhe mësimit në UP është sekondare. Kjo ndikon në pjesëmarrjen e tyre në ligjëratat dhe në cilësinë e mësimit në përgjithësi.

Statistikat që i kemi siguruar për vitin akademik 2017/2018 tregojnë se numri i profesorëve të angazhuar apo i bashkëpunëtorëve të jashtëm vazhdon të jetë i madh. Sipas këtyre të dhënave, në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike 41 profesorë janë me statusin e të angazhuarve, ndërsa 32 janë të rregullt. Në Fakultetin e Ndërtimit dhe Arkitekturës 39 profesorë janë të angazhuar, ndërsa 41 janë të rregullt. Në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe të Sportit numri i profesorëve të angazhuar është 21, aq sa është edhe numri i profesorëve të rregullt. Në Fakultetin e Arteve 78 profesorë janë të angazhuar, ndërsa 79 janë të rregullt.

Mungesa e stafit të rregullt rrezikon mbylljen e disa programeve në UP.

Tani për tani UP nuk ka plan se si do të dilte nga kjo situatë.

Universiteti si fushatë

Hulumtimi e ka trajtuar gjendjen e gjashtë universiteteve publike në Kosovë. Preportr ka dalë në terren dhe për së afërmi e ka parë gjendjen në këto universitete të cilat janë hapur këto pesë gjashtë vitet e fundit pa ndonjë strategji dhe plan. Në të gjitha ka probleme të theksuara me mungesë të stafit, ka ndërhyrje të mëdha politike në to, ndërkohe që MASHT po kërkon profilizimin e tyre.

Pasi janë universitete të reja ato përballen me probleme të shumta që nga ndërhyrjet politike, ndërhyrjet në punësime po edhe mungesa e stafit, i cili staf as për së afërmi nuk i ka plotësuar kushtet. Preportr ka gjetur se në këto universitete mësimit kanë dhënë profesorë me notë pak më të lartë se gjashtë, të drejtimit jo përkatës dhe me studime baçelor. Hulumtimi e ka trajtuar edhe lidhjen që stafi menaxhues i tyre e ka me partitë politike. Të dhënat tregojnë se një pjesë e madhe e tyre kanë qenë ose janë ende pjesë e partive politike, disa madje kanë ushtruar postet më të rëndësishme politike dhe publike në vend.

Demokracia për Zhvillim - D4D

Në raportet e vitit 2018, është raportuar mbi aktivitetet e organizuara nga Instituti D4D, që nga fillimi i projektit: salloni me pjesëmarrjen e disa anëtarëve të koalicionit dhe reagimi i shpejtë, sipas planit fillestar të projektit. Gjithashtu është raportuar lidhur me përfundimin e analizës së hartuar nga D4D, përkatësisht, Funksionimi KD të UPHP, analizë e punës dhe vendimeve. Procedimi tutje sipas planit të ak-

tiviteteve është vonuar sa i përket publikimit të 2 analizave dhe publikimit të editorialeve, për shkak të mospergjigjes së menaxhmentit të UPHP-së karshi kërkeses sonë për qasje në mbledhjet e KD-së.

Instituti D4D gjatë periudhës kohore qershor-dhjetor 2018, ka vazhduar aktivitetet e saja në kuadër të projektit të financuar nga KFOS, (Rritja e transparencës dhe llogaridhënies në UPHP. Monitorimi i cilësisë së vendimeve të Këshillit Drejtues të UPHP. Aktivitetet në këtë periudhë kohore janë fokusuar tek pjesa e avokimit përmes takimeve me menaxhmentin e UPHP-së, dhe takimeve me anëtarët e këshillit drejtues.

Gjatë periudhës korrik-dhjetor 2018, D4D ka paraqitur dhe proceduar dy kërkesa zyrtare lidhur me pjesëmarrjen në cilësinë e organizatës monitoruese të takimeve të KD të UPHP-së. Kërkesat janë dorëzuar dhe protokoluara tek administrata e rektoratit të UPHP-së.

Përkunder procedimit të kërkesave nga D4D gjatë muajve korrik dhe shtator të vitit 2018, ende nuk kemi marrë përgjigje lidhur me lejimin ose je të monitorimit të mbledhjeve të KD të UPHP-së.

Gjatë vitit 2018, Instituti D4D ka vazhduar me takimet avokuese me menaxhmentin e rektoratit të UPHP, duke avokuar lidhur me çështjet e rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së UPHP-së me fokus të veçantë tek këshilli drejtues i UPHP-së.

Gjithashtu janë zhvilluar takime me disa prej anëtarëve të KD të UPHP-së dhe gjithashtu edhe me rektorin e universitetit, duke trajtuar temat e funksionimit, transparencës dhe llogaridhënies së organeve drejtuese të UPHP-së. Në të gjitha takimet avokuese të zhvilluara

nga D4D me akteret e arsimit të lartë në Kosovë janë shprehur publikimet, analizat dhe gjetjet e Institutit D4D.

Deri në fund të projektit kanë mbetur:

- Hartimi dhe publikimi i dy analizave të shkurtra lidhur me transparencën dhe llogaridhënien e Këshillit drejtues të UPHP-së
- Seria prej 6 editorialeve që fokus kanë çështjet që dalin nga gjetjen e monitorimit të KD
- Organizimi i dy salloneve të së martës .

BIRN

Projekti “Gazetaria hulumtuese në arsimin e lartë” ka 2 faza dhe përmban: punëtori, bursë/fellowship për hulumtim, avokim dhe monitorim të institucioneve përmes mbulimit mediatic. Të gjitha aktivitetet e reforcjnë njëra tjetrën për të fuqizuar gazetarët aktualë dhe ata që aspirojnë të merren me gazetari hulumtuese në arsim të lartë, dhe në të njëjtën kohë përmes rritjes së raportimit dhe hulumtimit, dhe rritjen e transparencës në proceset e rregullta në arsimin e lartë.

Duke u bazuar në aktivitetet e parapara, BIRN Kosova deri më tani ka arritur të kryejë këto aktivitete:

Faza 1: Punëtorja “Gazetaria hulumtuese për arsim të lartë në Kosovë: Sfidat dhe mësimet” Punëtorja është mbajtur më 6-8 Korrik, 2018 në Durrës, Shqipëri. Pjesë e punëtorisë kanë qenë 15 gazetarë nga media të ndryshme të Kosovës si: Ngadhajim Avdyli - Kosova 2.0, Edona Musa – RTK , Albert Ahmeti – Zeri , Besa Kalaja - Preportr, Arben Ahmeti – TV Dukagjini, Shkelqim Hysenaj - REL, Bensik Krasniqi – Koha Ditore, Lira Klaiqi – Gazeta Monitor, Albulena Nuha – RTV 21, Dafina Jegeni – Klan Kosova, Drita Vitia – Radio Kosova,

Teuta Gashi - Kosovapress, Serbeze Haxhij – Radio Kosova, Plator Gashi – Prishtina Insight dhe Doruntina Baliu – KALLXO.com. Pjesë të panelit kanë qenë: Ministri i Arsimit të Kosovës Shyqiri Bytyci dhe Ministrja e Arsimit të Shqipërisë, Lindita Nikolla të cilët diskutuan për gjendjen e arsimit dhe për marrëdhëniet e bashkëpunimit e këtyre dy vendeve për të ngritur cilësinë e arsimit. Gjithashtu, pjesë të panelit ishin edhe Artan Fuga – akademik dhe publicist nga Shqipëria dhe Dukagjin Pupovci – educator dhe ekspert arsimit nga Kosova të cilët diskutuan për cilësinë e universiteteve në të dy vendet ku sipas tyre, kualiteti i arsimit në Kosovë e Shqipëri po kalon në një kohe krizë pasi që diplomat e arsimit të lartë po shiten në formë të produktit, duke bërë vetë arsimin një lloj biznesi përfitues.

Punëtorja vazhdoi me diskutimin dhe prezantimin e profesor Gazmend Lubotenit dhe prof. Vjollca Krasniqi nga Agjencia e Kosovës për Akreditim të cilët folën për çështjet si akreditimin e universiteteve dhe cilësinë e tyre me temën “Akreditimi dhe sigurimi i kualitetit”.

Në pjesën e dytë të punëtorisë, gazetarët si Besa Kalaja - Preportr; Besnik Krasniqi - Koha Ditore, & Rron Gjinovci - ORCA patën mundësinë të prezantojnë rreth temës “Raportimi dhe hulumtimi në arsim: raste specifike”

Në ditën e dytë, kryeredaktori i KALLXO.com, Kreshnik Gashi mbajti punëtori rreth temës “Raportimi etik dhe qasja në dokumente për arsim” dhe më pas, Visar Prebreza, redaktor në Gazeta Jeta në Kosovë mbajti trajnimin me temën “Monitorimi i prokurimit në arsim”.

Në pjesën e dytë të punëtorisë, gazetarët e perzgjedhur për këtë punëtori patën rastin të diskutojnë për raportimin dhe hulumtimin rreth temave për arsim të lartë. Ata gjithashtu diskutuan idete e tyre rreth arsimit, të cilat do

t’i trajtonin në hulumtimet/artikujt e tyre për të cilat edhe do të fitojnë bursë.

Faza 2: Bursa për gazetari hulumtuese, raportim & avokim (qershor 2018- janar 2019)
Pjesë e aktivitetit ka qenë angazhimi i 15 gazetarëve në hulumtime rreth arsimit. Deri më tani, janë publikuar 12 artikujt në KALLXO.com dhe në mediumet ku këta gazetarë punojnë. Ndërsa artikujt e mbetur, pra 3 prej tyre, do të publikohen së shpejti.

Duhet cekur se gazetarët kanë qenë nën monitorimin e redaktorëve të BIRN Kosova, më saktësisht të Kreshnik Gashi dhe Visar Prebreza të cilët kanë ndihmuar gazetarët rreth hulumtimeve të tyre, duke iu dërgu komente e sygjerrime rreth temave të tyre.

Kosovo 2.0

Projekti “Në thelb: rreth arsimit” është mbështetur në fund të vitit 2018 dhe ka për qëllim publikimin e një monografie rreth çështjes së arsimit. Kosovo 2.0 përmes këtij projekti synon të arrijë tek të gjithë qytetarët e Kosovës, mirëpo vëmendje të veçantë do të kenë rinia, respektivisht grupmoshat 18-34, të cilët janë studentë aktivë, ose kanë përfunduar studimet rishtazi.

Rrjeti i Radiove për të Drejtat e Njeriut – RDN

Qëllimi kryesor i projekti medial “Është edukimi juaj - të gjithë jemi përgjegjës për një sistem arsimor më të mirë” është vetëdijesimi/informimi dhe ndërgjegjësimin i studentëve, profesorëve, stafit akademik, personelit administrativ si dhe fuqizimi i tyre për të luftuar Universitetin joefikas dhe të korruptuar. Ky projekt është mbështetur në fund të vitit

2018 dhe do të realizohet gjatë vitit 2019.

duke u bazuar në rekomandimet e nxjerra nga Hulumtimi i percepcioneve të korrupsionit. Projekti do të realizohet gjatë vitit 2019.

Iniciativa për Inovacione Sociale Zveçan

Projekti “Perceptioni i korrupsionit në arsimin e lartë në gjuhën serbe, në Kosovë” do të realizohet në Universitetin e Mitrovicës dhe ka për qëllim avokimin ndërmjet përfaqësuesve të institucioneve të arsimit të lartë për të krijuar mekanizma për ta luftuar korrupsionin

1. Lista e granteve dhe shpenzimeve tjera

Emri i Projektit	Grantist	Shuma Euro
Rritja e transparencës dhe llogaridhënies akademike në Universitetin e Prishtinës	ORCA	6,900.00 €
Planprogramet në UP	OJQ Admovere	22,920.00 €
Perceptimi i studentëve për cilësinë e studimeve dhe gjendjen e përgjithshme në UP	Qendra per Arsim e Kosovës - KEC	7,440.00 €
Pjesëmarrja në Konferencën: Dangerous Questions: Why Academic Freedom Matters	Rron Gjinovci, Rinor Qehaja, Arton Demhasaj	2,433.00 €
Gazetaria Hulumtuese në Arsimin e Lartë	BIRN	26,400.00 €
Shpenzime të punëtorisë së BIRN-it	Operacional	5,812.00 €
Shkolla Verore për Angazhim Studentor	ORCA	26,550.00 €
Prej gjetjeve drejtë avansimit të politikave dhe integritetit në arsimin e lartë	Qendra për Kurajo Politike	21,747.00 €
Rritja e Transparencës dhe llogaridhënies në UPHP. Monitorimi i cilësisë së vendimeve të Këshillit Drejtues të UPHP	Demokraci për Zhvillim – D4D	8,760.00 €
Hulumtim – Politizimi i Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë në Kosovë	Qendra per Arsim e Kosovës - KEC	12,990.00 €
Profesorët përballë ligjit	OJQ Admovere	22,750.00 €
Në thelb: Rreth arsimit	Kosovo Glocal	9,890.00 €
Perceptimi i Korrupsionit në Arsimin e Lartë në gjuhën serbe, në Kosovë	Inicijativa za Drustvene Inovacije, Zvecan	11,300.00 €

Është edukimi i juaj – të gjithë jemi përgjegjës për një system arsimor më të mirë	Rrjeti i Radiove për të Drejtat e Njeriut	4,000.00 €
	Subtotal	189,892.00 €
Shpenzime operacionale programore		
KITU takim, mars 2018	Operacional	6,851.00
KITU takim, shtator	Operacional	5,234.32 €
Takimi në ENQA dhe EQAR	Operacional	2,226.45 €
Takimi me OSFA	Operacional	2,185.47 €
Takimi i Ballkanit Perëndimor	Operacional	1,030.12 €
Shpenzime të konferencës	Operacional	455.00 €
	Subtotal	17,983.34 €
Pagesë për konsulencë	Operacional	2,262.12 €
Raporti vjetor	Operacional	2,060.00 €
Dokumentari – Mjeshtria e Kopjimit, Butterfly	Operacional	3,500.00 €
Shërbime të përkthimit	Operacional	580.51 €
	Subtotal	6,140.51 €
Furnizim për zyre	Operacional	256.40 €
	Subtotal	256.40 €
	Total	26,642.37
	Grand Total	216,534.37



RILIDHJA E MITROVICËS



RILIDHJA E MITROVICËS

Si edhe viteve paraprake, edhe viti i pestë i zbatimit të konceptit Rilidhja e Mitrovicës u përfundua me sukses; e vetmja diferencë me vitet paraprake ishin ngjarjet e shumta në skenën politike që ndodhën gjatë vitit 2018 dhe të cilat patën potencial të rrezikojnë zbatimin e mirëfilltë të konceptit. Me gjithë atë, bashkëpunimi i ngushtë dhe i besueshëm i kultivuar në vitet paraprake me shoqërinë civile, fleksibiliteti i fondacionit për të reaguar shpejt në situata të reja dhe planifikimi i mirë duke e marrë parasysh edhe situatën politike ka ndikuar që të zbatohen të gjitha aktivitetet e parapara për vitin 2018.

Bazamenti i fortë, i shtruar në ciklin e parë strategjik (2014-2017), siguroi zbatim të përgjeshëm, stabil dhe në vazhdimësi të aktiviteteve dhe iniciativave të parapara me këtë koncept. Vendosja e Qendrës së Energjisë Qytetare (CEC), intervenimi më i madh që fondacioni bëri në Veri, siguroi prezencë permanente të fondacionit në atë pjesë të vendit dhe ofroj një vend energjie, idesh dhe aksioni civil në pjesën më të tensionuar të Kosovës. Kjo qendër tani shihet si “çerdhe” e shumë nisma të OShC-ve dhe qytetarëve të veriut pa marrë parasysh nëse iniciativa është e përkrahur nga fondacioni apo donatorët tjerë. Partneritetet e lidhura më herët vetëm sa u thelluan, jo vetëm me organizatat e veriut por edhe me ato të pjesëve tjera të Kosovës të banuara me shumicë serbe. Platformat dhe iniciativat tjera që zbatohen në kuadër të këtij koncepti këtë vit u avancuan dhe stabilizuan.

Sfidat politike në 2018 ishin të shumta dhe të rënda. Vrasja e liderit politik serb, Oliver Ivanovic, në fillim të vitit ishte një nga kërcën-

imet e para për zbatim të konceptit. Frika dhe dëshpërimi i madh, pas vrasjes, i serbëve në mbarë Kosovën për një kohë të shkurtër ndërpreu gati të gjitha aktivitetet në Veri. Më pas, propozimi i dy presidentëve, të Kosovës dhe Serbisë, për korrigjim të kufijve, shkëmbim të territoreve, e të ngjashme shkaktoi huti në terren në veçanti te ata serb që jetojnë në Kosovën qendrore dhe Lindore duke i bërë ata të ndihen të braktisur dhe mendimi i tyre karshi procesit të dialogut dhe marrëveshjes përfundimtare dhe gjithëpërfshirëse në mes të Kosovës dhe Serbisë i neglizhuar. Në fund, vendosja e taksave për mallin e importuar nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina ngritën tensionet në kulm duke shkaktuar edhe trazira (demonstrata) në Veri dhe pakënaqësi të madhe të serbëve që jetojnë në vendet tjera të Kosovës duke nxjerrë në pah diferencat në mes të serbëve të Veriut me ata të Jugut dhe interesave por edhe pozicioneve të ndryshme që kanë. Të gjitha këto ndikuan në zbatim të konceptit duke orientuar e ndonjëherë edhe “dezorientuar” temat e diskutimit. Por, pika më e rëndësishme e konceptit, diskutimi dhe komunikimi, mbetën gjallë edhe në kohën e tensioneve më të mëdha.

“ Pesë vjet më pas, progresi tejkaloi pritjet tona.

Koncepti edhe këtë vit mbajti të njëjtat shtylla programore përmes të cilave vazhdoi punën në rilidhjen graduale të komuniteteve të tjetërsuara të Veriut dhe Jugut të Kosovës duke i përdorur instrumentet dhe mjetet e

njëjta por të freskuara sipas nevojave dhe zhvillimeve të komunitetit në terren dhe nivelit të komunikimit në relacion serb-shqiptarë dhe Veri-Jug. Kështu për shembull Shkolla e Integritimit Evropian u ri-dizajnuar dhe nga plan-programi i ligjëratave të nivelit bazikë dhe të avancuar mbi proceset evropiane u kalua në plan-program tematikë duke adresuar fusha specifike dhe tani në dy lokacione, në Veri dhe në Kosovën qendrore.

Platformat programore dhe të arriturat kryesore të konceptit në 2018:

Qendra e Energjisë Qytetare dhe oferta programore e saj e cila për synim ka fuqizimin dhe mobilizimin qytetarë në Veri dhe nxitjen e dialogut në mes të serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës dhe e cila zbatohet përmes partneritetit me OJQ Aktiv përbëhet nga (1) Emisioni debutues (talk show) “SporaZoom” (Marrëveshja) e cila tani është bërë një emision serioz me brend të njohur në Kosovë dhe rajon, pikë së pari për shkak se shihet si emision objektiv dhe pa censurë. Gjatë 2018 janë realizuar 16 emisione me nga 3 mysafirë në studio, të përzgjedhur ashtu që të sigurohet balansi(2) Platforma avokuese “Empirika”, e dizajnuar në bazë të Forumin 2015, është platformë që tash më njihet në komunitet por edhe nga institucionet qeveritare dhe komuniteti ndërkombëtarë dhe është bërë platformë për intervenime avokuese konvergjente të komunitetit serb për të drejtat e tyre. Hapja e zyrës ndërlidhëse në Prishtinë dhe vendosja e Empirikë në këtë zyrë ka avancuar dhe stabilizuar pozitën e saj. Kjo platformë gjatë vitit 2018 ka zhvilluar fushatat avokuese që lidhen me dokumente personale dhe ndryshimet ligjore dhe administrative që duhet bërë qeveria e Kosovës për të zgjidhur

këtë problem të rëndësishëm për integrim të komuniteteve. Fushatë tjetër për të cilën avokon Empirika është respektimi i ligjit mbi përdorimin e gjuhës dhe kualiteti i përkthimeve të dokumenteve zyrtarë të qeverisë. (3) Klubi social i Mitrovicës, i cili gjendet në përdhosen e CEC, është shndërruar në vend takim qytetarësh konstruktiv në të cilin në atmosferë joformale trajton tema serioze që prekin qytetarët, në veçanti të rinjtë. Gjatë vitit 2018 janë realizuar 20 diskutime të cilat të xhiruara mund të gjinden edhe në mediat sociale dhe në këtë mënyrë përfshijnë një auditorium edhe më të gjerë se ai i cili ishte prezent fizikisht në këto diskutime. Përveç kësaj MSC ka marr edhe një rol të rëndësishëm për realizim të diskutimeve tjera, qofshin ato të emisionit SporaZoom, të platformës Empirika apo ndonjë diskutim tjetër. MSC përmes diskutimeve të veta siguron mendimin e qytetarit i cili më pas përfshihet në studime, dhe diskutime dhe tani përpos vendit të diskutimit jo formal shërben edhe si fokus grup për matjen e trendëve të shoqërisë në Veri.

Iniciativat e bashkëpunimit (dyzimit) në mes të OShC-ve dhe mediave këtë vit trajtuan çështje të guximshme dhe sërish arritën që ta kenë qytetarin në qendër të synimeve dhe veprimeve të veta duke i përfshira ata nëpër tryeza diskutimi, debate, fokus grupe, intervista, radio e TV programe/reportazhe, etj. Nuk munguan fare temat e angazhuara, ndërsa mediat ishin gjithnjë pas OShC-ve duke hulumtuar, përcjella dhe informuar mbi aktivitetet dhe rezultatet e projekteve dhe duke realizuar reportazhe, shkrime autoriale në mediat e veta për temat e trajtuara të projekteve. E veçantë këtë vit ishte bashkëpunimi i vendosur në mes të projekteve, që ngjau me vet-iniciative të bartësve të projekteve. Në këtë mënyrë një numër i projekteve gjetën pikat e përbashkëta në mes veti dhe shfrytëzuan mundësitë e njëri

tjetrit për të amplifikuar zërin e tyre në adresim të çështjeve që trajtonin. Për shembull mund të marrim projektin i cili monitoronte gjendjen e sigurisë së përgjithshme në Veri dhe tjetrin i cili merrej me pasojat e ndotjes së ambientit në rajonin e Mitrovicës. Këto dy projekte së bashku dokumentuan dhe adresuan rastet e derdhjes së materialit helmues në lumin Ibër dhe ngritën çështjen te autoritet përkatëse. Ky është vetëm një nga disa raste të vendosjes së bashkëpunimit ad hoc dhe të pa planifikuar me projekt propozim.

Shkolla për integrim Evropian, një shtyllë tjetër programore e konceptit, e cila deri në fillim të 2018 është zbatuar vetëm në Mitrovicën Veriore, në CEC në 2018 nxjerri gjeneratën e pestë të vijuesve të saj. Numri i vijuesve me këtë gjeneratë arriti numrin prej 250 përfaqësues të vetëqeverisjes lokale, OShC-ve, institucioneve publike, mediave dhe bizneseve. Plan programi në vitin 2018 u ridizajnuar në mënyrë që të plotësoj nevojat për fusha specifike/tematike dhe siguroi prezencë në dy lokacione të banuara me serbë, në Mitrovicën e veriut dhe në Graçanicë. Këtë vit u regjistruan 70 vijues, nga 35 për grup tematikë, gjë që në mes tjerash ndikoi në përhapjen e njohurive mbi politikën specifike të BE-së dhe eksperiencave nga rajoni dhe Kosova në këto fusha. Programi i ri-dizajnuar ofroi edhe shumë më shumë mundësi interaksioni me punën e OShC-ve dhe ekspertëve të Kosovës në fushat e trajtuara dhe njohje me të thellë me proceset e reformave të Kosovës karshi integritimit evropian.

Të arriturat kryesore të konceptit në 2018 mund të konsiderohen: (1) çështjet që trajtohen përmes emisionit “SporaZoom”, platformës avokuese “Empirika”, “Klubit social të Mitrovicës” dhe projekteve të dyzimit OShC-media tani më nuk i ikin temave aktuale poli-

tike, shpeshherë të “rënda” dhe të ndjeshme, (2) pjesëmarrja e anës tjetër (shqiptarëve) si mysafirë, panelist, diskutues, etj. në iniciativat në veri tani është bërë gati e zakonshme dhe e domosdoshme, gjë që vetëm para disa viteve do të ishte konsideruar blasfemi, (3) interesimi për proceset dhe vlerat evropiane është në ngritje. Programi i ri-dizajnuar sjelli më shumë kontakte me ekspert nga Kosova dhe njohuri mbi proceset në Kosovë. Trendi anti-BE ndër serbët e Kosovës është më i ulët se para fillimit të zbatimit të EU Shkollës, por kjo ndryshon në varshmëri nga situata politike. (4) bashkëpunimi në mes të ekspertëve të Veriut dhe Jugut është ende i vogël por në rritje e sipër, shembull i mirë për këtë është projekti i mbrojtjes së ambientit dhe ai i sigurisë, por këto nuk janë të vetmit, (5) mediat serbe janë lidhur në një rrjetë dhe raportimi i tyre është bërë shumë më profesional dhe i orientuar kah ngjarjet në Kosovë.

Qëllimi dhe objektivat e konceptit në 2018

Qëllimi – rilidhja graduale e komuniteteve të tjetërsuara të Veriut dhe Jugut të Kosovës – 1. duke kultivuar një shoqëri të fuqishme civile dhe kulturë të diskutimit si mjet për zgjidhje të problemeve dhe 2. duke krijuar lidhje të reja dhe ringjallje të vjetrave në mes të grupeve qytetare, akademike, etj. të bazuara në komunitet në të dyja anët e lumit rreth çështjeve me interes të ndërsjellë për të dyja palët.

Për të arritur qëllimin e konceptit Fondacioni punoi në tri shtylla kryesore, si në vijim:

1. Nxitja dhe lehtësimi i dialogut në mes të serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës,
2. Përfshirja dhe angazhimi më i madh i OShC-ve dhe të komunitetit Serb në përgjithësi në

proceset politike dhe shoqërore të Kosovës përmes punës kërkimore dhe avokimit, 3. Ngritja e njohurive mbi parimet dhe vlerat e BE-së.

Në vazhdim jepen informata më të detajuara mbi të gjitha aktivitetet e zhvilluara përbrenda konceptit Rilidhja e Mitrovicës e ndarë sipas shtyllave kryesore të intervenimit.

1. Nxitja dhe lehtësimi i dialogut në mes të serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës

“Rilidhja” mbetet ylli jonë udhëheqës, organizatat të cilat i ka mbjellë fondacioni kanë nxitë aktivitetet civile dhe debat të paparë për gjenerata.

Nxitja dhe lehtësimi i dialogut, edhe pse synim i tërë konceptit dhe i shpërndarë nëpër të gjitha shtyllat programore, ishe në shënjestër të platformave diskutuese të realizuara në Qendrën e Energjisë Qytetare dhe në partneritet me OJQ Aktiv dhe TV Mreza, si partneri i dytë në rastin e emisionit SporaZoom. Platformat e diskutimit si Klubi Social i Mitrovicës, Empirika dhe emisioni SporaZoom u dizajnuan duke pas për bazë nevojat e grupeve të ndryshme të interesit në Mitrovicën e Veriut duke ja nisë nga të rinjtë si grup më dinamik, kërkues dhe në nevojë për aktivitetet të ndryshme; OShC-të me nevojë të veçantë për hapësirë për zbatim të aktivitetet të veta dhe platformë të fuqishme avokuese, dhe popullsia e gjerë me synim në shtresën më

intelektuale e cila ka nevojë për informacion, sfidim të perceptimit të situatës duke ofruar mendim ndryshe nga një këndvështrim tjetër.

Qendra e Energjisë Qytetare (CEC) – vendngjarja e gati të gjitha aktivitetet civile në Veri edhe këtë vit ishte vend i ideve, aksionit, edukimit, artit dhe kulturës. Gjatë vitit u realizuan më shumë se 260 aktivitetet me pjesëmarrje të afro 3.500 pjesëmarrësve të përkrahura nga fondacioni dhe donatorët tjerë. Në CEC u realizuan prezantime të studimeve, hulumtimeve; diskutimet me qytetarë lidhur me politikat lokale dhe ato qendrore, iniciativa dhe prezantime të projekteve të reja të organizatave ndërkombëtare, trajnime, kurse të gjuhëve, prova të shfaqjeve teatrale, baletit dhe një seri debatesh e diskutimesh mbi çështje politike. CEC ishte edhe vendi ku u zhvillua diskutimi me shoqërinë civile në kuadër të iniciativës së kryetarit të Serbisë “Dialogu i brendshëm mbi Kosovën”. Të gjitha aktivitetet e zhvilluara me përkrahje të fondacionit kishin mbulim të mirë në media dhe informatë të shkurtë në ueb faqen e CEC. Kjo qendër ishte investimi më i madh i fondacionit në Veri dhe si i tillë plotësoj qëllimin e vet për ringjallje të shoqërisë civile, qytetarit i cili u arrit me shumëllajshmëri dhe sasi të aktivitetet të realizuara dhe të dizajnuara që të plotësojnë nevojat e secilit grup të qytetarëve në Veri.

Gjatë dizajnit të platformave të cilat do të ndikonim në nxitje dhe lehtësim të dialogut iu kushtua rëndësi e veçanti gjetjes së formave më të përshtatshme për të plotësuar nevojat dhe interesimet e të gjitha grupet. Për të plotësuar këtë nevojë u dizajnuan tri forma të veçanta të diskutimit të cilat sipas formatit synon grupe dhe nevoja të ndryshme të dis

// Vetëm Qendra e Energjisë Qytetare mirëpret aktivitet të komuniteteve gati çdo ditë.

kutimit, informimit dhe shkëmbimit të informacionit. Gjithashtu, së bashku me partnerit tonë i cili bënë edhe menaxhimin e CEC OJQ Aktiv, u munduam që të bëjmë ndërlidhen e platformave të diskutimit ashtu që të maksimizohet efekti në shoqëri. Kështu për shembull një teme e trajtuar përmes MSC në një frymë pak më ndryshe, më të lehtë, dhe me bashkëbisedues kompetent trajtohet edhe në emisionin “SporaZoom”, ndërsa platforma “Empirika” veç e ka përgatitur studimin/hulumtimin në po atë temë dhe e ka prezantuar e diskutuar në tryeze diskutimi ndërsa rezultatet e hulumtimit përdoren për argumentim dhe në mbështetje të emisionit „SporaZoom“. Renditja e instrumentit të përdorur për diskutim të ndonjë çështje nuk është gjithnjë e njëjtë, ajo vendoset zakonisht bazuar në seriozitetin dhe rëndësinë e temës që trajtohet dhe nevojës momentale. Jo gjithnjë të gjitha temat dhe çështjet për diskutim kalojnë nëpër këtë cikël por mundohemi që secili mekanizëm i përdorur për diskutim të jetë tematikisht kompatibil me dy të tjerat.

Emisioni “SporaZoom” është produkti më i dukshëm nga paleta e aktiviteteve të cilat realizohen në qendrën CEC. Ky emision realizohet në bashkëpunim me OJQ Aktiv dhe TV Mreža (rrjet i 5 televizioneve lokale dhe një produksioni në gjuhën serbe) dhe trajton tema politike të cilat bazohen në Marrëveshjen e Brukselit në mes të Kosovës dhe Serbisë në shumicën e rasteve por jo vetëm.

Emisioni transmetohet çdo dy javë me së paku një reprizë në mes në pesë TV stacionet serbe anëtare të TV Mreža dhe në TV Mitrovica. Emisioni gjithashtu vendoset në rrjetet sociale (youtube, Facebook, Twitter) dhe ueb faqet e partnerëve të projektit. Gjithashtu, në ueb faqe vendoset edhe përmbledhja e diskutimit në formë të artikullit. Në këtë mënyre sigurohet se emisioni shihet edhe përtej Kosovës dhe arrin edhe deri te grup moshë e re e cila kryesisht informohet përmes internetit dhe platformave të ndryshme me bazë interneti.

Emisioni këtë vit pati një ekspansion pasi që kualiteti i përgjithshëm i emisioneve është ngritur për disa shkallë. Në ngritje të kualitetit ndikoj shumëllojshmëria dhe kredibiliteti i mysafirëve në studio, përzgjedhja e temave aktuale të rëndësishme për komunitetin serb por edhe mbarë Kosovën dhe më gjerë dhe cilësia e produktit si nga aspekti përmbajtësor ashtu edhe nga aspekti vizual. Që nga vit i kaluar të gjitha emisionet patëm së paku nga një përfaqësues të anës tjetër, anës shqiptare, dhe kjo tashmë është bërë rregull. Bordi redaktues i emisionit përkujdeset gjatë përzgjedhjes së temave të emisioneve që ato të jenë sa me reale, që tema e emisionit të jetë mirë e argumentuar me studime, hulumtime, analiza, që secili emision në temë të përzgjedhur të ketë balans etnik dhe politik, përfaqësim të opsioneve, frymëve dhe qëndrimeve të ndryshme politike në mënyrë që të dëgjohen të gjitha anët dhe qëndrimet dhe të mos shihet si emision i njëanshëm. I vetmi balans të cilin emisioni nuk e arriti është ai gjinor për shkak të së pari mungesës së grave në pozita vendimmarrëse dhe së dyti sepse ato shumë rrallë pranojnë të paraqiten në emisione të këtij lloji.

Gjatë vitit 2018 janë realizuar 17 emisione me nga 3-4 mysafirë në studio që përafërsisht jep rreth 60 mysafirë disa prej të cilëve disa morën pjesë më shumë se njëherë. U trajtuan tema aktuale politike, por më prezentë ishte tema rreth marrëveshjes gjithëpërfshirëse të normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, ndërprerjes së dialogut, kualitetit të zbatimit të marrëveshjeve të arritura. Mysafirë në studio në mes tjerësh ishin: Ambasadori britanik Rouri O’Connell, Bodo Weber, Agron Bajrami, Jeta Krasniqi, Besa Luci, Belul Beqaj, Rada Trajković, Dušan Janjić, Ksenija Bozovic, Florian Qehaja, Nenad Rasic, etj.

Situata në mes të Kosovës dhe Serbisë në fund të vitit arriti kulmin e tensioneve dhe si gjithnjë këto tensione ndikuan në stabilitetin e situatës në Veri. Kjo situatë ndikoi shumë në realizimin e emisioneve të fundit të ciklit dimëror të emisionit “SporaZoom”. Mysafiret e ftuar për emisionet e fundit refuzoni pjesëmarrjen për shkak të situatës së acaruar. Për ta zgjidhur këtë fondacioni sugjeroi që të kalohet në një format tjetër të realizimit të emisionit. Temat u trajtuan me dy analistë, një nga Kosova, Belul Beqaj dhe një nga Serbia, Dushan Janjiq të cilët u gjiruan në zyrat e veta duke ia shtuar atyre një numër të deklaratave të ekspertëve dhe njohësve të situatës, si Florian Qehaja lidhur me sigurinë, Augustin Palokaj dhe Dusan Gajic, korrespondent nga Brukseli të cilët komentuan situatën lidhur me propozimet për shkëmbim të territoreve, taksën mbi importin e mallit nga Serbia dhe Bosnia dhe Hercegovina, etj. nga perspektiva e Brukselit, Zhivojin Rakocevic i cili përfaqësonte pozitën e serbëve të Kosovës qendrore, Ruari O’Connell si përfaqësues të shteteve të Kuintës, etj. Në këtë format u realizuan dy emisione të fundit dhe përkundër supozimit u prit shumë mirë nga shikuesit.

Të gjitha emisionet e realizuara deri më tani mund të gjinden në kanalin e emisionit në youtube.

Sfidat karshi emisionit „SporaZoom“ në vitin 2019 janë: (1) mbajtja e kualitetit të arritur gjatë viteve të kaluara, (2) gjetja e formave adekuate për të siguruar realizim të emisioneve me kohë, përkundër tensioneve politike dhe rrezikut i cili e ndalon mysafirin e emisionit të marr pjesë fizikisht në studio në Veri, (3) identifikimi dhe përzgjedhja e mysafirëve kompetent në studio pasi që në Kosovë ekziston një kapacitet i limituar i bashkëbiseduesve për këtë lloj emisioni sidomos nga komuniteti serb, (3) ngritja dhe zhvillimi i më tejme i kapaciteteve të të angazhuarve në OJQ Aktiv dhe TV Mreza për të marrë përsipër përgatitjen përmbajtësore dhe teknike të emisionit dhe në këtë mënyrë të sigurohet qëndrueshmëria e saj, (4) gjetja e mundësive për transmetim të emisionit në ndonjë nga kanalet rajonale si psh. N1. Dhe sigurimi i transmetimit të emisionit në kanalet publike të Kosovës në RTK.

Platforma avokuese „Empirika“ është platformë avokimi e dizajnuar duke pas për bazë Forumin 2015. Në vitin 2018 OJQ Aktiv hapi zyrën ndërlidhëse në Prishtinë ku u vendosë platforma “Empirika” me qëllim që të jetë më afër vendimmarrjes. Platforma gjatë vitit u angazhua në rritje të numrit të OShC-ve anëtare të platformës dhe në gjetjen e formave më efektive të avokimit. Me zgjerim të anëtarëve të platformës u përfshinë edhe OShC-t e Kosovës qendrore dhe tani numri i anëtarëve arrin numrin nëntë gjë që këtë platformë e bënë shumë më reprezentative në aspektin gjeografik të përfaqësimit dhe më të fuqishme për nga ekspertiza. Mediat anëtare të kësaj platforme i japin fuqi depërtuese nëpër mediat e Kosovës dhe rajonit. OShC-ve dhe mediave serbe të Kosovës.

Gjatë vitit u realizuan dhe prezantuan disa studime nga anëtarët e platformës Empirika të udhëhequr nga OJQ Aktiv. Ndër studimet më relevante ishte studimi mbi perceptimin e shqiptarëve dhe serbëve ndaj njëri tjetrit, ai i analizës së trendëve të integritit të komuniteti serb në shoqërinë kosovare dhe ai mbi skenarët e ndarjes së Kosovës. Dy studimet e para u prezantuan në Mitrovicë ndërsa në Prishtinë do të realizohen gjatë muajit shkurt. Studimi i dytë do të prezantohet së shpejti në të dy qytetet. Gjithashtu, u realizua edhe një seri analizash kuantitative si ai mbi pozitën e serbëve karshi propozimit për ndarjen e Kosovës dhe/apo shkëmbimit të territoreve, mbi mundësitë e punësimit dhe perspektivës së jetës në Kosovës të të rinjve serb, analiza e quajtur “Zona e pasaportave të veçanta” që adresonte problemin e dokumenteve personale dhe aksesit që serbët e Kosovës kanë ndaj tyre. Këto dhe studime e analiza tjera mund të gjinden në ueb faqen e CEC.

Këtë vit platforma Empirika mbajti dy tryeza diskutimi në kuadër të aktiviteteve të tyre avokuese lidhur me përdorimin e gjuhës serbe në institucionet e Kosovës dhe kualitetin e përkthimeve të dokumenteve zyrtare si një prej mjeteve për integritet të komuniteti serb në shoqërinë kosovare dhe sigurim të demokracisë përmes respektimit të të drejtave të njeriut dhe respektim të ligjit në fuqi. Këto tryeza u pasuan me një numër të letrave të hapura dhe peticioneve.

Iniciativat tjera të platformës Empirika ishin letrat e hapura drejtuar institucioneve përkatëse e lidhur me taksën e vendosur për importin e mallit nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina; apel për përshpejtim dhe rinisje të procesit të dialogut; reagim në propozimet e dy kryetarëve për ndarjen e Kosovës. Këto letra të hapura dhe apele e faktorizuan edhe

më shumë platformën Empirika pikë së pari te komuniteti Serb por edhe në skenën civile të mbarë Kosovës. Kjo platformë u bë partnere edhe në disa iniciativa të OShC-ve kosovare të Prishtinës të cilët bashkërisht tentojnë të inkurajojnë OShC-të të marrin pjesë më aktive në procesin e negocimit me Serbinë dhe zhvillojnë fushata informuese për këto procese.

Një rezultat dhe tregues i mirë i integritit të ngadalshëm të komuniteti serb është edhe iniciativa e re të cilën e filloi platforma Empirika për monitorimin e punës së grupeve parlamentare të parlamentit të Kosovës. Gjatë vitit organizatat anëtare të platformës bënë monitorimin e disa prej grupeve parlamentare si që janë grupi për integritet evropian, ai për siguri, grupi i legjislacionit, etj.

Sfidë për vazhdimin e punës së platformës avokuese „Empirika“ në 2019 mund të konsiderohet: (1) pas konsolidimit dhe rritjes së numrit të anëtareve i cili ngjau gjatë 2018 platforma Empirika duhet të forcoj pozitën e vet në vendet tjera të banuara me serb, posaçërisht në Kosovën qendrore, në Graçanicë, (2) të përfshihet në iniciativa të mëdha të OShC-ve të Prishtinës në fushata informuese mbi procesin e negocimit në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe fushata avokuese duke mbrojtur dhe prezantuar pozicionin e komunitetit serb të Kosovës. (3) të gjejë forma inovative për të përcjellë porosinë deri te vendim-marrësi si psh Open 333 i fondacionit apo forma tjera, (4) krijimi i lidhjeve dhe formave më të forta bashkëpunuese me OShC-të dhe mediat në gjuhën shqipe që do të i siguronte depërtim më kualitativ të porosisë së tyre.

Klubi Social i Mitrovicës është një formë më e butë e adresimit të fushave me interes për tërë komunitetin serb me fokus të veçantë në të rinjtë. Praktika e filluar në 2017 e xhirimit të

diskutimeve dhe vendosjes së tyre në youtube dhe ueb faqen e CEC u vazhdua edhe në vitin 2018 dhe u shtua edhe një raport i shkurtër mbi tezat kryesore të diskutuara gjatë MSC. Temat e diskutimit në 2018 i përcjellën me përpikëri ngjarjet politike aq sa renditja e tyre mund të shërbejë edhe si kalendarë i ngjarjeve politike në vend. Gjatë vitit u realizuan 18 diskutime të shpërndara njëtrajtshëm nëpër vit, nga dy çdo muaj. Shumë shpesh MSC organizohej menjëherë pas apo para xhirimit të emisionit SporaZoom apo punëtorisë së EU Shkollës dhe në këtë mënyrë shfrytëzoheshin maksimalisht edhe resurset financiare dhe siguroheshin panelist të profilit të lartë dhe ekspert për këtë platformë joformale të diskutimit. Gjatë vitit të kaluar u trajtuan temat si: 10 vjet pavarësi të Kosovës - që u murrë me analizimin e ndryshimeve që ndodhën nga shpallja e pavarësisë e deri në dhjet vjetorin e saj, për këtë temë folën Sanja Sovrllic, gazetare dhe aktiviste e shoqërisë civile dhe Shpëtim Gashi kryetarë i këshillit për qeverisje inkluzive dhe Zeljko Tvrdiscic, gazetar. Mbi marrëveshjen e Brukselit dhe sa larg është kompromisi më mes të dy palëve folën Belul Beqaj, analist politikë dhe Nenad Rasic, kryetarë i Partisë Progresive të Serbëve të Kosovës. Darko Dimitrijevic anëtarë i këshillit këshillëdhënës për komunitete dhe Goran Avramovic, kryeredaktori i Kim televizionit biseduan me pjesëmarrësit se sa cilat janë arsytet e braktisjes së Kosovës nga të rinjtë serb. Një nga temat e trajtuara në MSC ishte edhe funksionimi i gjyqësorit një vit pas integritimit në sistemin e Kosovës. Për këtë folën Dusan Radakovic, drejtor i organizatës ACDC të cilët bëjnë monitorimin e këtij procesi që nga fillimi dhe Jelena Krivokapic, gjykatëse e Gjykatës Supreme të Kosovës. Propozimi i dy kryetarëve, të Kosovës dhe Serbisë për korrigjim të kufijve, shkëmbim të territoreve u diskutua në dy raste nga Marko Jaksic, bloger

dhe anëtarë i asamblesë komunale të Mitrovicës së Veriut dhe Lubomis Stanojkovic analist politik nga Shillova. Mbi transformimin e Forcave të Sigurisë të Kosovës në Ushtri folën Florian Qehaja, drejtor i Qendrës për Studime të Sigurisë të Kosovës dhe Veroljub Petronic, drejtor i Qendrës Humane të Mitrovicës. Në Prishtinë u shtrua çështja për diskutim mbi nivelin dhe mundësitë e bashkëpunimit në mes të OShC-ve shqiptare dhe serbe . Për këtë teme biseduan Naim Rashiti, Dejan Radivojevic dhe Boban Simic që të tre aktivist të shoqërisë civile.

Kjo formë e diskutimit u tregua shumë efektive në nxitje të dialogut dhe rezultoi me shumë ide të reja, rekomandime dhe nxiti shpesh iniciativa të reja për adresim të çështjeve të trajtuara. Vendosja e diskutimeve në rrjetet sociale e përhap informacionin më gjerë se vet Kosova dhe përfshiu në komentim edhe qytetare dhe aktivist nga Serbia.

Sfidë për MSC në 2019 duhet të jetë: (1) formati i MSC ende nuk është i konsumuar dhe ende është atraktiv për pjesëmarrësit por ka nevojë për një freskimi dhe shtim të ndonjë inovacion social i cili do ta bënte më atraktiv, (2) pasurim me diskutues ende të pa eksploruar, të rinj nga të dy komunitetet, gjë që do të ndihmonte edhe në plotësimin e listës për mysafirë në emisionin „SporaZoom“, (3) organizim të më shumë diskutimeve bashkëpunuese në formë të vizitave njëri tjetrit në vendet tjera të Kosovës, këtu pikë së pari mendohet në Prishtinë por adresa e dytë duhet të jetë Gračanica ku programi duhet të hapet me një numër të iniciativave.

1. Lista e granteve dhe shpenzimeve tjera:

Emri i Projektit/iniciativës	Grant marrësi	Shuma në Euro
Rritja e praktikave demokratike dhe përfshirja e qytetarëve në proceset vendim-marrëse në veriun e Kosovës	OJQ Aktiv	82,760.00
Produksioni i 16 emisioneve “Spora-Zoom” (Marrëveshja)	TV Mreza	33,960.00
Bashkëpunimi në fushën e artit vizuel në mes të komunitetit shqiptar dhe serb	Monet Art&Books	4,000.00
Subtotali		120,700.00
Shpenzime operacionale programore		
Punëtori me OShC-të	Operacionale	797.12
Produkcioni i dokumentarit të shkurtë “RM në 4 minuta”	Operacionale	350.00
Shpenzime të përkthimit	Operacionale	297.73
Konsulencë	Operacionale	6,442.00
Furnizim i zyrës	Operacionale	173.00
Subtotali		10,059.46
Totali		130,759.46

1. Njoftimi me principet dhe vlerat bazë të BEs – Shkolla për integrim evropian

Shkolla për integrim evropian në vitin 2018 nxjerri gjeneratën e pestë të vijuesve të saj. Edhe këtë vit partnerë në zbatim të kësaj shtylle programore ishin Lëvizja Evropiane e Serbisë (LES) dhe OJQ Aktiv. Meqenëse gjatë katër viteve të kaluara u krijua një mase kritike e 200 alumneve me njohuri bazike mbi principet, vlerat dhe proceset e BE-së dhe 60 me njohuri të avansuara fondacioni e vlerësoi se ekziston një kapaciteti dhe është koha që programi i EU Shkollës të ri-dizajnohet dhe avansohet në mënyrë që të i përshtatet nevo-

jave të vijuesve, alumneve dhe momentit. Në fillim të vitit në bashkëpunim me partnerët implementues fondacioni ri-dizajnoj plan programin e EU Shkollës duke krijuar mundësi të avansimit të njohurive në fusha specifike dhe duke vendosur bashkëpunim më të ngushtë me OShC-të dhe institucionet e Kosovës. Programi i ri-dizajnuar mori për bazë momentin politik në Veri dhe nevojën për shpërndarje të njohurive mbi BE-në njëtrajtshëm edhe në vendet, komunat tjera të banuara me serb. Duke pas për bazë këto dy momente u vendosë që në vitin 2018 të vendoset një celulë e EU Shkollës në Graçanicë të punohet me dy grupe tematike të cilat do të plotësonin

nevojën për njohuri specifike në dy fusha. Këto fusha këtë vit ishin Sundimi i ligjit i cili u zhvillua në Mitrovicën veriore dhe Zhvillimi i qëndrueshëm i cili u vendosë në Graçanicë. Programi i ri-dizajnuar kishte përafërsisht të njëjtën strukturë të aktiviteteve por kishte shumë më shumë interaksion në mes të grupeve dhe me ekspert dhe institucione të Kosovës.

Programi përbëhej nga një punëtori fillestare mbi bazat e BE-së, tetë punëtori tematike dyditore, nga katër për secilin grup tematik, seminari rajonal, vizita studiuuese në Beograd dhe Prishtinë, vizita studiuuese lokacioneve apo institucioneve të cilat kishin mundësi të japin shembull të punës praktike dhe ligjërata të hapura.

Programi filloj me një punëtori 2 ditore e cila u mbajt në Vrnjačka Banja në qershor 2018, në të cilën vijuesit e ri u njoftuan me bazat e funksionimit të BE-së, strukturën e saj, mënyrën e vendimmarrjes ndërsa alumnit e gjeneratave paraprake i freskuan njohuritë e veta mbi të njëjtat. Ligjëruesit në këtë punëtori ishin ekspert të fushës të përzgjedhur nga Lëvizja Evropiane e Serbisë e cila edhe është angazhuar për shkak të ekspertizës që ka në këtë fushë.

Punëtoritë tematike u realizuan nga një në çdo lokacion për muaj, përjashtuar gushtin. Për të dy grupet u realizua një punëtori mbi aktivitete e watch dogging të politikave përkatëse për secilin grup në mënyrë që të aftësohen për këtë lloj të aktiviteteve dhe ta zbatojnë në komunat e veta dhe bashkërisht kur për këtë lind nevoja.

Vijuesit e programit të Sundimit të ligjit në Mitrovicë vizituan Gjykatën themelore në Mitrovicë ku u pritën nga kryetari i kësaj

gjykate dhe gjyqtari i Gjykatës së apelit të cilët i njoftuan mbi punën e këtyre gjyqeve dhe procesin dhe sfidat e integritetit të gjyqësisë në sistemin e Kosovës.

Grupi i Zhvillimit të qëndrueshëm vizituan shterpësirën e minierës së Kishnicës ku i priti drejtori i drejtoratit për urbanizëm, planifikim hapësinorë dhe mbrojtje të ambientit të komunës së Graçanicës. Vijuesit e këtij grupi gjatë kësaj vizite u njoftuan me punën e këtij drejtorati në fushën e mbrojtjes së ambientit dhe sfidat me të cilat ballafaqohen me shterpën e kësaj miniere dhe ndotjen që ajo shkakton.

Ligjëratat e hapura u mbajtën edhe në Graçanicë edhe në Mitrovicë. Koncepti gjithnjë shfrytëzon rastin e vizitave të ekspertëve të angazhuar në projektet e tjera për të mbajtur ndonjë ligjëratë të hapur të EU Shkollës në të cilën përfshihen edhe të gjithë të tjerët të interesuar për temën. Këtë vit ligjëratat të hapura mbajti Bodo Weber në temën tashmë të paevitueshme të normalizimit të marrëdhënieve Kosovë-Serbi e cila ngjau menjëherë pas propozimit për ndarje të Kosovës, korigjim të kufijve dhe zgjoi interesim shumë të madh. Ligjëratën e Bodo Weber e dëgjuan mbi 30 persona ndërsa diskutimi që pasoi ishte shumë i gjallë i zgjati më shumë se dy ore. Kjo ligjëratë përpos se dha informacion mbi procesin e negociimit në mes të Kosovës dhe Serbisë ishte edhe barometër i interesimit dhe pozicionit të serbëve të Kosovës qendrore karshi këtij procesi dhe propozimit të bërë.

Interesimi shumë i madh për të njëjtën temë por të trajtuar nga një këndvështrim tjetër, nga Brukseli, duke i përfshirë proceset edhe në Kosovës edhe në Serbi, proceset tjera në BE si Brexit, planifikimin buxhetor të BE-Së

për ciklin tjetër u mbajt nga Augustin Palokaj. Numri i pjesëmarrësve edhe në këtë ligjëratë ishte befasishëm i madh në krahasim me vitet e kaluara. Ligjëratat e Augustin Palokja si gjithnjë ishte tejet interesante, përplot informacion dhe e sinqertë gjë që u vlerësua tejet nga pjesëmarrësit. Diskutimi pas ishte gjithashtu shumë i gjallë, me shumë pyetje dhe komente e qëndrime të shprehura. Kjo ligjëratë përveç se ishte barometër dha edhe një informacion të rëndësishëm për konceptin, se komuniteti serb në Kosovën qendrore është më se i gatshëm të merë pjesë në procesin e dialogut dhe të shprehë haptas qëndrimin e vet.

Programi i ri-dizajnuar ngjalli shumë më shumë debat në mes të vijuesve në mes veti, në mes të ligjëruesve, ekspertëve, analistëve interesim për fushat përkatëse dhe u vlerësua si shumë i dobishëm për shumicën e vijuesve duke iu dhënë atyre njohuri praktike të cilën munden me e përdorë në punën e tyre të përditshme.

Sfidë për EU Shkollën në vitin 2019 mund të jetë: (1) situata ende jo stabile në Veri gjë që pengon zbatimin e aktiviteteve të planifikuara për shkak të frikës së ligjëruesve, (2) përzgjedhja adekuate e fushave për kurset e specializuara për të dy lokacionet, (3) gjetja e formave shtesë për afrimin e komunitetit serb me institucionet dhe organizatat tjera të Kosovës. (4) njohja e gjuhës së dy palëve do të mbetet sfidë permanente.

2. Lista e granteve dhe shpenzimeve tjera:

Emri i Projektit/iniciativës	Grant marrësi	Shuma në Euro
Shkolla për integrim evropian 2018, Mitrovicë	NGO Aktiv	16,833.00
Shkolla për integrim evropian 2018	Lëvizja evropiane në Serbi	25,890.00
Shkolla për integrim evropian, Graçanicë	Communication for Social Development	4,570.00
Bursa për student të komuniteteve pakicë	International Business College Mitrovica	4,995.00
Subtotali:		51,398.70
Shpenzime operacionale programore		
Konsulencë		624,76
Shpenzime të përkthimit		682,60
Furnizim i zyrës		301,20
Subtotali:		1,608,53
Totali:		53,007.23

2. Përkrahja për projektet hulmtuese dhe avokuese të OShC-ve dhe monitorimi i zbatimit të marrëveshjes së Brukselit – projektet e bashkëpunimit në mes të OShC-ve dhe mediave.

Në vitin 2018 koncepti ka vazhduar me skemën e grant-dhënies për organizata jo-qeveritare dhe media serbe, të cilat përsëri ishin të sfiduara të punojnë në partneritet në realizimin e projekteve të përbashkëta. Kjo skemë është treguar shumë e suksesshme në dy vitet e kaluara dhe ka dhënë rezultate shumë konkrete. Involvim i mediave e ka siguruar një efikasitet si dhe çasje me kreative në kampanjat avokuese të cilat kanë qenë pjesë përbërëse e

projekteve të garantuara.

Objekti kryesor i fondacionit ishte që t'i adresojë tri çështje që lehtë përkthehen në vlera të pakontestueshme të kësaj shtylle programore: (1) të mbërthehet një spektër të gjerë të organizatave (OJQ dhe media) me ndikim jo të vogël në shoqëri, (2) të zgjerohet spektri i hulmtuesve në projektet e OJQ duke i shtuar edhe hulmtuesit e mediave (gazetarët) dhe (3) të forcohet dukshëm kapaciteti avokues i këtyre organizatave në komunikimin e rezultateve me vendimmarrësit.

Kapitulli i veçantë do të jetë periudha e mbledhjes së rezultateve nga të gjitha projektet e

mbështetura, që i sjellë fondacionit mundësi të përmbledhjes së të gjitha projekteve dhe rezultateve në një edicion të posaçëm – praktike e suksesshme nga viti paraprak – që mundësoi organizimin e diskutimit përfundimtarë “Under construction” me shumë aktor të rëndësishëm dhe me bartësit e projekteve, ku është bërë prezantimi i rezultateve më të shprehura dhe u trajtuan proceset e rëndësishme në shoqërinë kosovare të cilat ishin subjekt i projekteve. Përfshirja e mediave dhe prodhimi i tri emisioneve begatuan edhe më shumë këtë iniciativë duke i sjellë rezultatet më afër qytetarëve, promovuar punën tonë dhe rolin e shoqërisë së gjëre civile në sigurimin e dinamikave zhvillimore në të gjitha lëmit. Një përmbledhje dhe diskutim i ngjashëm i begatuar edhe me panelistë nga organizatat e Prishtinës do të mbahet në vitin 2019 si përmbyllje e ciklit të vitit 2018.

Ftesa për projekt ide për ciklin e projekteve të vitit 2018 u hap menjëherë pas diskutimit “Under Construction”, fillimi i së cilës u shfrytëzua edhe për tu paralajmëruar hapja e konkursit dhe fushat potenciale për trajtim me projekte.

U përkrahën nëntë projekt propozime të cilat adresuan çështje nga që trajtonin (1) Marrëveshjen e Brukselit dhe zbatimin e marrëveshjeve, (2) Sundimin e ligjit dhe sigurinë dhe (3) Zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e ambientit. Prapa kësaj përzgjedhje të fushave qëndronte ideja e ndërlikohjes së kësaj shtylle programore me atë të Shkollës së integriteteve evropiane dhe përfshirja e bartësve të projekteve në grupet tematike të EU Shkollës në mënyrë që ata të risin dhe të aplikojnë njohuritë e veta në punë praktike duke zbatuar projektet e tyre. Kjo edhe ngjau dhe dha rezultate shumë të mira duke sjellë angazhim më të madh të përbashkët, kualitet

shumë më të lartë dhe strukturë më të mirë të studimeve, dhe produkteve mediale.

Numri i përfituesve direkt të përfshirë në të gjitha projektet ishte 4.917. Numri i përfituesve indirekt është shumëfish më i madh falë komponentës mediale të secilit projekt. Të gjitha projektet edhe aktivitetet e tyre ishin plotësisht të mbuluara nga mediat dhe në këtë mënyrë u vërtetua se aktivitetet me të vërtetë janë realizuar. Interesimi i mediave për aktivitetet e projekteve shkante përtej partnerëve në projekt. Një numër i aktiviteteve, prezantimeve të rezultateve të hulumtimeve/studimeve dhe diskutimeve tërhuqën vëmendjen edhe të mediave në gjuhën shqipe në Kosovë dhe mediave tjera rajonale të cilat trajtojnë tema nga Kosova dhe rajoni.

Në kuadër të këtyre projekteve u realizuan më se 35 fokus grupe, 12 konferenca, 9 studime/analiza politikash, u prodhuan më shumë se 15 emisione dokumentare, spote, debate televizive dhe më se 20 shkrime në ueb portale. Një pjesë e studimeve janë përdorë si bazë për përgatitje të emisionit SporaZoom, ndërsa një pjesë e përvojave u ndanë në diskutim me vijuesit e EU Shkollës.

Sfidë për këtë komponentë në vitin 2019 janë: (1) inkurajimi i bashkëpunimit në mes të OSHC-ve të veriut dhe jugut si shembulli i projektit të mbrojtjes së ambientit dhe ndërtimi mbi këtë eksperiencë, (2) fuqizimi i bashkëpunimit me mediat shqiptare, (3) gjetja e formave inovative për avokim dhe përfshirje më të madhe të qytetarëve të të dy komuniteteve.

3. Lista e granteve dhe shpenzimeve tjera:

Emri i Projektit/iniciativës	Grant marrësi	Shuma në Euro
Diskutimi "Under Construction"	Operacionale	968.59
Analiza e procesit të verifikimit të diplomave në përputhshmëri me marrëveshje e Brukselit	Klubi rinor edukativ "Sinergija"	8,666.00
Edukimi i prodhuesve bujqësorë si bazë për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e popullatës	Grupi i ekspertëve ekologjik dhe mjekësor	10,150.00
Integrimi i gjyqësisë-6 muaj pas	Qendra për përfaqësim të kulturës demokratike	10,000.00
A e ka harruar qytetarin marrëveshja e Brukselit?	Bota bardh e zi	9,000.00
Marrëveshje për regjistrat: ujërat e qetë të kodrës së Brukselit	Iniciativa lokale LINK	9,775.00
Marrëveshja e Brukselit - temat e patrajtuara	Qendra për Paqe dhe Tolerancë	7,910.00
Vlerësimi i problemeve të sigurisë në veri të Kosovës - SECURYMETAR	Qendra humane e Mitrovicës	10,000.00
Shoqëria përgjegjëse - komunat transparente!	Iniciativa e re shoqërore dhe Komunikimi për zhvillim shoqërorë	16,985.00
Veriu dhe Jugu: Pikat lidhëse	TRV Herc	4000,00
Analiza e situatës së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe krijimi i strategjisë në Kosovën Qendrore dhe Lindore në komunitetet serbe	Small Development Business Center of Kosovo	3,950.00
Dialogu Prishtinë-Beograd: Rruga drejt normalizimit dhe si mund të arrijmë atje?	Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik	1,500.00
Subtotali:		92,905.00
Shpenzimet operacionale programore		
Pjesëmarrja në Forumin e Ballkanit Perëndimorë	Operacionale	989.90
Punëtorja me OShC	Operacionale	1,519.53
Shërbime të përkthimit	Operacionale	845.80
Furmizim i zyrës	Operacionale	812.10
Subtotali:		4,167.33
Totali:		97,072.33





OSF FONDI REZERVĚ



OSF FONDI REZERVË

Fuqizimi i perspektivës së Kosovës në dialog me Serbinë

Duke e vlerësuar që hyrja e një faze të re të dialogut në mes Kosovës dhe Serbisë ka një rëndësi të madhe dhe do afektojë zhvillimin e tërë rajonit, Fondacioni ka inicuar një projekt lehtësues për të fuqizuar pozitën e Kosovës brenda negociatave. Nevoja për një projekt të tillë u bë më se e dukshme në mars të vitit 2018, kur Strategjia e re e komunikimit nga Komisioni Evropian ndërlidhi procesin e integritit evropian të të gjitha vendeve të Ballkanit me relacione të mira fqinjësore, dhe në rastin e Serbisë dhe Kosovës, ua kushtëzoi perspektivën e tyre evropiane me një marrëveshje ligjrisht të obligueshme.

Si përgjigje Fondacioni nisi projektin “Fuqizimi i perspektivës së Kosovës” në bashkëpunim me partnerët Këshillin për Politika të Demokratizimit (DPC) nga Berlioni dhe Grupin për Studime Ligjore dhe Politike (GLPS) nga Prishtina në maj të vitit 2018, projekt ky që do të vazhdojë të implementohet edhe përgjatë vitit 2019.

Deri më tash, projekti ka rezultuar në një seri tryezash të mbyllura sipas rregullave të Chatham House, në përpilimin dhe lancimin e katër dokumenteve të politikave, udhëtimeve avokuese në kryeqytetet kryesore evropiane dhe tryeza të mbyllura mes akterëve kyç politikë në Kosovë. Deri më tash, ka qenë po ashtu platforma e vetme e shoqërisë civile e përkrahur nga të gjitha partitë e mëdha që përfaqësojnë shumicën shqiptare në Kuvend, duke përfshirë partitë në koalicionin qeverisës dhe ato opozitare.

Përkrahur financiarisht nga fondi rezervë i Open Society Foundations, projekti ka për objektivë kryesore të forcojë kapacitetin e palës kosovare në dialogun për të arritur marrëveshjen gjithpërfshirëse me Serbinë, duke i ofruar përfaqësuesve politikë njohuri përmes dokumenteve të politikave dhe publikimeve tjera për diskutim dhe debateve mes përfaqësuesve politikë dhe shoqërisë civile. Që nga maji 2018, Fondacioni ka qenë aktivisht i angazhuar në krijimin e një konsensusi politik në vend për t’i bindur partitë në pushtet dhe opozitë të marrin pjesë konstruktivisht në dialogun Kosovë-Serbi. Për të krijuar një diskutim të sinqertë në mes të gjitha partive politike në vend, Fondacioni ka organizuar një seri tryezash të mbyllura në Tiranë, duke i mbledhur tok të gjitha partitë kyçe për të diskutuar parimet bazë që do t’i donin t’i shihnin të përfaqësuar në procesin e dialogut me Serbinë. Në maj, Fondacioni në bashkëpunim me partnerët organizoi një tryezë të mbyllur për të lancuar dokumentin e parë të serisë të përpiluar nga Bodo Weber dhe Agron Bajrami, “Korniza origjinale e dialogut politik.” Ky publikim doli pas takimit të parë në mes të përfaqësuesve të partive në nivel të deputetëve dhe nënkryetarëve, dhe u vazhdua përgjatë vitit 2018 me një takim tjetër në shtator dhe lancimin e tri dokumenteve tjera të shkruara nga ekspertët e lartpërmendur të cilat merren me njohjen potenciale të Kosovës nga Serbia, rrugën e Kosovës drejt anëtarësimit në BE dhe OKB, dhe çështjen e Asociacionit të komunave me shumicë serbe.

Përfaqësuesit politikë të partive kryesore në vend kanë bërë vizita avokuese në katër kryeqytetet kyçe evropiane: Paris, Berlin (në

qershor 2018), Bruksel dhe Londër (në nëntor 2018) për tu takuar me përfaqësues politikë shtetëror dhe të shoqërisë civile në secilin vend për të avokuar për përkrahjen e tyre në këtë proces të rëndësishëm dhe për të komunikuar pozitën e tyre në lidhje me marrëveshjen eventuale. Në Paris dhe Berlin, përfaqësuesit politikë që përfaqësojnë të gjithë spektrumit politik në Kosovë, janë takuar me parlamentarë, zyrtarë të Ministrive të Huaja dhe kanë mbajtur debate publike. Ngjashëm në Bruksel dhe Londër, përfaqësuesit politikë kanë takuar zyrtarë të lartë të Komisionit Evropian, përfaqësues nga Parlamenti Evropian, deputetë nga House of Commons, debat në LSE dhe përfaqësues të Zyrës për Marrëdhënie me Jashtë në Londër. Rol kyç kanë luajtur këto takime të nivelit të lartë për të komunikuar dhe përforcuar pozitën e përbashkët të përfaqësuesve politikë pjesëmarrës, përkundër një mungese të konsensusi konsistent dhe një përçarje në lidhje me propozimin e Presidentit Thaci për “korigjim kufijsh”.

Në tetor, Fondacioni po ashtu ka organizuar edhe një Forum2015 për të diskutuar mundësinë e një paradigme të re për dialog, prezantuar nga z. Veton Surroi dhe me prezencën e ambasadorit gjerman Christian Heldt. Në nëntor, iniciativa është zgjëruar dhe më shumë duke përfshirë përfaqësues të shoqërisë civile, kryesisht udhëheqës dhe hulumtues nga “think-tank”-et kryesore në Kosovë. Projekti do të vazhdojë me një udhëtim avokues për në kryeqytetin e SHBA-ve, prodhimin e një ‘non-paper’ (dokument diskutimi) përpiluar nga tryezat e mbyllura mes përfaqësuesve politikë dhe shoqërisë civile, dhe do të zgjerohet me inkuadrimin e perspektivës së serbëve të Kosovës, përmes hulumtimeve dhe debeteve.

Në vitin 2019, Fondacioni do të përcjellë zhvillimet dhe me fleksibilitet do i përgjigjet atyre duke inkuadruar dhe aktivizuar gjithnjë më shumë përfaqësuesit e shoqërisë civile.

1. Tabela e granteve

Emri i Projektit	Grantist	Shuma Euro
Fuqizimi i pozitës së Kosovës në dialogun Kosovë-Serbi	Democratization Policy Council, DPC	42,264.00 €
Fuqizimi i pozitës së Kosovës në dialogun Kosovë-Serbi pjesa 2	Democratization Policy Council, DPC	15,430.00 €
	Subtotal:	57,694.00 €
Shpenzime operacionale programore		
Takim i parë i mbyllur me përfaqësues politik në Tiranë maj 2018	Operacional	7,310.66 €
Takim i dytë mbyllur me përfaqësues politik në Tiranë tetor 2018	Operacional	8,063.44 €
Takim i tretë mbyllur me përfaqësues politik në Tiranë 3 dhjetor	Operacional	6,751.35 €
Udhëtim avokues me përfaqësues politik në Paris, Francë, qershor 2018	Operacional	26,628.30 €
Udhëtim avokues me përfaqësues politik në Berlin, Gjermani, qershor 2018	Operacional	12,280.59 €
Udhëtim avokues me përfaqësues politik në Bruksel, Belgjikë, nëntor 2018	Operacional	16,505.20 €
Udhëtim avokues me përfaqësues politik në Londër, Mbretëri të Bashkuar, nëntor 2018	Operacional	13,745.60 €
Prezantimet/ tryezat në Prishtinë maj, qershor, korrik, dhe tetor	Operacional	5,293.63 €
Konsulenca	Operacional	12,087.08 €
Publikime	Operacional	5,136.95 €
Furnizim për zyre	Operacional	380.00 €
	Subtotal	111,176.06 €
	Grand Total	176,870.06 €

Marrëdhëniet Kosovë – Shqipëri: Një hulumtim mbi qëndrimet në të dy anët e kufirit në partneritet me OSFA

Ky projekt është mbështetur nga fondi rezervë i Open Society Foundations - OSF. Me këtë fond janë mbështetur dy Fondacionet, KFOS dhe OSFA dhe do të vazhdojnë realizimin edhe në vitin 2019.

Qëllimi

Hulumtimi i qëndrimeve, ndërveprimit, njohurive, besimeve, në mes të qytetarëve të Shqipërisë dhe Kosovës ka për qëllim rritjen e bashkëpunimi në mes vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Takimi nismëtar për të parë mundësitë e realizimit të një hulumtimi gjithëpërfshirës në Shqipëri dhe Kosovës është mbajtur në shkurt 2018 në Tiranë.

Po në muajin shkurt, fondacionet në Shqipëri dhe Kosovës kanë angazhuar liderët e projektit të cilët do të koordinojnë punën mes fondacioneve në Shqipëri dhe Kosovës me organizatat të cilat realizojnë anketimin, si dhe përgatisin raportin përfundimtar të të gjeturave të anketës, vendosin për strategjinë e komunikimit të rezultateve dhe koordinojnë grupet e ekspertëve për studimet tematike.

Aktivitetet

- Në periudhën mars – qershor 2018, në Kosovë dhe Shqipëri janë mbajtur tri takime të përbashkëta mes liderëve të projektit, organizatave hulumtuese dhe fondacioneve

me qëllim të dakordimit për aktivitetet, de-tyrat, afatet kohore, si dhe guidat për fokus grupet në Shqipëri dhe Kosovë;

- Nga 6 korriku deri 30 korrik 2018, kompania hulumtuese e angazhuar për të kryer hulumtimin kuantitativ në Kosovë, KANTAR TNS Index Kosova, ka mbajtur 8 fokus grupe në tri lokalitete të ndryshme në Kosovë. Fokus grupet janë mbajtur me grupe të ndryshme të shoqërisë (gra/burra, të rinj/të moshuar, urban/rural) me qëllim të identifikimit të fushave dhe pyetjeve për hartimin e pyetësorit kuantitativ.
- Më 24 shtator 2018, është zhvilluar takimi i katërt i përbashkët i fondacioneve, liderëve të projektit, kompanive hulumtuese për të harmonizuar draftin final të pyetësorit.
- Në datat 13-18 tetor 2018, kompania hulumtuese ka bërë testimin e pyetjeve në terren, me qëllim të evitimit të problemeve eventuale në pyetësor.
- Gjatë muajit nëntor 2018, është kryer anketimi me 1,004 respondentë shqiptarë në mbarë territorin e Kosovës.
- Gjatë muajit dhjetor 2018, janë zhvilluar 300 anketa me pjesëtarët e komunitetit serb.

Rezultatet

Puna me fokus grupe në Kosovë dhe Shqipëri ka rezultuar me identifikimin e fushave dhe pyetjeve për pyetësorin final, i cili përmban pyetje që synojnë të masin ndërveprimin mes qytetarëve të Kosovës dhe Shqipërisë, njohuritë për njëri tjetrën, vlerat dhe besimet që ndajnë apo që i dallojnë, vlerësimin e bashkëpunimit zyrtar mes dy shteteve, pyetje rreth qëndrimit për bashkimin mes dy shteteve, relacionet me vendet e rajonit, qëndrimet rreth Bashkimit Evropian, si dhe perceptimet për dialogun Serbi-Kosovë dhe qëndrimet e qytetarëve për debatin e hapur për korrigjimin e kufijve.

Aktivitet në vazhdim

Raporti gjithëpërfshirës për rezultatet e anketave në Shqipëri dhe Kosovë do të finalizohet gjatë muajit janar 2019.

Pas finalizimit të raportit, fondacionet në bashkëpunim me liderët e projektit do të identifikojnë fushat kryesore në të cilat ekspert të fushave të ndryshme do të vazhdojnë tutje debatin rreth bashkëpunimit në fushën e arsimit, tregtisë, tregut të punës, etj.

2. Tabela e granteve

Emri i Projektit	Grantist	Shuma Euro
Studim i përbashkët Shqipëri-Kosovë	Index Kosova	26,609.00 €
	Subtotal:	26,609.00 €
Shpenzime operacionale programore		
Takime kordinimi	Operacional	4,404.22 €
Konsulenca	Operacional	3,028.94 €
Furnizim për zyre	Operacional	618.20.€
	Subtotal	7,552.16 €
	Grand Total	34,161.16 €

Projekti Më mëso mua

Përshkrimi i shkurtër i projektit

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) ka filluar zbatimin e projektit 3-vjeçar “Më mëso mua” (ang.: “SchoolMe”) në 16 shkolla përfituese të Kosovës në mars të vitit 2016. Projekti është financuar nga fondi rezervë i OSF, dhe është implementuar në partneritetet me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT),

si dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) të 15 komunave si në: Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Gjilan, Vushtrri, Podujevë, Hani i Elezit, Istog, Rahovec, Malishevë, Lipjan, Suharekë, Fushë Kosovë, Shtime dhe Drenas. Qëllimi i projektit ishte aftësimi i mësimeve për të zhvilluar kompetencat e të nxënësve të nxënësve të përcaktuara në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës përmes shfrytëzimit të platformës digjitale “Më mëso mua”, si dhe të burimeve të tjera online në procesin mësimor.

Projekti “Më mëso mua” është realizuar në tri faza. Gjatë fazës së parë të zbatimit të projektit u realizuan aktivitetet të cilat fokusoheshin në sigurimin e kushteve teknike për shfrytëzimin e platformës në klasa, regjistrimin e mësimdhënësve dhe nxënësve për përdorimin e platformës, si dhe aftësimin e mësimdhënësve për integrimin e platformës digjitale në metodologjinë e tyre të punës. Në shtator të vitit 2016 u përzgjedhën 16 shkolla për të shfrytëzuar platformën digjitale në procesin mësimor gjatë vitit shkollor 2016/2017. Më shumë se 750 mësimdhënës dhe afër 6500 nxënës të këtyre shkollave shfrytëzuan mundësinë e shfrytëzimit të platformës në shkollë dhe në shtëpi. Interesimi për shfrytëzimin e risive në procesin mësimor, sidomos për realizimin e mësimdhënies digjitale, bëri që gjatë vitit shkollor 2017/2018 të rritet në 23 numri i shkollave përfituese, të shtohet në 909 numri i mësimdhënësve me mundësi shfrytëzimi të platformës, si dhe të arrijë në 8076 numri i nxënësve që janë shfrytëzues të platformës “Më mëso mua”.

Meqë platforma “Më mëso mua” është realizuar për herë të parë në Kosovë, atëherë gjatë periudhës së implementimit të projektit janë realizuar 5 hulumtime të ndryshme, të cilat ofruan informacion lidhur me cilësinë e saj, perceptimet e mësimdhënësve dhe nxënësve për dobinë e shfrytëzimit të platformës “Më mëso mua” në procesin mësimor, si dhe për efektet që ajo sjellë gjatë përdorimit në klasë. Hulumtimet e realizuara treguan se platforma digjitale “Më mëso mua” konsiderohet nga mësimdhënësit si një mundësi shumë e mirë për të zbatuar me sukses Kornizën e Kurrikulës së Kosovës, sidomos kur merret parasysh fakti se mungojnë tekstet shkollore për zbatimin e saj. Në veçanti mësimdhënësit e kanë vlerësuar shumë faktin që përmes përdorimit të platformës kanë arritur të zhvil-

lojnë kompetencën digjitale tek nxënësit, si një kërkesë për përgatitjen e nxënësve për epokën digjitale.

Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2018

Gjatë vitit 2018 janë realizuar këto aktivitete:

1. Organizimi i një gare shpërblyese për shkollat përfituese të projektit

Nga janari deri në qershor të vitit 2018 KEC organizoi një garë shpërblyese për shkollat përfituese të projektit “Më mëso mua”. Organizimi i garës kishte për qëllim motivimin e mësimdhënësve dhe nxënësve të shkollave përfituese për të përdorur platformën në procesin mësimor, përmes hartimit dhe zbatimit të projekteve shkollore të cilat do të përmbanin aktivitete që përfshijnë përdorimin e platformave digjitale në përgjithësi, dhe të platformës “Më mëso mua” në veçanti. Para fillimit të garës shpërblyese KEC hartoi protokollin e organizimit të garës, si dhe kriteret për vlerësimin e projekteve shkollore. Pas hartimit të dokumenteve, KEC organizoi trajnimin 1-ditor “Mësimi problemor” për përfaqësuesit e shkollave përfituese. Më datën 9 shkurt është mbajtur trajnimi për 22 përfaqësues të 11 shkollave të përfshira në projekt, ndërsa më 10 shkurt për 22 përfaqësuesit e 11 shkollave të tjera. 44 mësimdhënës të cilët morën pjesë në trajnim janë certifikuar. Pas përfundimit të trajnimit, shkollat përfituese hartuan projektet shkollore deri më datën 28 shkurt 2018, ndërsa më pas filluan implementimin e tyre deri më 15 maj 2018. Komisioni i përbërë nga 3 përfaqësues të MASHT, DKA në Mitrovicë dhe KEC bëri vlerësimin e projekteve shkollore. Shpallja e shpërblyesve u bë gjatë konferencës “Mësimdhënia digjitale – Perspektiva e së ardhmes”, e cila u mbajt më 28 qershor 2018. Përveç 6 shkollave fituese

që u shpërblyen me vende të para dhe fituan laptop, kamera dhe mjete konkretizimi për lëndën e matematikës, KEC shpërbleu me nga një komplet librash edhe punën e nxënësve të të gjitha shkollave të tjera pjesëmarrëse në garë.

2. Përditësimi i listave të mësimdhënësve dhe nxënësve të 23 shkollave përfituese për të përdorur platformën “Më mëso mua” në procesin mësimor

Në shtator të vitit 2018 është bërë përditësimi i listave të mësimdhënësve dhe nxënësve të 23 shkollave përfituese për të përdorur platformën “Më mëso mua” në procesin mësimor. Kështu nxënësit të cilët gjatë vitit shkollor 2017/2018 kanë qenë në klasën 1-8 dhe kanë përdorur platformën, ata në shtator të vitit 2018 kanë kaluar një klasë më lartë, ndërsa nxënësit të cilët kanë qenë në klasë të 9 janë zëvendësuar me nxënës të rinj të cilët kanë filluar të shfrytëzojnë për herë të parë platformën “Më mëso mua” në procesin mësimor. Gjatë vitit shkollor 2018/2019 është arritur që 909 mësimdhënës dhe 8076 nxënës të regjistrohen për përdorimin e platformës në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve.

Përvoja e mirë e shkollave “Qamil Batalli” dhe “Kelmend Rizvanolli” në zbatimin e projektit në procesin mësimor ka bërë që këto shkolla të fitojnë pa pagesë nga kompania SchoolMe shfrytëzimin e kësaj platforme edhe gjatë gjysmë vjetorit të dytë të vitit shkollor 2018/2019.

3. Organizimi i hulumtimeve lidhur me dobinë e shfrytëzimit të platformës “Më mëso mua” në procesin mësimor

Në kuadër të projektit “Më mëso mua” kanë qenë të planifikuara të realizohen 5 hulumtime, një gjatë vitit 2017, ndërsa 4 të tjera

gjatë vitit 2018. Pas përfundimit të hulumtimit të parë lidhur me cilësinë e materialeve të platformës “Më mëso mua” në prill të vitit 2017, KEC realizoi gjatë vitit 2018 edhe 4 hulumtime të tjera. Rezultatet e dy hulumtimeve të para të realizuara gjatë vitit 2018 dhe që analizuan perceptimet e mësimdhënësve dhe nxënësve lidhur me dobinë e përdorimit të platformave digjitale në procesin mësimor u prezantuan gjatë konferencës së mbajtur më 28 qershor 2018. Dy hulumtimet e tjera, njëri i fokusuar në efektet e shfrytëzimit të burimeve online dhe tjetri lidhur me ndikimin e shfrytëzimit të burimeve online në cilësinë e mësimdhënies kanë përfunduar në shtator të vitit 2018 dhe janë shpërndarë te përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme që kontribuojnë në promovimin e mësimdhënies digjitale në procesin mësimor. Të gjitha raportet e hulumtimeve janë dërguar te partnerët e implementimit të projektit.

4. Organizimi i monitorimit në shkollat përfituese

Gjatë muajit shtator dhe tetor 2018 janë monitoruar 23 shkollat përfituese të projektit. Ky monitorim kishte për qëllim të ndihmonte shkollat në mbledhjen e të dhënave të nxënësve të rinj për regjistrim në platformë, si dhe për të vlerësuar përgatitjet që kishin bërë shkollat në fillim të vitit shkollor për përdorimin e platformës “Më mëso mua” në procesin mësimor. Gjatë monitorimit në shkolla, koordinatori e projektit ka realizuar intervista me drejtorët e shkollave, takime me mësimdhënës, si dhe ka realizuar monitorimin e 1-2 mësimdhënësve në klasë. Nga mësimdhënësit e monitoruar 11 ishin mësimdhënës klasorë, 2 mësimdhënës të lëndës së Fizikës, 5 mësimdhënës të Biologjisë, 4 mësimdhënës të Gjeografisë dhe 1 mësimdhënës të TIK. Për secilin mësimdhënës është plotësuar pro-

tokolli i monitorimit dhe është përgatitur raporti final për të gjitha shkollat.

5. Përditësimi i databazës së projektit

Në mënyrë të vazhdueshme është bërë mbledhja e të gjitha dokumenteve të projektit dhe sistemimi i tyre në databazën e projektit.



PROJEKTET ME FONDE TË PALËVE TË TRETA



PROJEKTET ME FONDE TË PALËVE TË TRETA

Projektet e zbatuara nga fondet e palëve të treta në përkrahje të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Gjatë vitit 2018 vazhdoi dhe hyri në fazën finale zbatimi i dy projekteve të përkrahura nga fondet e donatorëve tjerë: 1. Projekti Prospect Plus i përkrahur nga Ministria e Zhvillimit përmes Karl Kubel Stiftung me buxhet total prej 527.000 € dhe projekti EU SIMRAES II i përkrahur me 1.3 milion € nga Bashkimi Evropian përmes IPA fondeve. Të filluara në fund të vitit 2015, respektivisht në muajt e parë të vitit 2016, që të dy projekte arritën shumë më shumë se që ishte e parashikuar me projekt propozime. Të dy projektet ishin të dizajnuara ashtu që të jenë në sinergji të plotë me njëri tjetrin në mënyrë që të maksimizojnë efektet në terren. Përmes punës së qendrave të komuniteteve/mësimore në 12 komuna këto projekte adresuan fushat më kritike të këtyre komuniteteve, integrimin në sistemin arsimorë, shëndetësinë dhe çështjet sociale si dhe fuqizimin e OShC-ve për të adresuar këto çështje dhe të jenë të aftë të avokojnë për komunitetet e veta. Asnjëri nga këto dy projekte nuk pati ngecje në punë apo sfida të paparashikuara.

Gjatë vitit të fundit të zbatimit të këtyre dy projekteve fondacioni i filloi bisedimet me të dy donatorët dhe institucionet e Kosovës për vazhdimin e përkrahjes për zbatim të projek-

teve të ngjashme nga viti 2019. Bashkëpunimi do të vazhdohet me Karl Kubel Stiftung me projekt të ri i cili do të zbatohet në lokacionet ku ishte prezent edhe deri me tani, Suhareke dhe Peje por duke adresuar tani personat e riatdhesuar të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian me theks në riintegrim në sistemin arsimor dhe social. Ky projekt do të zgjasë për katër vjet dhe do të ketë buxhet prej 575.000 €. Bisedimet u filluan edhe me Zyrën e BE-s në Kosovë dhe Ministrinë e Arsimit, Teknologjisë dhe Shkencës dhe në këtë fazë, pas takimeve me Ministrin Bytyqi dhe përkrahjen e tij për vazhdim të projekti EU SIMRAES në një format të ri, fondacioni ka hartuar koncept propozimin dhe është në pritje të përgjigjes nga Ministria e Integritimeve Evropiane për të filluar përgatitjet për projekt propozim të ri.

Në vazhdim janë të përshkruara të arriturat kryesore të dy projekteve.

Përkrahja e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2 - Arsim për Integrim (EU SIMRAES 2)

Përshkrimi i shkurtër i projektit

Projekti “Përkrahja e BE-së në zbatimin e strategjisë për integrimin e komuniteteve

rom, ashkali dhe egjiptian 2 – Arsim për Integrim” (EU SIMRAES 2), ka filluar implementimin me 1 prill 2016. Projekti financohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe implementohet nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) në partneritet me 7 organizata tjera:

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)

Balkan Sunflowers Kosova (BSFK)

Bethany Christian Services (BCS)

Nevo Koncepti (NVK)

SHL Kosova (SHL-K)

Syri i Vizionit (SIV)

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është partneri kryesor institucional në projekt, që krahas përkrahjes së aktiviteteve të projektit, financon edhe një pjesë të programit të bursave në kuadër të projektit. Komuna e Gjakovës, Prizrenit, Rahovecit, Istogut, Obiliqit, Fushë Kosovës dhe Mitrovicës janë po ashtu partnerë institucionalë në nivelin lokal.

Objektivi i përgjithshëm i projektit EU-SIMRAES 2 është të mbështesë Qeverinë e Kosovës në zhvillimin e shoqërisë demokratike dhe multietnike duke zbatuar Strategjinë për Integrimin e Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe Planin e saj të Veprimit.

Objektivi specifik i veprimit është të sigurojë qasje të barabartë të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm, duke përmirësuar regjistrimin, vijimin dhe arritjen e rezultateve të fëmijëve nëpërmjet mbështetjes së bazuar në komunitet dhe asaj financiare.

Grupet e shënjestruara janë:

- 10 lokalitete ku jetojnë romë, ashkali dhe egjiptian me 8,127 banorë;
- fëmijët e moshës 5 vjeçare - gjithsej 154, prej tyre 98 e vijnë arsimin parafillor dhe 56 nuk vijnë;
- fëmijët e moshës 6-14 vjeçare - gjithsej 1246, prej tyre 1002 e vijnë arsimin e obliguar, dhe 244 nuk e vijnë;
- prindërit e fëmijëve të moshës shkollore nga 10 lokalitetet e synuara;
- mësuesit e shkollave që shërbejnë komunitetet e synuara;
- nxënësit e shkollave në komunitetet e synuara;
- 200-300 nxënës romë, ashkali dhe egjiptian të shkollave të mesme;
- 7 organizata të shoqërisë civile;
- publiku i gjerë në Kosovë.

Projekti i ka tri rezultate, që identifikohen edhe si komponentë të projektit:

- Përfshirja e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nga 10 lokalitetet e shënjestruara, në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm, dhe përmirësimi i rezultateve të tyre të të nxënësve
- Qasje dhe mbajtje e përmirësuar e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të lartë dhe përmirësimi i kapacitetit të tyre për të përfituar nga arsimi i lartë
- Organizatat që punojnë në edukimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian e përmirësojnë kapacitetin e tyre për t'u ofruar shërbime cilësore anëtarëve të komuniteteve të tyre.

Si aktivitete kryesore të projektit janë:

1.1 Mbështetet punës e 10 qendrave mësimore.

1.2 Bëhet vetëdijesimi i prindërve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për të regjistruar fëmijët me kohë në shkollë.

1.3 Ofrohet mbështetje logjistike fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për të vijuar arsimin parafillor.

1.4 Ofrohet mentorim individual dhe ndihmë në detyra të shtëpisë për fëmijët e moshës shkollore dhe atyre të kthyer.

1.5 Organizohet trajnim kundër paragjyqimeve për mësimdhënësit dhe prindërit, dhe ofrohet mentorim/këshillim për të siguruar zbatimin e kompetencave të marra.

1.6. Organizohen ngjarje lokale për të ndihmuar integrimin më të mirë të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në nivelin shkollor.

2.1 Ofrohet mbështetje për regjistrimin e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të lartë.

2.2 Krijohet një program i bursave për nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian të shkollave të mesme të larta.

2.3 Ofrohet mentorim për përfituesit e bursave.

3.1 Themelohet një rrjet joformal i OShC që punojnë në përmirësimin e mundësive të arsimimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

3.2 Lehtësohet komunikimi në mes të anëtarëve të rrjetit dhe shpërndahet informacioni .

3.3 Zhvillohet strategjia e bashkëpunimit për rrjetin

3.4 Ofrohen mundësi të zhvillimit profesional të anëtarëve të rrjetit, për të përmirësuar shkathtësitë e tyre të shërbimit dhe avokimit.

Të arriturat kryesore

1. Përfshirja në edukimin e hershëm dhe arsimin e obliqur

Këtë komponent të projektit e koordinon Qendra për Arsim e Kosovës. Organizatat tjera partnere kanë rol të theksuar në menaxhimin në nivel lokal përmes qendrave mësimore. Janë 10 qendra mësimore në 7 komuna, të cilat menaxhohen nga 6 organizatat tjera partnere.

Emri i qendrës mësimore	Organizata partnere menaxhuese
Qendra Sociale në Plementin (PBLC)	Balkan Sunflowers Kosova
Qendra Mësimore në Plementin (PLC)	Balkan Sunflowers Kosova
Fidan Lahu (Fushë Kosovë)	Balkan Sunflowers Kosova
Gurrakoc (Istog)	Syri Vizionit
Serbobran (Istog)	Syri Vizionit
Piranë (Prizren)	Nevo Koncepti
Jeta e Re (Prizren)	Nevo Koncepti
Lagjja e Romëve (Rahovec)	SHL-Kosova
Brekoc (Gjakovë)	Bethany Christian Services
Lagjja e Romëve (Mitrovicë)	RADC

Mbështetja e qendrave mësimore

Ka vazhduar zbatimimi i programit të detyrave të shtëpisë që është ndër programet më të rëndësishme të projektit, i cili implementohet sipas metodologjisë së kursit Hap pas Hapi. Në këtë program vazhdojnë të angazhohen së paku 3 fasilitatorë me kohë të plotë ose 6 fasilitatorë me gjysmë orari në varësi të nevojave të qendrës dhe numrit të fëmijëve. Ata ndihmohen nga vullnetarët apo tutorët e qendrave mësimore.

Projekti EU SIMRAES 2 parasheh ndihmë logjistike për të lehtësuar vijueshmërinë në shkollë dhe në qendër mësimore dhe në kuadër të kësaj projekti edhe gjatë këtij viti ka ndërmarrë veprimet në vijim:

- a) ka shpërndarë 1600 pako shkollore nga 800 të parapara për vitin shkollor 2018/2019, respektivisht i ka mbuluar të gjithë fëmijët në nevojë në 10 lokalitetet përfituese;
- b) ka shpërndarë në baza mujore gjysmë shujtë për fëmijët që vijnë në qendra mësimore;
- c) ka shpërndarë materialet didaktike në secilën qendër mësimore;

Trajnimi për trajnerë “Edukimi për Drejtësi Shoqërore” (EDSH)

Gjatë muajit prill 2018, projekti ka organizuar trajnimin për trajnerë të EDSH-së. Qëllimi i trajnimit ishte që të përgatitej një listë e trajnerëve të rinj që do të mund të ofrojnë trajnimin e EDSH-së në të ardhmen. Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit kanë përgatitur dhe prezantuar aktivitete si dhe janë vlerësuar nga kolegët. Kjo metodë ka mundësuar që secili pjesëmarrës përveç pjesës së prezantimit, të

vlerësojë edhe pjesëmarrësit tjerë në cilësinë e trajnerit, si një mundësi për të reflektuar më shumë rreth performancës si trajner. Gjithsej janë trajnuar dhe certifikuar 16 pjesëmarrës (12 femra; 4 meshkuj).

Punëtorja reflektuese e EDSH-së

Gjatë muajit prill 2018, projekti ka organizuar punëtorinë reflektuese me temën “Parandalimi i paragjyqimeve, stereotipeve dhe krijimi i një shkolle demokratike”, në bashkëpunim me Prospect +. Programi i trajnimit ka qenë i organizuar në atë mënyrë që përmes aktiviteteve pjesëmarrësit të njihen me paragjykimet dhe stereotipet që krijohen në shkollat tona dhe si mund të bëhet luftimi i tyre. Gjatë punëtorisë, pjesëmarrësit kanë prezantuar reflektimet e tyre nga zbatimimi i aktiviteteve në shkolla si dhe u janë ofruar aktivitete shtesë për zbatim në shkolla. Në trajnim morën pjesë 32 pjesëmarrës (15 femra; 17 meshkuj) ku përfaqësueshin drejtorët dhe mësimdhënësit e shkollave partnere të qendrave mësimore si dhe stafi i qendrave mësimore.

Punëtorja për koordinatorët e qendrave mësimore

Gjatë muajit maj 2018, është organizuar punëtorja triditëshe me koordinatorët e qendrave mësimore me temën “Roli i OShC-ve në zbatimin e Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021”. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte diskutimi për masat e strategjisë që lidhen drejtpërdrejt me punën e qendrave mësimore, konkretisht me punën e koordinatorëve të këtyre qendrave. Pjesëmarrësit kishin mundësinë që përgjatë tri ditëve të punëtorisë të diskutojnë se si mund të kontribuojnë tutje në zbatimin e masave të cak-

tuara të Strategjisë, të diskutojnë sfidat dhe të shkëmbejnë praktikat në zbatimin e kësaj politike. Në punëtori morën pjesë 19 pjesëmarrës (9 femra; 10 meshkuj).

Monitorimi i Qendrave Mësimore (HqH)

Monitorimi i Qendrave Mësimore (QM) ka filluar në janar 2018 dhe ka përfunduar në dhjetor 2018. Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar gjithsej 105 vizita monitoruese. Monitorimi si proces i vazhdueshëm ka qenë i rregullt në secilën qendër edhe këtë vit. Qendrat janë monitoruar për të siguruar cilësinë e punës në përgjithësi, duke përfshirë kështu aktivitetet me fëmijë, aspektin e performancës së stafit në punë, aspektin e logjistikës dhe në veçanti higjienën.

Monitorimi ka luajtur rol të rëndësishëm dhe ka ndikuar pozitivisht në punën e përditshme të QM-ve. Në qendra është krijuar rend dhe rregull sidomos në zbatimin e planit mësimor. Nga monitorimet e deritanishme vërehet se ka rritje të vazhdueshme të numrit të fëmijëve që vijnë në mësimin në qendrat mësimore duke përfshirë edhe fëmijët nga komuniteti shumicë.

Aspektet që monitoruesit rekomanduan për përmirësim të vazhdueshëm janë: planifikimi i detajuar i mësimëve tematike në të cilat mund të përfshihen tema që mundësojnë ndërlidhjen e lëndëve dhe fushave mësimore, ku me këtë rast përmbushet mësimdhënia e cila zhvillon aftësitë, shkathtësitë dhe shprehitë e nxënësve me anë të ndërveprimit të tyre si dhe puna individuale me fëmijë.

2. Përmirësimi i qasjes në arsimin e mesëm të lartë

Programi i bursave

Për të tretin vit radhazi, projekti është pjesë e programit të bursave në nivel vendi i cili koordinohet nga ministria e Arsimit, shkencës dhe Teknologjisë, dhe në të cilin marrin pjesë edhe ofruesit e tjerë të bursave për nxënësit e shkollave të mesme nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Në dy vitet e para numri i bursave ishte 500, ndërsa këtë vit ky numër u rrit në 600 përfitues. Projekti i financon 200 bursa.

Procesi i programit të bursave edhe këtë vit ka filluar me shpalljen e thirrjes për aplikime për bursa. Kanë aplikuar më shumë se 700 nxënës, ndërsa të gjitha aplikimet janë futur në sistemin për menaxhimin e informatave për bursat që është sistem i përbashkët i cili është kontribut i projektit tonë. Mbi bazën e këtij sistemi dhe kriterëve të vendosura që më pare, është krijuar lista preliminare e përfituesve, e cila më tutje është validuar me vendim nga ministri i arsimit. KFOS ka lidhur kontratat për bursa me 67 nxënës bursistë që paguhen nga KFOS, ndërsa Ministria do të bëjë pagesën e bursave për 133 bursistët e tjerë të projektit.

Programi i mentorimit

Qëllimi i programit të mentorimit është përmirësimi i vijueshmërisë dhe rezultateve të të nxënësve të nxënësve përfitues të projektit duke u ofruar atyre mbështetje akademike dhe jo-akademike si dhe mundësi më të shumta shoqërimi me bashkëmoshatarët.

Gjatë vitit shkollor 2017/18 prej 200 bursistëve, projekti ka ofruar program të mentorimit për së paku gjysmën e bursistëve. Më saktësisht nën këtë program, përmes 23 mentorëve janë mbështetur 114 bursistë të shkollave të mesme të larta në komunat: Gjakovë, Istog dhe Prizren.

Programi ka ecur mirë dhe kemi pasur përmirësim në rezultatet e të nxënësve. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur nota mesatare për dy vitet shkollare prej kur ka filluar të ofrohet programi i mentorimit për nxënësit përfitues të programit të mentorimit. Nga tabela shihet që përgjatë dy viteve shkollare kemi rritje të notës mesatare.

1. Nota mesatare e nxënësve të mentoruar

Viti shkollor	Nota mesatare Gjysmëvjetori I	Nota mesatare Gjysmëvjetori II
2016/17	2.46	2.85
2017/18	2.86	3.18

Gjatë muajit maj 2018, projekti në bashkëpunim me VoRAE ka organizuar modulën e dytë të trajnimit për mentorë i cili është ofruar nga Roma Education Fund (REF). Qëllimi i trajnimit ka qenë që t'u mundësojë mentorëve përmirësimin e praktikave të mentorimit sa i përket mbështetjes së nxënësve të mentoruar në arritjet mësimore, zhvillimin e tyre dhe përfshirjen sociale. Trajnimit e kanë ndjekur 41 mentorë që janë të angazhuar në kuadër të programeve të mentorimit të VoRAE dhe EU SIMRAES 2.

Në vitin shkollor 2018/19, programi i mentorimit ka filluar prej 1 nëntorit, sapo procesi i përzgjedhjes së bursave ka mbaruar. Gjatë këtij viti shkollor do të përkrahen 115 bursistë në komunat: Gjakovë, Prizren dhe Istog. Nxënësit do të ndihmohen nga 23 mentorë të cilët janë profesorë të shkollave ku ata vijojnë mësimin në çështjet që lidhen me mësimin, komunikimin me bashkëmoshatarë, mundësi për punë praktike, orientim në karrierë si dhe aktivitete jashtëkurrikulare. Sikurse edhe vitet e kaluara, mentorimi do të organizohet

në formë të takimeve individuale dhe grupe me nxënësit si dhe takimeve periodike me prindërit dhe shkollën.

3. Forcimi i kapacitetit të OShC-ve që punojnë në edukimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

Ky komponent është i drejtuar kah forcimi i kapaciteteve të anëtarëve të organizatave partnere për të ofruar shërbime cilësore në fushën e arsimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Rrjeti mban takime periodike që shërbejnë për shkëmbimin e përvojave të anëtarëve të rrjetit në fushën e avokimit për arsimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. KFOS-i e ka rolin e lehtësimit të këtyre takimeve në aspektin e organizimit logjistik, ndërsa organizatat me radhë janë nikoqire të takimeve.

Këtë vit takimi i parë i rrjetit është mbajtur në maj 2018, me organizim të organizatës

partnere Bethany Christian Services. Ndërsa takimi i dytë i rrjetit ka qenë më i veçantë pasi u realizua në formë të një punëtorie triditëshe vlerësuese për punën e deritashme të rrjetit. Kjo punëtori u realizua në organizim të KFOS. Punëtorja në fjalë shërbeu si nismë për procesin e hartimit të strategjisë së rrjetit.

Në nëntor 2018, u organizua punëtorja triditëshe për zhvillimin e strategjisë së rrjetit Konect për periudhën e ardhshme trivjeçare. Punëtorja u zhvillua me pjesëmarrjen në një grupi planifikues ku u përfaqësuan organizatat partnere të rrjetit. Në punëtori u përcaktuan vizioni, misioni dhe objektivat strategjike të rrjetit, si dhe u definuan masat për përbushjen e objektivave strategjike. Pas kësaj punëtorie, konsulentja e angazhuar nga projekti e ka hartuar draftin e parë të dokumentit të strategjisë dhe i njëjti është qarkulluar për komente e kontribute shtesë nga anëtarët e ekipit planifikues.

Organizatrat partnere këtë vit kanë qenë të angazhuara në planifikimin dhe zbatimin e nismave avokuese që janë të orientuara në adresimin e çështjeve me rëndësi për edukimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe me fushat e lidhura. Projekti në bashkëpunim edhe me projektet KOSINT e KEEN kanë bashkëpunuar në krijimin e një platforme për nismat avokuese. Sidoqoftë, për shkak të dinamikës së ndryshme të projekteve, nuk ka qenë e mundur që të gjitha aktivitetet avokuese të realizohen bashkarisht. Megjithatë, si rezultat i bashkëpunimit me organizatat partnere të këtyre projekteve, është themeluar Këshilli i Avokimit i cili ka marrë mandatin e shqyrtimit të propozimeve për nisma avokuese, si dhe aprovimin e tyre. Në këtë këshill kanë qenë të përfaqësuar anëtarët nga këto organizata: KFOS, BSFK, VoRAE, SiV, RADC, TdH dhe KEC.

Këshilli i ka aprovuar 7 nisma avokuese, të cilat janë propozuar:

- Avokimi për financimin e qendrave mësimore me bazë në shkollë në komunën e Prizrenit dhe Suharekës (NVK)
- Njoftimi i nxënësve semimaturat të shkollave fillore të mesme të ulta për vendet e rezervuara të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shkollat e mesme të larta të komunës së Prizrenit dhe Suharekës (NVK)
- Funksionalizimi ekipeve për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së mësimin të rregullt në shkollimin e obliguar nga nxënësit në komunën e Pejës, dhe fuqizimi i rolit të tyre për veprim brenda shkollave (SiV)
- Intervenimi i institucioneve të nivelit lokal për rregullimin e fushës së sportit dhe ambientit përrreth saj në lagjen 29 në Fushë Kosovë (BSFK)
- Rregullimi i një parku të gjelbër për banesat sociale në Plemetin (BSFK)
- Angazhimi në rritjen e suksesit të nxënësve të klasave 6 – 8 në Plemetin (BSFK)
- Përfaqësimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në qeverisjen lokale përmes punësimit të përfaqësuesit në ZKKK në Rahovec (SHL-K)

Të gjitha këto nisma janë realizuar me sukses. Në kuadër të projektit funksionon uebfaqja e projektit e cila është në dispozicion në <http://eu-simraes.net/>. Po ashtu, projekti ka një faqe në Facebook, që është në dispozicion në <https://Web.facebook.com/eusimraes2/?fref=ts>

Planet për të ardhmen

Për vitin 2019 planifikohen aktivitetet në vijim:

- Aplikimi për vazhdimësi të projektit;
- Implementimi i programeve të detyrave të shtëpisë në 10 qendrat mësimore;
- Mentorimi i 115 përfituesve të bursave;
- Monitorimi i programeve;
- Organizimi i aktiviteteve vetëdijesuese dhe ndërkulturore;
- Mbështetje profesionale e stafit të qendrave mësimore, sipas nevojës;
- Miratimi i strategjisë së rrjetit;
- Takimet e rrjetit dhe aktivitetet e tjera të rrjetëzimit.

2. Lista e granteve:

Emri i Projektit	Grantist	Shuma Euro
Koordinimi i partnerëve, trajnimi i të punësuarve të QM dhe monitorimi dhe vlerësimi i aktiviteteve	Qendra për Arsim e Kosovës	66,337.71
Menaxhimi i QM dhe zbatimi i programeve mësimore dhe avokuese	Nevo Koncepti	32,034.60
Menaxhimi i QM dhe zbatimi i programeve mësimore dhe avokuese	Bethany Christian Services	16,406.70
Menaxhimi i QM dhe zbatimi i programeve mësimore dhe avokuese	Syri Vizionit	29,774.60
Menaxhimi i QM dhe zbatimi i programeve mësimore dhe avokuese	SHL-Kosova	17,126.30
Menaxhimi i QM dhe zbatimi i programeve mësimore dhe avokuese	Balkan Sunflowers Kosova	42,810.64
Menaxhimi i QM dhe zbatimi i programeve mësimore dhe avokuese	Roma and Ashkali Documentation Center	17,049.30

Promovimi i integritit të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Pejës dhe të Suharekës, Kosovë – Prospect Plus

Projekti Prospect Plus është vazhdimësi e projektit Prospect, i cili është zbatuar në katër komuna të Kosovës (Prizren, Gjakovë, Rahovec dhe Istog). Projekti Prospect Plus zbatohet në dy komuna (Pejë dhe Suharekë), duke filluar nga nëntori i v.2015. Projekti synon të vazhdojë t'i kontribuojë realizimit të strategjisë shtetërore për integrimin e komunitetit rom dhe ashkali duke e përmirësuar qasjen në shërbimet për arsim, shëndetësi dhe çështje sociale. Andaj synimi i përgjithshëm i Projektit Prospect Plus është të kontribuojë në realizimin e të drejtave të romëve, ashkallive dhe egjiptianëve në Kosovë, respektivisht në komunën e Pejës dhe të Suharekës, dhe në integrimin e tyre në shoqërinë kosovare. Për të kontribuar në arritjen e këtij qëllimi të përgjithshëm, Projekti Prospect Plus ka marrë mbi vete obligimin të arrijë një qëllim të caktuar, i cili është që në katër lagje në dy komuna e cekura ku jeton komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian të përmirësohet qasja në shërbimet për arsim, shëndetësi dhe çështje sociale si një hap i rëndësishëm drejt rritjes së pjesëmarrjes ekonomike dhe sociale si dhe të integritit social.

Ky është viti i fundit i realizimit të këtij projekti, gjegjësisht realizimi i projektit ka përfunduar më 31 janar 2018. Në marrëveshje me donatorin, është marrë vendim që projekti të vazhdojë për katër muaj, si periudhë no-cost. Ndërkohë janë duke u finalizuar përgatitjet për fillimin e projektit të ri Prospect, i cili pritet të fillojë nga muaji maj 2019.

Gjatë zbatimit të tij në vitin 2018, projekti ka ndërmarrë një varg masash dhe aktivitete në për të realizuar objektivat, të cilat janë të përfshira edhe në Strategjinë dhe Planin e veprimit për integrimin e komunitetit rom dhe ashkali në Kosovë (specifikisht në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë si dhe në sektorët e ndërlidhur të çështjeve sociale).

Ky raport në vijim përfshin realizimin e aktiviteteve dhe përmbushjen e objektivave apo fushave të intervenimit, të shprehura si qëllime të projektit:

1. Fëmijët romë, ashkali dhe egjiptas në katër lokacione janë të integruar në shkollën fillore (nivelel parashkollor, fillor dhe të mesëm të ulët).

Të gjitha aktivitetet e projektit në 2018 janë zhvilluar në 2 Qendrat Mësimore në komunën e Pejës, gjegjësisht në Vitomiricë dhe në lagjen 7 Shtatori në Pejë, dhe në 2 Qendrat Mësimore në komunën e Suharekës, në fshatrat Leshan dhe në Gelancë. Qendrat Mësimore janë të vendosura brenda hapësirave të shkollave fillore ku në marrëveshje me autoritetet e arsimit janë lëshuar klasat duke u shndërruar kështu në Qendra Mësimore (QM). Në secilën QM punojnë nga 2 tutorë, të cilët u ndihmojnë fëmijëve që kanë vështirësi në nxënie, kanë pasur vijueshmëri të parregullt ose janë rikthyer nga emigrimi. Në komunën e Pejës 286 fëmijë kanë marrë shërbime të këtilla, gjersa në komunën e Suharekës numri i fëmijëve të përfshirë 79. Përveç kësaj, tutorët kanë ndërmjetësuar me mësuesit, autoritetet shkollore dhe prindërit ashtu që të forcohet bashkëpunimi i prindërve me shkollën me qëllim që të rritet edhe përfshirja e prindërve në ndihmë fëmijëve të tyre. Në QM shërbime nga tutorët kanë marrë edhe rreth 20% të fëmijëve nga komuniteti shumicë, të

cilët po ashtu vijnë nga shtresat sociale të sfiduara. Si rezultat është rritur vijueshmëria ose zvogëluar numri i mungesave të nxënësve dhe është rritur sukcesi apo nota mesatare e nxënësve që vijnë nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. QM ka ndërmarrë gjithashtu aktivitete ndërkulturore, të karakterit rekreativ dhe mësimor, në të cilat janë përfshirë fëmijët e komunitetit rom, ashkali, egjiptian, shqiptar dhe boshnjak. Aktivitetet ndërkulturore kanë çuar drejt uljes së shkallës së diskriminimit, të stereotipeve dhe paragjytimeve që fëmijët kanë ndaj njëri-tjetrit. Secilin muaj janë ndërmarrë të paktën një aktivitet ndërkulturor në një QM ose të paktë 48 aktivitete të tilla, ku në komunën e Pejës janë përfshirë rreth 200 fëmijë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian dhe rreth 200 fëmijë të komunitetit shqiptar si dhe rreth 100 fëmijë të komunitetit boshnjak. Në komunën e Suharekës janë përfshirë rreth 70 fëmijë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian si dhe rreth 200 fëmijë të komunitetit shqiptar. Projekti ka ndërmarrë gjithashtu aktivitete ndërgjegjësuese: në muajt maj, qershor dhe gusht 2018 janë ndërmarrë fushata intensive për ndërgjegjësimin e prindërve/familjarëve për të regjistruar ose mbajtur fëmijët e tyre në shkolla, ngase këto janë muajt kur ligjshmërisht regjistrohen fëmijët në shkollë. Kësisoj personeli i projektit, duke i përfshirë edhe zyrtarët komunalë të arsimit, kanë bërë vizita nëpër lokacionet e projektit, duke i hyrë nëpër shtëpi familjeve më autoritare që vijnë nga këto komunitete por edhe tyre më të varfëra, dhe kanë këshilluar për rëndësinë e arsimit dhe rolin që shkolla e ka për të siguruar ardhmëri me perspektivë për fëmijët e tyre.

2. Komuniteti i synuar rom, ashkali dhe egjiptian e përmirësojnë qasjen e tyre në shërbimet shëndetësore dhe sociale dhe fitojnë më shumë njohuri dhe informata rreth çës-

tjeve që kanë të bëjnë me shëndetin

Kryesisht aktivitetet janë realizuar në mëhalla/lagje të lokacioneve të projektit, shpesh duke u ndërmarrë edhe nëpër shtëpitë e familjeve që vijnë nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. Për këtë qëllim janë angazhuar ndërmjetësuëset shëndetësore dhe sociale, si personel i projektit por që vijnë nga vet komunitetet e tilla. Përqendrimi ka qenë kryesisht në gratë dhe vajzat, meqë në fillim kanë qenë mjaft hezituese në marrjen e shërbimeve mjekësore por edhe atyre sociale. Në marrëveshje me autoritetet shëndetësore komunale, sidomos me QMF-të (Qendrat e Mjekësisë Familjare) ndërmjetësuëset kanë organizuar vizitat mobile të mjekëve dhe specialistëve mjekësorë në lagje, ku mjekët kryenin kontrolle rutinoire dhe specialistike nëpër shtëpi, duke kontrolluar kështu gratë, vajzat, djemtë dhe burrat që kishin probleme shëndetësore. Janë organizuar të paktën një vizitë mobile në muaj në secilin lokacion të projektit, ose të paktën 50 vizita të këtilla përgjatë vitit. Gjithashtu ndërmjetësuëset, në formë të organizuar, kanë sjellë pjesëtarët e komuniteteve nga mëhallat në QMF për të kryer kontrollet ose vizitat specialistike, ku janë ndërmarrë të paktën 50 organizime të tilla përgjatë vitit 2018. Aktivitet tjetër me rëndësi që e kanë ndërmarrë ndërmjetësuëset është organizimi i takimeve ose seancave këshilluese kryesisht për gratë dhe vajzat e komunitetit. Dy herë në muaj, në secilin lokacion të projektit, janë sjellë mjekët ose specialistët, në njërin nga shtëpitë e familjarëve në mëhallë, në të cilën seancë kanë marrë pjesë rreth 15-20 gra dhe vajza. Seancat kanë qenë të tipit këshillues, gjersa temat që janë diskutuar janë ngritur ose përzgjedhur nga vet gratë ose vajzat. Disa prej temave kanë qenë higjiena e individëve, higjiena e kuzhinës, sëmundjet endemike dhe kronike, higjiena e

fëmijëve, planifikimi familjar etj. Çdo të dytin muaj temat këshilluese kanë qenë të natyrës sociale, në të cilën kanë marrë pjesë edhe burrat dhe djemtë, ku temat kanë qenë të ngritura ose të përzgjedhura nga vet ata. Disa nga temat e tilla kanë qenë e drejta në përfitimin e skemës sociale, raportet ndërmjet anëtarëve të familjes, punësueshmëria etj. Në monitorimin e kësaj komponente është angazhuar personeli i Asociacionit i Mjekësisë Familjare të Kosovës (AMFK) që ka monitoruar punën e ndërmjetësueseve dhe ka mentoruar ato, gjithashtu duke ndihmuar edhe QMF-të të mobilizohen në ndihmë shëndetësore të familjeve brenda mëhallave/lagjeve të komuniteteve. Mesatarisht 180 gra dhe vajza kanë marrë shërbime në komunën e Pejës duke u facilituar nga aktivitetet e projektit, gjersa në komunën e Suharekës shërbime të tilla kanë marrë mesatarisht 120 gra dhe vajza. Në aktivitetet që lidhen me këshillimet/ndërmjetësimet me punësueshmërinë, në komunën e Pejës janë punësuar 5 persona (të gjitha gra) kurse në komunën e Suharekës 3 persona burra.

3. Një numër i OJQ-ve (Rrjeti PROSPECT) angazhohet dhe avokon për implementimin e planeve komunale të veprimit për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

Rrjeti PROSPECT përbëhet nga organizatat partnere të projektit Prospect +, përfshirë organizatat që kanë qenë të angazhuara në projektin e mëhershëm Prospect (NVK, BCS, SiV, SHL-K dhe Vizioni 02). Si komuna e Pejës ashtu edhe ajo e Suharekës nuk kanë plane të veprimit apo strategji lokale për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Planet e veprimit dhe strategjitë që i kanë pasur kanë skaduar para 10 (Pejë) respektivisht 3 vjetëve (Suharekë) duke i bërë kështu komunat të ndërmarrin më pak masa sa i përket integrim-

it të këtyre komuniteteve. Meqenëse në nivel qendror është aprovuar strategji e tillë me planin e veprimit, deri në vitin 2021, organizatat partnere gjithë kohës kanë avokuar nëpër komuna që të realizohen masat e planifikuara të dokumentit strategjik që buron nga Zyra për Qeverisje të Mirë të kabinetit të Kryeministrit. Gjatë vitit 2018 partnerët lokalë (Nevo Koncepti – Suharekë dhe Syri i Vizionit – Pejë) në çdo muaj kanë pasur takime me drejtorët e sektorëve komunalë të shëndetësisë, arsimit dhe të mirëqenies sociale, jo vetëm për të koordinuar aktivitetet e projektit por edhe të merret vendimi për hartimin e dokumentit të ri strategjik në nivel komune për integrimin e komuniteteve. Takimet e këtilla janë përcjellë me praninë e zyrtarëve komunalë të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, të cilët gjithë kohës kanë shtruar nevojën për të pasur një dokument të tillë. Në takimet e fundvitit edhe me kryetarë të komunave, komunat kanë marrë vendim që në vitin 2019 të nisin me hartimin e strategjisë lokale dhe planit të veprimit për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Në nivel qendror organizatat partnere si rrjet PROSPECT kanë qenë pjesëmarrës në hartimin e Udhëzimit Administrativ të ri të MAShT (Nr.17/2018) i cili rregullon funksionimin e Qendrave Mësimore dhe përkrahjes financiare të tyre, i cili pritet të zbatohet në vitin 2019.

Organizatat partnere kanë ndërmarrë edhe aktivitete të avokimit në komunat e tyre. Kjo për arsye se mbështetja nga komunat ka qenë e vogël dhe ka pasur ndikim të vogël në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian. Kjo vjen gjithashtu edhe si rezultat i aktivizimit të ulët qytetar, apo i pak nismave që rrjedhin nga vetë pjesëtarët e këtyre komuniteteve. Përmes mobilizimit të rinjve që vijnë nga këto komunitete, përgjatë vitit 2018 është avokuar tek sektorët e ndryshëm komunalë,

ku si rezultat nga disa veprime avokuese janë zgjidhur disa nga problemet të cilat i kanë pasur banorët e lagjeve, sikurse rregullimi i urës në fshatin Leshan, vendosja e ndriçimit publik në lagjen 7 Shtatori, si dhe rregullimi i rrugëve në të gjitha lokacionet e projektit.

3. Shuma e granteve e shpërndarë në partnerë lokalë për vitin 2018

Emri i projektit	Grantmarrësi	Shuma në Euro
Realizimi i aktiviteteve mësimore, të ndërmjetësimit shëndetësor dhe social, dhe të rrjetëzimit dhe avokimit	Nevo Koncepti	24,000
Realizimi i aktiviteteve mësimore, të ndërmjetësimit shëndetësor dhe social, dhe të rrjetëzimit dhe avokimit	Syri i Vizionit	24,000
Trajnimi i tutorëve dhe mentorimi i mësimdhënësve të përfshirë në projekt	Qendra për Arsim e Kosovës,	2,450
Trajnimi i mediatoreve, mentorimi i punës së tyre dhe ndërlidhja me ofruesit e shërbimeve shëndetësore	Dr. Genc Ymerhalili, Asociacioni i Mjekëve Familjarë të Kosovës,	2,880
Pakot shkollore për nxënësit e komuniteteve	Operacionale	6,570

4. Të dhënat e përgjithshme të përfituesve të projektit Prospect Plus

Lagjia	Banorë të komunitetit	# fëmijëve që vijojnë mësimin (6-19 vjeç)	# fëmijëve që nuk vijojnë mësimin (6-19 vjeç)	# familjeve përfitues të skemës sociale	# i të punësuarve	Nr i të papunësuarve
7 Shtatori, Pejë	1340	218	52	46	3	151
Vitomiricë, Pejë	440	68	18	19	0	0
Totali në Pejë	1780	286	70	65	3	151
Leshan, Suharekë	139	28	14	12	3	65
Gelancë, Suharekë	212	51	31	16	2	0
Totali në Suharekë	351	79	45	28	5	65

